

SHËNDETËSI

Mungojnë kuadrot deficitarë

Fq.6



TALAT XHAFERI

Dialogu Kosovë- Serbi të zgjidhet sa më parë

Fq.4



RAMA NË RAINEWS:

S'mohoj blerjen e votave

Fq.16



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XIII · Numri 3593 · e hënë, 25 shkurt 2019

15°C | 20°C

15 DEN



KOHA për sport

Fq.12-15

ANALIZË

Si mund të luftohet "kapja e shtetit" në Ballkan?



Vala e madhe e protestuesve që kanë mbërthyer së fundmi Ballkanin, nga Tirana në Beograd dhe deri në Podgoricë, ka bërë që shumë ekspertë të politikave të rajonit të tregojnë problemin më të madh me të cilin përballen sipas tyre qytetarët e këtij rajoni: kapjen e shtetit. Fq.2

GJEOPOLITIKË

Lufta e Kinës dhe Ruisë për Rajonin e Ballkanit

Fq.18

GLOBI

Arabia Saudite emëron për herë të parë një grua ambasadore në SHBA

Fq.17



PRAPASKENAT E NJË PROCEDURE

SI I SHPËTOI VELJANOVSKI PARABURGIMIT?



Komisionit për Çështje të mandatit dhe imunitetit pas dy ditëve debat për heqjen e imunitetit të deputetit të VMRO-DPMNE-së, Trajko Veljanovski, të njëjtit nuk i mori mandatin sepse nga nëntë deputetët sa numëron komisioni amë, 4 deputetë votuan "për" dhe 4 "kundër".

Fq.3

Tetovë, në vend të tezgave hapet parking i ri

Tetovë, 24 shkurt - Diku rreth 40 vende të reja parkimi do të kenë në dispozicion qytetarët e Tetovës. Vendet e reja të parkimit janë paraparë në pjesën tek tregu i gjelbërt në Tetovë ku kohëve të fundit ishin ngulfatur hapësirat me tezgave për shitje të produkteve ushqimore dhe tekstil. Krahas kësaj, poashtu ishin uzurpuar edhe trotuarët që pamundësonin qarkullimin e lirë të automjeteve. "Pas aksionit për lirimin e hapësirave publike nga ana e Inspektoriatit komunal, përfundimisht trotuarët ju kthyen qytetarëve. Si autoritete, filluam aksionin për dislokimin e shitësve ambulante, brenda tregut të gjelbër. Paralelishtë filluam ndërtimin e një hapësire të re e cila do të shfrytëzohet si parking i mbyllur. Meqenëse vendparkimet janë një kërkesë shumë e rëndësishme e qytetarëve, ky vendparkim si pikë e re..." Fq.7

si-
rave
publike
nga
ana
e
Inspektoriatit
komunal,
përfundimisht
trotuarët
ju
kthyen
qytetarëve.
Si
autoritete,
filluam
aksionin
për
dislokimin
e
shitësve
ambulante,
brenda
tregut
të
gjelbër.
Paralelishtë
filluam
ndërtimin
e
një
hapësire
të
re
e
cila
do
të
shfrytëzohet
si
parking
i
mbyllur.
Meqenëse
vendparkimet
janë
një
kërkesë
shumë
e
rëndësishme
e
qytetarëve,
ky
vendparkim
si
pikë
e
re...



ANALIZË

SI MUND TË LUFTOHET "KAPJA E SHTETIT" NË BALLKAN?



"Sot, vendet e Ballkanit Perëndimor tregojnë elementë të qartë të kapjes së shtetit". Me këtë fjali Komisioni Europian mori për herë të parë guximin një vit më parë për të folur hapur kundër strategjive të liderëve rajonalë për të kontrolluar të gjithë mekanizmat demokratike të shteteve.

Për vite me radhë, burokratët e Brukselit kanë ngritur alarmin se kapja e shtetit pengon përparimin e vendeve të rajonit në Bashkimin Europian dhe kërcënon të ardhmen e qytetarëve. Por deri më tani, BE-ja nuk ka marrë ende masa, duke bërë që pakënaqësia e qytetarëve të rajonit të rritet dita-ditës. Por çfarë është kapja e shtetit dhe cilat janë "simptomat" e tij? Sipas Bankës Botërore, "kapja e shtetit ndodh kur elita qeverisëse /ose biznesmenët e fuqishëm "kapin" ose përcaktojnë politika për të ndryshuar ligjet dhe rregullat në avantazhin e tyre. Kapja e shtetit është forma më e lartë e korrupsionit e karakterizuar nga aleanca sekrete. Ai mund të shfaqet në dy forma: kapjen e korporatave shtetërore për përfitime private dhe kapjen e partive politike po për përfitime private.

Një nga protestat e opozitës në Tiranë Pavarësisht angazhimit të dyanshëm, një pjesë e madhe e masave teknike dhe normative të zbatuara nga qeveritë e Ballkanit Perëndimor për hir të përparimit të vendeve të tyre drejt BE-së nuk kanë sjellë reforma thelbësore. Në të vërtetë, standardet demokratike të vendeve të rajonit mbeten po njësoj. Bashkimi Europian është i vetëdijshëm për këtë, por deri më tani ka vendosur të bëjë një "sy qorr". Retorika e Komisionit Europian në vitin 2018 ishte më e guximshme se zakonisht, veçanërisht, pasi deklaroi se problemi i kapjes së shtetit do të ndikonte në hyrjen e rajonit në BE. Sidoqoftë, ai nuk caktoi asnjë vend në mënyrë specifike, gjë që i mundësoi çdo qeverie të përjashtojë veten nga kjo shuplakë. Për më tepër, Komisioni nuk ka përcaktuar as "simptomat" që çojnë drejt kapjes së shtetit, duke bërë që shumë ekspertë të ngrenë shqetësimin se Brukseli duhet në ndryshojë mënyrën e raportimit dhe qasjes ndaj problemeve të rajonit.

Shumë ekspertë rajonalë thonë se Ballkani ka nevojë për një BE që nxjerr në pah publikisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë problemet e rajonit. Ata thonë se kapja e shtetit nënkupton një gjendje të korrupsionit të përhapur dhe shfrytëzimin e burimeve publike për përfitime private, duke neutralizuar mekanizmat e kontrollit, qoftë me mjete ligjore qoftë në mënyrë të paligjshme.

Jelena Pijic, analiste serbe thotë se megjithëse raportimi brenda procesit të pranimit në BE tashmë është mjaft voluminoz dhe kompleks, disa nga raportet nuk janë në dispozicion të publikut dhe ato që publikohen përdorin fraza diplomatike dhe formulime të kujdesshme që nënkuptojnë kapjen e shtetit, por nuk i referohen në mënyrë të drejtpërdrejtë.

"Në Serbi partia në pushtet po shet interesat e saj si interesa publike (dhe kombëtare); proceset themelore demokratike, si zgjedhjet dhe puna e parlamentit kontrollohen nga shteti, drejtësia dhe administrata publike janë bërë gjithnjë e më të politizuara; politikanët në pozita të larta akumu-

Vala e madhe e protestuesve që kanë mbërthyer së fundmi Ballkanin, nga Tirana në Beograd dhe deri në Podgoricë, ka bërë që shumë ekspertë të politikave të rajonit të tregojnë problemin më të madh me të cilin përballen sipas tyre qytetarët e këtij rajoni: kapjen e shtetit.

lojnë kompetenca diskrete; liria e mediave nuk ekziston; përfaqësuesit e opozitës, shoqëria civile, institucionet e pavarura, akademia dhe gazetarët që shprehin kritika ndaj politikave zyrtare anashkalohehen dhe sulmohet", thotë ajo. "Më alarmues është fakti se këto sulme ndaj demokracisë ndodhin ndërkohë që negociatat vazhdojnë, edhe pse nuk ka pasur reforma thelbësore. Përkundrazi, qeveria duket se po vepron nën maskën e negociatave", thekson Pijic.

Ndërkohë të tjerë ekspertë thonë se BE duhet të veprojë më të gjitha vendet e rajonit ashtu siç veproi në Maqedoni, pas kapjes së shtetit nga ish-kryeministri Nikolla Gruevski.

Pas përgjimeve të urdhëruara nga qeveria, të cilat zbuluan shumë praktika korruptive të partisë në pushtet, duke përfshirë ndërhyrjen në punën e gjyqësorit, manipulimin e procesit zgjedhor, shtrëngimin e kontrollit mbi mediat dhe mbikëqyrjen e shërbimeve të sigurisë, BE-ja mori masa të rrepta.

Së bashku me ndërmjetësimin diplomatik midis aktorëve politikë në Maqedoni, Brukseli mblodhi një grup ekspertësh të pavarur, të udhëhequr nga ish-drejtori për Ballkanin në Komisionin Europian, Reinhard Priebe për të identifikuar çështjet sistematike të Sundimit të Ligjit në vend. Ky hetim çoi në të ashtuquajturin "Raporti Priebe". Ekspertët e pavarur nga vendet anëtare të BE-së ishin më të sinqertë në identifikimin e problemeve të demokracisë dhe nuk ishin aq formal sa raportet e zakonshme të BE-së. Sidoqoftë, fakti që "Raporti Priebe" u porositi dhe publikua nga Komisioni Europian i ka dhënë autoritet të madh.

Protesta në Serbi

Dokumenti identifikoi sektorin e sigurisë si një levë e rëndësishme e kapjes së shtetit. Ai vuri në dukje përqendrimin e fuqisë në shërbimin e inteligjencës maqedonase i cili veproi në mënyrë të shfrenuar dhe pa mbikëqyrje. Autoritetet përgjegjëse nuk kishin përdorur kompetencat e tyre të kontrollit dhe mbikëqyrjes, sepse ishin politizuara.

Për Pijic raportet si ai Priebe, janë të domosdoshme për çdo vend të Ballkanit Perëndimor dhe mund të shërbejnë si një model për të tejkaluar monitorimin teknik të BE-së. Një raport i pavarur i ekspertëve i mbështetur nga Komisioni Evropian mund të jetë një përgjigje adekuate ndaj nevojës për një monitorim më efektiv të reformave të sundimit e ligjit në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Serbi, Mal të Zi, Kosovë dhe Bosnje.

"Synimi i një monitorimi të tillë nuk duhet t'u kërkojë palëve të marrin përgjegjësi politike, por të identifikojë mangësitë kritike të sistemeve të demokracisë në Ballkan dhe të ofrojë mbështetje për t'i kapërcyer me sukses. Ky proces duhet të përfshijë dialog kombëtar të hapur dhe të sinqertë mbi reformat e nevojshme për hyrjen në BE", thotë analistja serbe.

Duke qenë të vetëdijshëm për elementet e kapjes së shtetit në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, BE duhet të përdorë levave të saj në politikën e zgjerimit në mënyrë që të përmbyset kapjen e shtetit dhe për të parandaluar rikthimin e krize të re të ngjashme me atë që e tronditi Maqedoninë katër vjet më parë. (BIRN)

POLITIKANËT SHQIPTARË DUHET T'I BOJKOTOJNË MEDIAT E KREMLINIT

"Kur pashë median proqeveritare shqiptare që shpërndajnë lajmin e intervistës së Bashës për Russia Today, nuk m'u besua dhe shkova e ndoqa vetë emisionin.

Basha, më së paku, është tradhtuar këtu nga njerëzit e tij që merren me komunikim dhe media.

Kjo më së paku ishte një dhuratë, shpresoj padashje për propagandën që vetë Edi Rama bën ndaj Bashës.

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha e ka krahasuar Edi Ramën me Maduron e Venezuelës. Po pastaj shkoi dhe jep intervistë për kanalin televiziv, i cili, 24 orë në ditë, mbron Maduron dhe regjimin e tij diktatorial.

Sot, "Russia Today" (Rusia Sot) makina propagandistike e Vladimir Putinit, shpenzoi 30 minuta nga emisioni njëorësh i lajmeve për të argumentuar në favor të Maduros dhe 10 minuta për të shpalosur argumentin e opozitës në Shqipëri.

E krahasuar me Pravdën e dikurshme të komunistëve sovietikë, "Russia Today" synon në mënyrë aktive të sabotojë paqen dhe stabilitetin në Ballkan, propagandon në mënyrë aktive kundër pavarësisë së Kosovës, paraqet shqiptarët si agresorë dhe serbët si viktime, ka shkruar në profiling e tij në Facebook, kryeredaktori i gazetës shqiptaro-amerikane "Ilyria", Ruben Avxhiu.

A KEMI PATRIOTIZËM EKONOMIK?

"Po na troket në derë MUAJI BOTEROR I TE DREJTAVE TE QYTETARIT KONSUMATOR, muaji MARS; Aty në mes na pret edhe DITA BOTERORE E TE DREJTAVE TE QYTETARIT KONSUMATOR - 15. MARS!

A jemi më mirë sivjet sa i përket përbushjes së të drejtave, obligimeve, intereseve dhe dinjitetit tonë?

Ç bëra unë / Ç bëre Ti / Ç bëmë ne më shumë e më mirë që Unë / Ti / Ai / Ne / Ju / Ata...famlijet tona, fëmijët tanë të jenë më të sigurt, më të shëndetshëm, më të kënaqur, më dinjitoz...?

"Dora e huaj nuk të kruan" ?!

E, disa institucione, asociacione e mekanizma tanë po na qasen "SI DORË E HUAJ" !

Kujdesi, (vetë)mbrojtja, reagimi, insistimi ligjor, qytetaria vepuese, angazhimi / aktivizmi dhe guximi qytetar...janë PATRIOTIZEM EKONOMIK !

Durimi dhe falja deri në infinit nuk është mençuri. Ata na shputisin, thonë: " la ngula ", " E bona budallë ", " E hongër ", " Futja budallës "...

Edhe kur porosisin / importojnë gjëra / artikuj jostandard ia bëjnë aminin personit në anën tjetër të telefonit: " Hajt, mos ki gjale se kjo gjoja jonë han e kullotë krejt çka t i qitsh " ?!

Të gjithat do të jenë të vërteta nëse me neglizhencën, injorancën...e përtacinë tonë i konfirmojmë ato ?!

Paranë e mendjen e kemi tonën dhe askush nuk mund të na detyrojë që të blejmë e konsumojmë çkado.

Paranë e mendjen tonë e kemi për ta mbrojtur vehten që t mos sfidohej me strese të ankimit, Nëse jemi të pakujdesëshëm dhe mashtrohemi - ANKIMI DO TE JETE TURPI YNE, Po mashtrohemi nga njerëzit pa shkollë e pa edukatë ?!", ka shkruar një status në Facebook, Selatin Kaçaniku, kryetari i Shoqatës së konsumatorëve të Kosovës.



PRAPASKENAT E NJË PROCEDURE

SI I SHPËTOI VELJANOVSKI PARABURGIMIT?

Komisionit për Çështje të mandatit dhe imunitetit pas dy ditëve debat për heqjen e imunitetit të deputetit të VMRO-DPMNE-së, Trajko Veljanovski, të njëjtit nuk i mori mandatin sepse nga nëntë deputetët sa numëron komisioni amë, 4 deputetë votuan “për” dhe 4 “kundër”.

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 24 shkurt – Anëtarët e Komisionit për Çështje të Mandatit dhe Imunitetit pas dy ditëve debat për heqjen e imunitetit të deputetit të VMRO-DPMNE-së, Trajko Veljanovski nuk i morën mandatin sepse nga nëntë deputetët sa numëron komisioni amë 4 deputetë votuan “për” dhe 4 “kundër”. Për heqjen e mandatit nuk votoi anëtari i komisionit nga radhët e BDI-së Agim Shaqiri i cili në momentin kur propozimi u hodh në votim nga kryetari i Komisionit Pavle Bogoevski, ai nuk ishte i pranishëm. Pas përfundimit të votimit kryetari i Komisionit Bogoevski u shpreh se me votimin 4 për dhe 4 kundër, nuk ka mundësi të japë rekomandim deri te kryetari i Kuvendit, se a duhet apo jo t’i merret Trajko Veljanovskit imuniteti i deputetit ashtu siç kërkon Gjykata Themelore Shkupi, për paraburgim të deputetit Veljanovski, sepse i njëjti është i dyshuar si organizator i ngjarjeve të 27-prillit, në kohën kur ka qenë kryesues i Parlamentit të Maqedonisë. “Kjo do të thotë se është refuzuar kërkesa, dhe nuk do të rekomandojë pranimin e saj”, deklaroi Bogoevski, pas përfundimit të seancës. Ai sqaroi se tani më fjalën e ka kryetari i Parlamentit se do t’i merret apo jo imuniteti deputetit dhe se kërkesa e gjykatës penale do të vendoset në seancë plenare. “Pas votimit, Komisioni amë duhet të dorëzojë raport nga debati deri te kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi dhe ky i fundit duhet që brenda tre ditësh të caktojë seancë plenare për heqjen e imunitetit të deputetit Veljanovski. Mirëpo kjo nuk do të thotë se nuk janë plotësuar kushtet që kryetari i parlamentit të caktojë seancë në afatin e paraparë. Për mos pasje të vendimit nga ana komisionit, në asnjë mënyrë nuk do të thotë se parlamenti nuk duhet të debatohet për kërkesën e Gjykatës penale”, deklaroi Pavle Bogoevski, kryetar i Komisionit për Çështje të Mandatit dhe Imunitetit.

SEANCË E RE PLENARE, TALAT XHAFERI NË HAMENDJE

Kryetari i parlamentit të Maqedonisë Talat Xhaferi ende nuk ka vendim konkret se do të cakton seancë plenare sot (të hënë) për heqjen e imunitetit të deputetit Trajko Veljanovski pasi 4 anëtarët e komisionit votuan për dhe 4 kundër. Pasi ta shoh raportin e Komisionit amë do të kërkojë nga shërbimet profesionale se si duhet të vendos. Raport nga komisioni ka



BOGOEVSKI: NUK KISHA SIGURI

“Kisha besim të plotë se koordinatori i BDI-së Ejup Alimi do të bëjë çmos ta sjellë zëvendësen e Agim Shaqirit, deputeten Mirsada Asani. Mirëpo deri në momentin e vendosjes në votim propozimin për marrjen e vendimit për heqjen e imunitetit të deputete Veljanovski e njëjta nuk u paraqit në seancë”. Kështu për gazetën KOHA deklaroi kryetari i Komisionit për çështje të mandatit dhe imunitetit Pavle Bogoevski i cili reagoi ndaj akuzave të deputetit

por nuk ka rekomandim. Që të caktoj seancë plenare duhet të kem raport me vendim konkret. Rregullorja e Parlamentit nuk parasheh situata të këtuilla. Unë do të thërras seancë plenare por çfarë do të jetë lënda e votimit. Nuk ka vendim nga komisioni. Për çfarë të debatohet. Të votojmë për heqjen imunitetit apo mos heqjen e imunitetit? Nuk kemi vendim konkret para nesh. Të votohet për “PO” apo “JO”. Të veprojmë sipas asaj që kërkon gjykata. Nuk mund Gjykata t’i propozon Parlamentit. Atëherë bëhet e pakuptimtë ekzistenca Komisioni për çështje të mandatit dhe Imunitetit. Këto situata specifike nuk parashihen në rregullore. Të themi se do ta vendos në rend dite votimin, por çfarë thotë raporti? Raporti i komisionit thotë edhe për “PO” edhe për “JO”, thotë krye parlamentar Talat Xhaferi. Burime nga partia në pushtet LSDM thonë se tani në lojë është opsioni i kryetarit të parlamentit Talat Xhaferi i cili në konsultim me shërbimet profesionale mund të jep drejtim se kjo çështje do të vendoset në seancë plenare që deputetët të votojnë “PËR” apo “KUNDËR” për marrjen e imunitetit deputetit apo ish kryetarit të parlamentit. “ Është e pasigurt për momentin se kush apo cili t’i rekomandon parlamentit t’i merret imuniteti Veljanovskit në seancë plenare, ku duhet votojnë 61 deputet për “PO” apo “KUNDËR” heqjes e imunitetit të deputetit”, thonë nga LSDM-ja. Ndërkaq për partinë opozitare VMRO -DPMNE s’ka asnjë dilemë

Alimi se fajtor për mos marrjen e imunitetit të Veljanovski është vetë kryetari i komisionit Bogoevski. “Nëse Alimi më kishte siguruar se do ta sjellë kur të votohej deputeten Asani këtë dhe duhej të bënte deri në ora 22.30 minuat dhe unë i besova atij. Mirëpo deri në momentin e votimit unë nuk kisha asnjë vërtetim se deputetja do të vinte”, thotë Bogoevski. Sipas tij ai disa herë ka tentuar ta kontaktoj me deputeten Asani përmes celularit por nuk ka mundur ta merr.

se duhet të caktohet seancë plenare nga kryetari i parlamentit për shkak se situata është e qartë. “Procedura e mëtejshme ndërpritet kur kihet parasysh fakti se Komisioni nuk ka vendim dhe parlamenti nuk ka se për çfarë të debatohet”, thonë nga partia VMRO-DPMNE.

AGIM SHAQIRI PËRFUNDON NË SPITAL

Partia në pushtet BDI-në për mos heqjen e imunitetit të deputetit Veljanovski e fajëson kryetarin e komisionit amë Pavle Bogoevski edhe pse i njëjti në kohë ka qenë i informuar për mungesën e anëtarit Agim Shaqiri në seancë të komisionit për shkak të përkeqësimit të gjendjes shëndetësore. Deputeti i Bashkimit Demokratik për Integritet dhe koordinatori i grupit parlamentar, Ejup Alimi ka ngritur dyshime ndaj kryetarit të komisionit për mandate dhe imunitet pasi që ai ndërpreu seancën dy orë përpara afatit edhe përkundër se ishin marrë vesh me LSDM gjegjësisht me kryetarin e Komisionit dhe i njëjti nuk ka pritur ardhjen e deputetes Mirsada Emini Asani. Mos heqja e imunitetit sipas Alimit nuk ishte për shkak se nuk votoi anëtari -deputeti të BDI-së por për shkak se kryetari Bogoevski ndërpreu para kohe punën e komisionit parlamentar për mandate dhe imunitet. “Mbrëmë rreth orës 19:00, pas qëndrimit dy ditë në punimet e komisionit mbi kërkesën e gjyqit për heqjen e imunitetit të deputetit Veljanovski, deputetit Agim Shaqiri,

iu përkeqësua gjendja shëndetësore dhe përfundoi në qendrën klinike në Shkup”, thotë Ejup Alimi deputeti i BDI-së. Alimi më tej sqaroi se duke u ballafaquar me këtë situatë, diku rreth orës 21, e kërkuar zëvendësen e Agimit, që të vijë dhe ta zëvendësojë. “Dërguam vozitës që ta merr zëvendës anëtarin dhe ta sjell për votim, por rreth orës 21:30, komisioni ndërpreu punën dhe e vuri në votim vendimin pa pritur ardhjen e deputetës tonë, e cila do të arrinte diku rreth orës 22:00 ose 22:30, ndërsa afat kohor për ta përfunduar seancën kishte gjer në mesnatë”, thotë Alimi duke shtuar se paraprakisht ishin marrë vesh që seancën ta mbyllin në ora 23:00 kur edhe do të votohej mbi vendimin. Ndërkohë dhe vetë deputeti i BDI-së Agim Shaqiri sqaroi se pas pauzës së dhënë nga kryetari komisionit në ora 18:00, ka shkuar në qendrën emergjente në klinikën shtetërore, ku siç thotë ai është ndaluar nga mjekët për arsye të problemeve serioze shëndetësore. “U dëgjova me koordinatorin e grupit parlamentar të BDI-së Ejup Alimi i cili erdhi dhe më vizitoi në klinikë dhe pas kësaj situatë, koordinatori morri masa që zëvendës anëtarja zonja Mirsade Emini Asani të shkojë në votim, mirëpo komisioni ndërpreu punën dhe e vuri në votim vendimin pa pritur deputeten tonë”, thotë Agim Shaqiri deputeti i BDI-së.

DYSHIMET E OPOZITËS

Për paritë opozitare shqiptare në Parlamentin e Maqedonisë

, mënyrën e votimit në komisioni e vlerësojnë si skandaloze dhe të turpshme për shkak se në Parlamentin e Maqedonisë pas 28 viteve për herë të parë ndodhë që komisioni, mos të votojë për kërkesën e gjykatës që t’i merret mandati një deputeti. Nga partia opozitare Aleanca për Shqiptarët (ASH) shprehen se janë të bindur thëllë se mos prezenca e deputetit të BDI Agim Shaqirit në Komisionin për mandate dhe imunitet ku duhej edhe t’i merrej mandati Trajko Veljanovskit, është e qëllimshme dhe e koordinuar me partinë e tij BDI, për ta shpëtuar Veljanovskin nga paraburgimi. “Ky është skandali i radhës i turpit dhe i tradhtisë, ndaj votuesve shqiptar që kanë votuar BDI, që sot janë shndërruar në mbrojtës të krimit të korrupsionit që i kanë bërë bashkë gjatë qeverisjes BDI-VMRO. Pas 28 viteve për herë të parë ndodhë që Parlamenti i Maqedonisë të mos voton kërkesën e gjykatës penale për heqjen e imunitetit të një deputeti”, thotë Flakron Bexheti zëdhënës i ASH-së. Sipas Bexhetit emëruesi i përbashkët i BDI dhe VMRO ‘ka qenë krimi dhe korrupsioni, dhe sot mundohen ta mbrojnë njëri tjetrin’.

“Në fakt BDI, detyrohet ta mbrojë VMRO-DPMNE me çdo kusht, sepse kjo e fundit i din të gjitha pislleqet politike të BDI, përfshirjen eventuale në procese gjyqësore politike dhe BDI për shkak se kaluar së sajë mund të ndihet e shantazhuar nga VMRO, për atë arsye, detyrohet ta mbroj herë Gruvskin e herë Veljanovskin sa herë që e kërkon nevoja”, thotë Bexheti. I gjithë ky veprim, sipas Bexhetit, qartë tregon se ‘BDI-ja është me bisht të kapur herë nga VMRO e herë nga LSDM’, dhe ajo duhet të votojë ashtu siç po e diktojnë të tjerët, siç ishte rasti kur votuan Prokurorin e përgjithshëm Jovo Kotevskin që rikualifikoj rastin e Almirit.

Parlamenti francez nënshkroi protokollin e NATO-s

Shkup, 24 shkurt - Franca e nënshkroi protokollin e NATO-s dhe gëzohet që do të jemi aleatë në kuadër të Aleancës Veriatlantike. Sa i takon negociatave inkuadruese me Maqedoninë e Veriut do të hapen pasi vendi t'i plotësojë të gjitha kriteret. Bashkimi Evropian nga ana tjetër, do të duhet fillimisht t'i realizojë reformat e domosdoshme për reformimin e saj para se të ndodhë zgjerimi i ri, thotë në intervistë për MIA-n ministrja franceze e Çështjeve Evropiane, Nata-

li Loazo, njofton MIA.

"Franca gjithmonë e ka mbështetur Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndërsa tani dëshiron më shumë se kurrë ta shohë të përfunduar dhe të integruar në rajon të paqes dhe të zhvillimit. Dy vitet e fundit Shkupi bërë progres të jashtëzakonshëm për pajtimin rajonal dhe falë vendimeve të guximshme për të cilat e dimë se ishin të dhimbshme, u tejkalua kontesti historik me Greqinë. Ky vendim i guximshëm, Marrëveshja e Pre-

spës, mundësoi të nënshkruhet protokollin për anëtarësim në NATO dhe paraqet progres të madh për sigurinë e Maqedonisë së Veriut. Franca e nënshkroi të njëjtin dhe gëzohet se do të jemi aleatë në kuadër të Aleancës Veriatlantike. Sa i takon afimit të Maqedonisë së Veriut drejt Bashkimit Evropian: negociatat inkuadruese do të hapen pasi Maqedonia e Veriut t'i plotësojë të gjitha kriteret. Bashkimi Evropian nga ana tjetër, do të duhet fillimisht t'i realizojë refor-



mat e domosdoshme për reformimin e saj para se të ndodhë zgjerimi i ri", thekson ministrja Loazo.

Ajo do të realizojë vizitën e saj të parë të punës në Shkup të martën, më 26 shkurt.



Mile Janakieski vendoset në arrest shtëpiak

Shkup, 24 shkurt - Gjykata Penale Shkupit ka marrë vendim që ish ministri i Transportit, Mile Janakieski, për 30 ditë, të vendoset në arrest shtëpiak, pas disa plagëve të marra nga të burgosurit ku po qëndronte në paraburgim. Janakieski, që është në proces gjyqësor për ngjarjet e dhunshme në Parlament më 2017, pësoi disa lëndime trupore më 21 shkurt nga të burgosurit. Pas incidentit, kryeministri Zoran Zaev detyroi shefin e burgut, Gjoko Kotevski, të japë dorëheqje.

Spiro Ristovski, ish ministër i Arsimin u raportua se kishte pësuar lëndime po ashtu gjatë paraburgimit. Ai u rivendos në një zonë tjetër të paraburgimit.

Autoritetet në Maqedoninë e Veriut më 20 shkurt kanë arrestuar ish kryetarin e Parlamentit, Trajko Veljanovski dhe dy ish ministrat e qeverisë së kaluar, për rolin e tyre në hyrjen me forcë në Parlament më 2017. Të akuzuarit kishin mohuar akuzat.

TALAT XHAFERI: DIALOGU KOSOVË-SERBI TË ZGJIDHET SA MË PARË

Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi thotë për KosovaPress, se bëjnë përpjeke që edhe Kosova të jetë prezentë në organizatat ndërkombëtare



Shkup, 24 shkurt - Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi ka deklaruar se tashmë Kosova nuk duhet që ta zgjasë më shumë procesin që e dërgon vendin në një marrëveshje finale me Serbinë.

Sipas tij, duhet të gjendet një zgjidhje e pranueshme për popullin e Kosovës. Gjithahstu ai ka

theksuar se pasi Maqedonia arriti të zgjidh konfliktin 30 vjeçar mbi emrin, që e kishte me Greqinë, vendit iu hapën dyert për anëtarësim në NATO.

Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi thotë për KosovaPress, se bëjnë përpjeke që edhe Kosova të jetë prezentë në organizatat ndërkombëtare.

Duke iu referuar përvojës së Maqedonisë, në konfliktet që kanë të bëjnë më fqinjët, Xhaferi sugjeron që të shfrytëzohen përvojat e tyre dhe Kosova mos të lejojë të stërgjatët procesi me Serbinë.

"Si vend fqinj normal që bëjmë përpjekjet që Kosova të jetë prezent në të gjitha organizatat dhe veprimet ndërkombëtare që

ndodhin, dhe për këtë arsye mendoj që u takon institucioneve të Kosovës dhe popullit të Kosovës, që edhe duke iu referuar përvojës tonë tre dekadëshe për çështje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me fqinje. Nuk do mend që sugjerimi është që ato përvoja të shfrytëzohen dhe mos të lejojnë që proceset të stërgjatën me dekada, por të gjendet zgjidhje që do të jetë e pranueshme për popullin e Kosovës, për institucionet e Kosovës dhe normal për të dy palët për faktin që çështja ka të bëjë me raportet dy palëshe dhe në këtë aspekt... Këto janë çështje për të cilat kurdo duhet të ketë një vendim, marrëveshje, konform asaj çka janë pritshmëritë e qytetarëve".

Në Kosovë po flitet se një marrëveshje finale me Serbinë do të mund të ndodh brenda këtij viti.

Sa është i gatshëm shteti të ballafaqohet me fatkeqësi të përmasave të mëdha

Shkup, 24 shkurt - Aksidenti tragjik me autobusin e linjës Shkup-Gostivar ka ngritur dyshime në opinion nëse organet shtetërore janë ta gatshme për tu ballafaquar me fatkeqësi të përmasave të mëdha. Drejtues të institucioneve thonë se ky rast duhet të shihet si shkëndijë flijimi për përmirësimin e kushteve. Udhëheqësi i Njësisë Territoriale Kundër Zjarrit në Tetovë, Uka Aliti



thotë se nuk disponojnë mjetet e nevojshme për intervenim në raste të aksidentit. Ai kërkon nga organet shtetërore që të investojnë në mjete pune që u nevojiten zjarrfikësve me qëllim që të bëhet intervenim i duhur dhe i shpejt në raste të ardhshme urgjente. Për efikasitet, siguri dhe arritje sa më të shpejtë në vendin e ngjarjes, zjarrfikëset kërkojnë të kenë përfaqësi

në çdo komunë. Nga 81 komuna sa numëron e gjithë Maqedonia, vetëm 23 komuna kanë njësi kundër zjarrit

Nga ana tjetër drejtor i Urgjencës në Spitalin Nëna Terezë, Ilir Hasani tha se duhet të bëhet analizë e detajuar e aksidentit të fundit dhe të gjenden lëshimet me qëllim të përmirësimit të gjendjes aktuale të shëndetësisë.

Zgjedhjet presidenciale, del në shqyrtim publik lista zgjedhore

Shkup, 24 shkurt - Komisioni shtetëror i zgjedhjeve nëpërmjet një kumtese ka lajmëruar të gjithë qytetarët e Maqedonisë se shqyrtimi publik i të dhënave në Listën zgjedhore ka filluar më 23 shkurt 2019 dhe do të zgjat deri më 14 mars 2019. Nga KSHZ lajmërojnë se shqyrtimi publik i Listës zgjedhore implementohet në njësitë dhe zyrat rajonale të Komisionit shtetëror zgjedhor, nga ora 08:30 deri në ora 19:00, të përllogaritura edhe

ditët e fundjavës dhe festave, ndërsa më 14 mars 2019 shqyrtimi publik do të zgjat deri në ora 24:00.

Lista zgjedhore vendoset në shqyrtim publik në bazë të gjendjes së të dhënave të qytetarëve, si më poshtë:

qytetarë me moshën 18 vjeçare me letërnjoftim të vlefshëm ose pasaportë në ditën e zgjedhjeve (21 prill 2019),

persona të vdekur 30 ditë para ditës së shpalljes të zgjedhjeve (08

janar 2019) dhe të dhëna të tjera nga Lista zgjedhore në ditën e shpalljes së zgjedhjeve (21 prill 2019).

Nga KSHZ njoftojnë se qytetarët e interesuar të cilit duan të kryejnë shqyrtimin e të dhënave personale në listën Zgjedhore, atë mund ta kryejnë në 6eb faqen zyrtare të komisionit Shtetëror zgjedhor www.sec.mk dhe në njësitë dhe zyrat rajonale të komisionit Shtetëror zgjedhor.



RTS: RAPORT PROGRESSET E KE-SË, PAS ZGJEDHJEVE TË PARLAMENTIT EVROPIAN

Sipas analistëve, drejtimi i politikës së zgjerimit të BE në Ballkanin Perëndimor do të varet nga rezultatet e zgjedhjeve evropiane, kurse disa anëtarë të BE-së e konsiderojnë zgjerimin në Ballkan si një rrezik të brendshëm përpara zgjedhjeve



Shkup, 24 shkurt - Ballkanin Perëndimor sipas analistëve, drejtimi i politikës së zgjerimit të BE në Ballkanin Perëndimor do të varet nga rezultatet e zgjedhjeve evropiane. Shpallja e raportit vjetor të Komisionit Evropian për përparimin e vendeve të Ballkanit do të shtyhet deri në fund të zgjedhjeve të Parlamentit Evropian, të planifikuara për në fund të majit, raporton RTS, duke cituar burimet diplomatike në Bruksel, njofton A10n.

Sipas analistëve, drejtimi i politikës së zgjerimit të BE në Ballkanin Perëndimor do të varet nga rezultatet e zgjedhjeve evropiane.

Edhe pse u njoftua që këto raporte do të shpallen në mes të prillit, raportet vjetore për vendet e Ballkanit do të shpallen pas 29 majit, e cila, sipas mediave, është shenjë se disa anëtarë të BE-së e konsiderojnë zgjerimin në Ballkan si një rrezik të brendshëm përpara zgjedhjeve. Edhe zëvendëskryetari i Qeverisë për Çështje Evropiane

Bujar Osmani, në kuadër të vizitës në Bruksel informoi për procesin e integritimit evropian të vendit. Ai me këtë rast ka potencuar dinamikën e zbatimit të reformave të parapara në Planin 18, në veçanti në fushat kyçe të sundimit të së drejtës, shërbimet e sigurisë dhe të inteligjencës, reforma në administratën publike dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

"Kemi sukses të jashtëzakonshëm në dinamikën dhe imple-

mentimin e reformave të parapara të Planit 18, për të cilën besoj se do të reflektojë në një Raport shumë më të mirë të Komisionit Evropian nga ajo e vitit të kaluar, së bashku me një rekomandim të pakushtëzuar deri në Këshillin e BE-së", ka nënvizuar Osmani, duke shprehur pritje të qartë se ky progres do të rezultojë me konfirmimin e vendimit të Këshillit të BE-së në qershor, për fillimin e negociatave me Republikën e Maqedonisë së Veriut, transmeton KOHA.

Sheqerinska: Incidenti në Shutkë me motive politike



Shkup, 24 shkurt - Jemi të vetëdijshëm se gjatë incidenteve në Burgun e Shutkës, ku u sulmuan Mile Janakieski dhe Spiro Ristovski, me siguri ka pasur lojëra politike dhe atë do ta dëshmojnë institucionet, tha Zëvendëskryeminstria Radmilla Sheqerinska.

Duke iu përgjigjur pyetjeve në debatin qytetar në Manastir, ajo gjithashtu e cekti edhe vizitën e Miçkovskit në spital "8 shtatori", duke thënë se VMRO DPMNE-ja vazhdon me të njëjtën agresion dhe dhunë duke menduar se është mbi ligjin. "A është rastësi fakti që kur Gruevski ka nevojë për justifikime shtesë për

atë përse ka ikur nga vendi, tani të na ndodhin këso gjërash? Kjo ishte pikërisht dita kur Kuvendi duhej të diskutonte marrjen e imunitetit të njërit prej atyre që janë të përfshirë në ngjarjet e 27 prillit. Është e qartë se në ligj janë bërë disa lojëra të mëdha për të justifikuar dhe zburuar fytyra e politikanëve, jo vetëm ata që ishin në burg, por edhe ata që janë jashtë burgut sepse kanë ikur. Këtë shpresoj se do ta dëshmojë hetimi. Megjithatë, ne nuk jemi Qeveri që do të qëndrojnë anash dhe të themi se nuk mbajmë përgjegjësi"- deklaroi zv/kryeminstria Radmila Sheqerinska.

Shkup, mbyllet ordianca në të cilën vdiq pacienti

Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor i shqiptoi ndalesë të përkohshme për kryerjen e veprimtarisë shëndetësore ISHP ordiancës specialiste për kirurgji plastike "Dr. sci. K. Mitanoski" në komunën e Aerodromit.

Ndalesa është shqiptuar pas mbikëqyrjes inspektuese të jashtëzakonshme lidhur me pacientin i cili ndërroi jetë nga sepsa në IPSH QPQ "8 Shtatori", i cili ka qenë i trajtuar në sallën e operacioneve në këtë ordiancë



Ndalesë për automjetet e rënda në rrugën Mavrovë-Dibër

Shkup, 24 shkurt - Reshjet e borës gjatë pasdites ka në Mavrovë dhe në pjesën veriperëndimore të vendit, ndërsa ndalesë për automjetet e rënda ka një rrugën Mavrovë-Dibër. Siç njoftojnë nga ndërmarrja publike "Rrugët e Maqedonisë" në pjesët e mbetura të shtetit komunikacioni po zhvillohet kryesisht nëpër korsi të tha-

ta në pjesët më të ulëta. Intensiteti i komunikacionit në drejtimet rrugore jashtë mjediseve të qytetit është mesatar, ndërsa në vendkalimet kufitare nuk ka pritje të gjata për hyrje dhe dalje nga shteti. LAMM rekomandon shpejtësi të përshtatur të lëvizjes, respektim të sinjalistikës dhe drejtim të vëmendshëm të automjetit.



Fruthi merr jetën e një foshnje nga Kumanova

Shkup, 24 shkurt - Në Institutin për Sëmundje të Mushkërive në Kozle ka vdekur një foshnje nga Kumanova. Nga fillimi i vitit, e deri më tani, gjithsej tetë persona nga Kumanova janë sëmurë nga fruthi, prej të cilëve gjashtë fëmijë.

Qendra e Shëndetit Publik në Kumanovë ka dezinfektuar hapësirat dhe ka siguruar dhoma të izoluar për raste të dyfishta të infektuarve nga fruthi dhe për hospitalizim, si pasojë e rritjes së të prekurve nga fruthi.

Këto masa po ndërmerren për të parandaluar përhapjen sëmundjes, sidomos pas rastit të fundit të vdekjes së foshnjës gjashtëmuajshe. Mjekët apelojnë që prindërit sa më parë t'i vaksinonjë fëmijët e tyre. Siç informon për KOH-ën, dr. Agron Sulejmani, përgjegjës i repartit për fëmijë nga Kumanova, dy fëmijë nga fillimi i shpalljes së epidemisë janë kontrolluar në ambulancë dhe menjëherë janë transferuar në Klinikën Infektive në Shkup.

Hospitalizimi i fëmijëve të vaksinuar në Kumanovë nën një vit është vetëm 49.2 për qind, në fshat dhe rrethinat 91.5 për qind dhe rivaksinimi është 89.2 për qind, që është larg nga norma e kënaqshme mbi 95 për qind. Mjekët thonë se numri i fëmijëve të vaksinuar po rritet. (D.K)



Olta Xhaçka viziton Shkupin

Shkup, 24 shkurt - Gjatë ditës së nesërme për vizitë zyrtare në ministrinë e Mbrojtjes do jetë ministrja e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, Olta Xhaçka. Siç njoftojnë nga ministria e Mbrojtjes, pritja para ministrisë së Mbrojtjes do të mbahet në ora 9:05. Në ora 9:30 është parashikuar incizimi i inserteve nga takimin mes dy ministreshe Sheqerinska dhe Xhaçka dhe nga takimet e dy delegacioneve. "Në ora 11:00 ministrja e Mbrojtjes Radmilla Sheqerinska dhe Olta Xhaçka do të japin deklarata për mediat në qendrën për shtyp në qeveri, menjëherë pas takimit të ministres Xhaçka me kryeministrin Zoran Zaev.

SPITALET RAJONALE ME PERSONEL TË BOSHTATISUR

MUNGOJNË KUADROT DEFICITARË

Në shumicën e spitaleve rajonale, kuadri mjekësor ose po largohet jashtë vendit, ose po pensionohet. Përpjekjet për të përtërirë vendet e boshatisura, janë në qendër të preokupimit të drejtuesve të spitaleve, por edhe të Ministrisë së Shëndetësisë



Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 24 shkurt – Mungesa e kuadrit mjekësor, kryesisht gjinekologë, anesteziologë, infektologë, urologë, por edhe motra medicinale, ka shqetësuar drejtorët e spitaleve të përgjithshme.

Këtë mungesë e kanë konfirmuar edhe në Odën e Mjekëve, kurse rajonet më të goditura tani për tani janë Dibra, ku përveç mungesës së motrave medicinale në spitalin e këtij qyteti, ka mungesë edhe të gjinekologëve, urologëve, internistëve. Por kohët e fundit janë bërë disa përpjekje që kuadri i pensionuar të zëvendësohet me personel të ri, kryesisht mjekë të posadiplomuar.

“Ne vazhdimisht kemi bërë apel për mungesë të mantelbardhëve. Mirëpo, kohën e fundit kemi një prurje të mirë si nga Universiteti i Tetovës ashtu edhe nga fakulteti i mjekësisë të Shkupit, Prishtinës dhe Tiranës dhe ky kuadër ka qenë i mirëseardhur, për shkak të mungesës. Në konkursin e fundit unë bëra pranimin e tre mjekëve, tani kemi një konkurs edhe për katër mjekë të tjerë. Gjithashtu kemi bërë kërkesë për motra medicinale dhe mamive”, thotë për gazetën KOHA, dr. Baki Halili, drejtor në Spitalin e përgjithshëm të Dibrës.

Por spitali i Dibrës, si edhe spitale tjera rajonale, ka mungesë të vazhdueshme të kuadrit specialist, si rezultat i largimit të gjinekologëve, anesteziologëve, etj.

“Për momentin kemi një deficit të specialistëve të profilin kirurgjikal. Kemi bërë kërkesë në Ministrinë e Shëndetësisë, dhe aktualisht spitali ynë ka nevojë për 7 specializantë, dy prej të cilëve kirurg, një gjinekolog, një anesteziologë”, tha Halili.

Pastaj vjen Gostivari, ku mungesa e kuadrit deficitar ka një historik më të hershëm.

Ylber Besimi, nënkryetari i Odës së mjekëve në Maqedoni thotë për gazetën KOHA, se është kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë që të përfshihen në politikën e ndarjes së specializimeve për të ulur deficitin e mjekëve specialistë në lëmi të caktuara.

“Kemi shumë probleme shkak të mungesës së specialistëve, siç është rasti me anesteziologë, patologë, infektologë, neurologë, gjinekologë etj. në shumicën e rajoneve të Maqedonisë dhe kjo duhet të paraqesë alarm për strukturat udhëheqëse të vendit”, nënvizon Besimi.

Në spitalin e Gostivarit disa reparte funksionojnë me mjekë të

DEPARTAMENTIT KIRURGJIK NË SPITALIN E STRUGËS JASHTË FUNKSIONIMIT

Më shumë se tri javë pjesa operative e departamentit kirurgjik në spitalin e Strugës nuk funksionon për shkak të një defekti në pajisjen anesteziologjike, respektivisht stacioni i gazit. Për shkak të kësaj gjendje, është pamundur të kryhen ndërhyrje kirurgjikale. Rastet emergjente dërgohen në spitalin e Ohrit. Është thirrur riparuesi i autorizuar, por tani është duke u pritur prokurimi i pjesës së nevojshme të rezervës që nuk dihet kur do të arrijë. Nga këtu gazrat e anesteziologjike shkojnë në procesin e operacionit dhe nëse këto reduktues nuk funksionojnë, asnjë prej nesh anesteziologëve dhe sigurisht edhe kirurgët nuk duan që jeta e pacientit ta vihet në rrezik për shkak të një problemi me pajisjet. Ne punojmë në një spital të vjetër, punojmë me pajisje të vjetra. Para 7-8 viteve



ishite një delegacion japonez që po fotografohej pranë aparateve tona. Ata nuk kishin parë aparate të tilla me të cilat ne punojmë- deklaroi Aco Veljanoski-Drejtor i Departamentit të Anesteziologjike. Pacientët, operacionet e të cilëve mund të presin, nga spitali i Strugës u japin dy opsione, të shkojnë në Ohër, ose të presin riparimin e defektit.

moshuar, kurse në disa të tjera ka mungesë të dukshme të personelit shëndetësor.

“Për momentin në Repartin e gjinekologjisë janë 7 gjinekologë, ku edhe i mbulojmë kërkesat deri diku, mirëpo nga ky kuadër brenda një viti pensionohen 4 mjekë, kështu që reparti jonë mund të mbetet me 3 mjekë, gjë që nga një qytet funksional do të bëhet funksional dhe për këtë gjendje

askush në ministri nuk mban llogari. Në përherë kemi kërkuar që të rinjtë të dërgohen në specializime, për të përfituar kohë, se bëhet fjalë për pesë vite shkollim. Momentalisht kemi dërguar vetëm një mjekë në specializim privatisht, por kemi bërë përpjekje me shumë peripeci ta fusin në kuotën e mjekëve të spitalit tonë, me qëllim që të obligohet të qëndrojë në spital”, tha gjinekologu Agim Jakupi,

kryeshef i Repartit gjinekologjik në Gostivar. Ai shton se, për plotësimin e vendeve të punës do të duhet të planifikohen më herët, punësimi i mjekëve. “Planifikimet nga ana e ministrisë është dashur të bëhen qysh më herët, sepse qysh atëherë janë bërë kërkesat tona. Dikur ka pasur punësime partiake, sot nuk mund të gjenden mjekë”, tha Jakupi, për gazetën KOHA.

Nuk ka më parking falas deri në 1 orë në City Mall

Shkup, 24 shkurt - Qendra më e madhe tregtare në vend “Skopje City Mall” i ka njoftuar të gjithë vizitorët se ka vendosur regjim të ri të parkimit në hapësirat e qendrës.

Nëse deri më tani ora e parë në këtë qendër ka qenë falas, tani më periudha tranzitore është përgjy-

smuar gjegjësisht do të ketë vetëm 30 minuta parking falas dhe më pas katër orët e para vazhdojnë të kushtojnë 40 denarë siç ka qenë deri më tani.

Katër orët e para kushtojnë 40 denarë, ndërsa çdo orë e ardhshme kushton 40 denarë, me këtë ta-

rifë 4 orë 40 denarë, Skopje City Mall mbetet parkingu më i lirë në Maqedoni.

Parkingu si edhe deri më tani është falas për personat me invaliditet vetëm me paraqitjen e librezës invalide gjatë hyrjes dhe daljes nga Qendra Tregtare.



Problemi me tezatg përreth tregut të gjelbër disa herë ka qenë edhe pjesë e diskutimeve në këshillin e komunës së Tetovës, kurse Inspektorati komunal i Tetovës filloi një aksion për lirim e hapësirave publike nëpër sheshe dhe rrugë të qytetit dhe përreth tregut të gjelbër me qëllim që qarkullimi i qytetarëve të jetë sa më i lirshëm

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 24 shkurt - Diku rreth 40 vende të reja parkimi do të kenë në dispozicion qytetarët e Tetovës. Vendet e reja të parkimit janë paraparë në pjesën tek tregu i gjelbërt në Tetovë ku kohëve të fundit ishin ngulatur hapësirat me teza për shitje të produkteve ushqimore dhe tekstil. Krahas kësaj, poashtu ishin uzurpuar edhe trotualet që pamundësonin qarkullimin e lirë të automjeteve.

"Pas aksionit për lirim e hapësirave publike nga ana e Inspektoriatit komunal, përfundimisht trotualet ju kthyen qytetarëve. Si autoritete, filluam aksionin për dislokimin e shitësve ambulantë, brenda tregut të gjelbër. Paralelisht filluam ndërtimin e një hapësire të re e cila do të shfrytëzohet si parking i mbyllur. Meqenëse vendparkimet janë një kërkesë shumë e rëndësishme e qytetarëve, ky vendparkim si pikë e re në njërin nga hyrjet kryesore të qytetit do të reduktoje jashtëzakonisht problemin e komunika-

TREGU I GJELBËR I TETOVËS ME PAMJE TË RE

NË VEND TË TEZGAVE HAPET PARKING I RI



cionit të ngjeshur, përreth tregut të gjelbërt", thotë kryetarja e komunës së Tetovës Teuta Arifi.

Deri më tani, hapësirat që janë larguar janë menaxhuar nga ana e Ndërmarrjes Publike Komunale, kurse tash e tutje do të menaxhohen nga ana e ndërmarrjes Parkingu i qytetit. Problemi me tezatg përreth tregut të gjelbërt disa herë ka qenë edhe pjesë e diskutimeve në këshillin e komunës së Tetovës, ku këshilltarët kanë kërkuar që të lirohen hapësirat dhe ajo pjesë tu kthehet këmbësorëve. Para dy jave, Inspektorati ko-

munal i Tetovës me ndihmë të pjesëtarëve të policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë filloi një aksion për lirim e hapësirave publike nëpër sheshe dhe rrugë të qytetit, dhe përreth tregut

të gjelbër në Tetovë me qëllim që qarkullimi i qytetarëve të jetë sa më i lirshëm. Me këtë rast janë larguar të gjitha tezatg statike të shitësve ambulant në trotualet përreth tregut të gjelbër. Nga in-

spektorati thonë që ky aksion është vazhdimësi e disa aksioneve të mëparshme për lirim e hapësirave publike pasi që është e drejtë e çdo qytetari të ketë qasje deri tek hapësirat publike në vendbanimin e tij dhe obligim moral i të gjithëve që të përkujdesemi për mirëmbajtjen e këtyre hapësirave. Si rezultat i kësaj, janë angazhuar ekipet e inspektoratit komunal me asistencë edhe të SPS-së Tetovë për të larguar tezatg e improvizuara nëpër trotualet e qytetit dhe përreth tregut të gjelbër dhe për të dhënë fund uzurpimit të hapësirës publike dhe tregtisë së paligjshme, thonë nga komuna e Tetovës. Ndonëse parkimi shumëkatësh në Tetovë aktualisht është lënë anësh si plan i shumë premtuar kurse komuna si zgjidhje për ngarkesën e lartë të komunikacionit premtonte parkime të tjera zonale dhe njëkahëzimin e rrugëve.

"Komunikacioni mbetet një hall i madh i komunës dhe i qytetarëve. Plani jonë është zgjerimi i mëtejme i zonës së parkingjeve që mendojmë se e ulë frekuencën në pjesët qendrore të qytetit" tha Teuta Arifi, kryetare e komunës.

Përveç kësaj, qyteti i Tetovës një kohë të gjatë përballet me mungesë të vendeve të parkingjeve. Mungesa e parkingjeve në anën tjetër ka krijuar një situatë të rëndë pasi që pronarët e automjeteve në mungesë të parkingjeve parkohen edhe nëpër trotualet dhe në vende ku pengojnë qarkullimin normal të automjeteve. Kjo dukuri tashmë është bërë përditshmëri në qytetin e Tetovës. Gjithsej në qytetin e Tetovës ka rreth 500 vende parkimi, në dy lloje parkimi edhe atë parking të hapur dhe të mbyllur, që është shumë pak për një qytet ku me mijëra vetura frekuentojnë rrugët e Tetovës.

Nxënësit e mjekësisë nga Gostivarit shpallen më të mirët në Spanjë

Gostivar, 24 shkurt - Një grup i nxënësve me mentorë profesorë nga shkolla e mesme e mjekësisë në Gostivar, që nga fillimi i këtij muaji qëndrojnë në Madrid ku njoftohen me përvojat e atjeshme duke pasur kështu mundësi të trajnohen në praktikë që do t'u ndihmojë në zhvillim e mëtutjeshëm të karrierës.

Ky grup i nxënësve është shpallur si grupi më i mirë që deri tani ka qenë në trajnim praktik në Shtëpinë e personave të moshuar. Vizita në Spanjë realizohet nëpërmjet Agjencisë Kombëtare për Programe Arsimore Evropiane dhe mobilitet. (U.H)



PROTESTË E BANORËVE TË KOMUNËS SË TEARCËS

Mungesa e sigurisë në rrugë - shqetësuese

Këshilli protestues kërkon vendosjen e pengesave rrugore apo polic të shtrirë, në rrugën regjionale Tetovë Jazhincë, konkretisht në vendbanimin në fshatin Dobrosht



Tetovë, 24 shkurt - Banorët e komunës së Tearcës kanë protestuar të dielën për mungesën e sigurisë në rrugë. Kjom sipas protestuesve, rrugë ka mungesë të sinjalizimit horizontal dhe atij vertikal, gjë kjo që bën vozitësit të tejkalojnë shpejtësinë

Aksidentet e shpeshta të trafikut me pasojë jetë njerëzish, në rrugën regjionale Tetovë - Jazhincë, kanë ngritur sot në protesta banorët e fshatit Dobrosht të komunës së Tearcës, duke bllokuar madje edhe rrugën rajonale regjionale në të dyja anët.

Banorët kërkojnë që organet e rendit dhe Rrugët e Maqedonisë, të marrin masa urgjente duke vendosur pengesa në rrugë dhe duke angazhuar patrulla të rregullta policore me qëllim të vetëdijesimit të vozitësve që çdo ditë vënë në rrezik jetën e banorëve. Kjo rrugë ka mungesë të sinjalizimit horizontal dhe atij vertikal, gjë kjo që bën vozitësit të tejkalojnë shpejtësinë.

Këshilli protestues kërkon vendosjen e pengesave rrugore apo polic të shtrirë, në rrugën regjionale Tetovë

Jazhincë, konkretisht në vendbanimin në fshatin Dobrosht. Si pikë të dytë e kemi patrullimin e rregullt i organeve policore apo policët e trafikut. Si dhe pika e tretë, vendosja e pengesave rrugore në rrugën lokale- deklaroi Fitim Osmani.

Afërsisht në këto 25 viteve të fundit mu në këtë rrugë në fshatin tonë, Dobrosht ka diku afërsisht 17 viktima shkaku i aksidenteve, e mos numërojmë aksidentet me lëndime të lehtë, ato janë të panumërta- thotë një banor i Tearcës. (U.H)



AGJENCIA E PUNËSIMIT
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Nëse jeni person me vizion për biznesin tuaj, me motiv për „jam i zoti i vetvetes“, me energjë për t'u ballafaquar me sfidat, atëherë kjo është Shpallja e vërtetë për ju.

Lexoni dhe mësoni më shumë për mundësitë për të fituar asistencë financiare të pakthyeshme prej 5.000 deri 10.000 euro nga buxheti i Agjencisë për punësim të Republikës së Maqedonisë dhe të themeloni biznesin tuaj.

Për informacione shtesë Ju presim të vini në Qendrën për punësim dhe të kuptoni se për çfarë bëhet fjalë!

Në bazë të Planit operativ për programe dhe masa aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2019 të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për Programin 1.1 Mbështetje për vetëpunësim (Sipërmarrje), e financuar nga Buxheti i Agjencisë për punësim i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me datë 25.02.2019, shpall

NJOFTIM PUBLIK
për
persona të papunësuar

- Inkurajohen personat e papunësuar dhe frymëzohen për sipërmarrje, me vizion për të themeluar biznesin e tyre, të aplikojnë në **Programin për Mbështetje të Vetëpunësimit (Sipërmarrje)**.
-Ftohen të gjithë personat e papunësuar, persona të papunësuar të rinj deri në moshën 29 vjeç, persona të papunësuar me invaliditet, femra të papunësuar që u përkasin grupeve të rrezikuara, të cilët duan ta zgjidhin çështjen e punësimi të tyre përmes mbështetjes financiare me Programin për Mbështetje të Vetëpunësimit (Sipërmarrje), të lajmërohen në klubet e punës të APRMV-së për të aplikuar për pjesëmarrje në program.
- Mbështetja financiare përmes **Programit për Mbështetje të Vetëpunësimit (sipërmarrje)** përfshin:
-**Mbështetje profesionale** në formë të **trajnitimit për sipërmarrje** dhe udhëheqje të biznesit, sistem vauçeri për **hartimin e planit të biznesit** dhe mbështetje gjatë regjistrimit të biznesit;
- **Mbështetje këshillëdhënëse/mentorim** për Biznes planet nga IN-grupi (grupi i aplikantëve me potencial për themelimin e bizneseve inovative gjegjësisht bizneseve me rritje të shpejtë) dhe ndihmë gjatë përpunimit të propozim projektit për financim dhe përkrahje të mëtutjeshme nga Fondi për Inovacioni dhe zhvillim teknologjik.
-Mjete të pakthyeshme (grant) në shumë prej **246.000 deri 307.500 denarë** për shfrytëzues ose deri në **615.000 denarë** nëse themelohet subjekt juridik nga ana e dy partnerëve si SHPK-Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nga dy persona, me ç' rast secili nga partnerët ka pjesë të barabartë (50%) në shoqëri.
- Subjektet juridike të themeluara nga ana e personave me invaliditet kanë mundësi për grant plotësues për punësim të 2 (dy) personave në shumë prej 92.000,00 për punësim personave me moshë mbi 29 vjeç ose 153.750 denarë për punësim të personave deri 29 vjeç, në pajtim me kushtet e cekura në marrëveshje;
- **Mbështetje këshillëdhënëse/mentorim** për një periudhë kohore 12 mujore nga themelimi i biznesit (gjithsej 120 orë mentorim) do të sigurohet nga Fondi për inovacione dhe zhvillim teknologjik për aplikantët e selektuar në "IN-grupin" (aplikant me potencial për themelimin e bizneseve inovative gjegjësisht të ndërmarrjeve me zhvillim të shpejtë).
- **Mbështetje këshillëdhënëse/mentorim** për një periudhë kohore 12 mujore nga themelimi i biznesit (gjithsej 120 orë mentorim) do të sigurohet edhe për këta qëllim grupe :
o Persona me invaliditet
o Persona të përkatësisë etnike rome
o Femra të "rrezikuara" (shfrytëzues të ndihmës sociale, viktima të dhunës familjare, viktima të tregtisë me njerëz, nëna vetëmbajtëse dhe femra që kanë mbetur pa punë për shkak se janë shpallur tepriç teknologjike ose për shkak falimentimi të ndërmarrjes.
- Personat e interesuar për pjesëmarrje në Program mund të aplikojnë deri në plotësimin e numrit të kandidatëve të planifikuar.
- Në këtë program mund të përfshihen edhe personat e papunësuar të cilët kanë kryer trajnimin për sipërmarrje dhe/ose kanë hartuar plan për biznes në vitin 2018.
- Personat të cilët kanë fituar grant për Vetëpunësim gjatë 5 viteve të kaluara **nuk kanë të drejtë aplikimi** për pjesëmarrje në Program.
- Përmes këtij Programi nuk do të përkrahët themelimi i bizneseve për veprimtaritë në vijim:
- Veprimtari bujqësore, gjegjësisht nga Sektori A/A, Departament 01 – Prodhimtari e bimëve dhe kafshëve, gjueti dhe shërbime të tjera që lidhen me këto veprimtari, me përjashtim të prodhimtarisë organike bujqësore;
- Biznese në veprimtari të klasës 49.32 - Taksi shërbime;
- Prodhimtari dhe shpërndarje të armëve, respektivisht veprimtari të klasës 25.40 – Prodhimtari të armëve dhe municionit;
- Biznese dhe aktivitete financiare dhe sigurimi që përfshijnë lojëra fati, respektivisht veprimtari nga Sektori K/I- Veprimtari financiare dhe veprimtari të sigurimit.
Me përjashtim, personat të papunësuar me invaliditet dhe personat e papunësuar nga komuniteti rom mund të regjistrojnë subjekt juridik me aktivitet bujqësor dhe taksit shërbim.
- Të drejtat dhe obligimet mes APRMV-së, UNDP-së dhe pjesëmarrësve, do të rregullohen në bazë të marrëveshjes së përbashkët.

Fletëparaqitja për pjesëmarrje duhet të dorëzohet në klubet e punës pranë qendrave të punësimi, çdo ditë pune prej 09:00 -14:00. Të gjithë të interesuarit mund të marrin informata të hollësishme në klubet e punës të 30 Qendrave për punësim të Agjencisë së Punësimi të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kontakt qendra 02-3111-850 dhe ueb faqet www.av.gov.mk dhe www.robotaimoznosti.mk.

AGJENCIA E PUNËSIMIT
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



AGJENCIA E PUNËSIMIT
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të Planit operativ të programeve dhe masave aktive të punësimi dhe shërbimeve në tregun e punës gjatë vitit 2019, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për masën aktive 2.1 Subvencionim i rrogave, e financuar nga buxheti i Agjencisë së Punësimi të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më datën 25.02.2019, bën

SHPLLJE PUBLIKE
për

punëdhënësit që të përfshihen në masën e subvencionimit të rrogave

- U bëhet thirrje punëdhënëseve të mikro firmave, atyre të vogla dhe të mesme, që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, por që kanë nevojë për punësim të personave adekuatë, të paraqiten në klubet e qendrave të Agjencisë së Punësimi të Republikës së Maqedonisë, çdo ditë pune prej orës 09:00 deri 14:00.
- Programi nuk i përfshin punëdhënësit e institucioneve shtetërore, publike, njësjive të vetadministrimit vendor dhe qytetit të Shkupit.
- Programi nuk do t'i mbështesë subjektet juridike të regjistruara pas datës 01.07.2017.
- Në këtë masë kanë të drejtë marrin pjesë punëdhënësit të cilët:
- numri i përgjithshëm i punëtorëve në ditën e aplikimit dhe para realizimit të mbështetjes nuk është më i vogël se numri mesatar i personave të punësuar në kohë të pacaktuar në vitin e mëparshëm kalendarik;
- që i kanë shlyer detyrimet në bazë të rrogave të paguara dhe kontributeve të sigurimit të detyruar social;
- që nuk kanë humbje financiare gjatë vitit paraprak;
- punëdhënësi duhet të ketë së paku një person të punësuar me kohë ta pacaktuar në vazhdimësi, më së paku gjashtë muaj para aplikimit, me përjashtim të organizatave qytetare të cilat në momentin e aplikimit nuk kanë të punësuar;
5. Numri i personave të cilët punëdhënësi mund t'i punësojë nëpërmjet programit të subvencionimit të rrogave, nuk mund të jetë më i madh se 50 për qind se numri mesatar i personave të punësuar gjatë vitit të mëparshëm kalendarik. Punëdhënësi i cili ka punësuar një person dhe të organizatave qytetare të cilat nuk kanë punësuar asnjë person, më së shumti mund të mbështetet vetëm me një person të punësuar.
6. Punëdhënësi do të mbështetet financiarisht nga Agjencia e Punësimi të Republikës së Maqedonisë në një shumë prej 19.000,00 në muaj në një periudhë prej 3, 6 dhe 12 muaj për person të punësuar, prej të cilëve 18.000,00 si subvencion të rrogës për personin e punësuar dhe 1.000,00 denarë për harxhimet e bëra lidhur me përgatitjen e personit në procesin e punës. Punëdhënësi mundet që punëtorit t'i paguajë rrogë edhe më të lartë.
7. Punëdhënësi i cili punëson personin e papunë është i detyruar që ta mbajë atë në marrëdhënie pune pas mbarimit të subvencionimit në një periudhë prej:
- gjatë muaj plotësues nëse shfrytëzohet tre muaj subvencionim (periudha e përgjithshme e punësimi është nëntë muaj);
- 12 muaj plotësues nëse shfrytëzohet subvencionim (periudha e përgjithshme e punësimi është 18 muaj);
- 18 muaj plotësues nëse numri i përgjithshëm i subvencionimit është 12 muaj (periudha e përgjithshme e punësimi është 30 muaj).
8. Kushtet, të drejtat dhe detyrimet do të jenë të përcaktuara me nënshkrimin e marrëveshjes së subvencionimit ndërmjet Agjencisë së Punësimi të RM-së, punëdhënëseve dhe kandidatëve.
9. Punëdhënësit e interesuar mund të aplikojnë deri në plotësimin e numrit të paraparë të shfrytëzuesve.

Informata më të hollësishme mund të merren në klubet e 30 qendrave të Agjencisë së Punësimi, në tel. 02/3111-850 lokali 223, si dhe ueb faqen www.avrm.gov.mk

AGJENCIA E PUNËSIMIT
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



AGJENCIA E PUNËSIMIT
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të Planit operativ të programeve dhe masave të punësimi dhe shërbimeve në tregun e punës për vitin 2019, e miratuar nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për masën aktive 3.1 Trajnimi në vendin e punës për punëdhënësit të njohur Agjencia e Punësimi të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më datën 25.02.2019, bën

SHPLLJE PUBLIKE

Për punëdhënësit

U bëhet thirrje punëdhënëseve të cilët kanë nevojë të punësojnë persona adekuat pas realizimit paraprak të trajnitimit në kohëzgjatje prej tremujsh, që të paraqiten në klubet e qendrave të Agjencisë së Punësimi të RMV, çdo ditë prej orës 9,00 deri më 14,00.

Programi nuk i përfshin punëdhënësit nga institucionet shtetërore, publike, njësjive të vetadministrimit lokal dhe Qytetin e Shkupit.

Kandidatët e zgjedhur do t'i nënshtohen një trajnimit tremujor. Trajnimi për personat e papunë do të mbahet në hapësirat e punës së punëdhënëseve, në përputhje me programin e stërvitjes së propozuar nga ana e punëdhënëseve dhe pjesëmarrësve të stërvitjes do t'u jepet vërtetim për realizimin e stërvitjes.

Kjo masë do të përfshijë persona të papunë, kërkues aktiv të punës të evidentuar në regjistrin e Agjencisë së Punësimi të cilët kanë mbaruar minimum arsimin fillor.

Në këtë masë kanë të drejtë të marrin pjesë punëdhënësit të cilët:

- Numrin e përgjithshëm të të punësuarve në kohë të pacaktuar në ditën e aplikimit dhe para realizimit të mbështetjes nuk duhet ta kenë më të vogël se numri mesatar i të punësuarve në kohë të pacaktuar në vitin e kaluar kalendarik, përveç në raste kur shkak i ndërprerjes së marrëdhënies së punës ka ndodhur me fajin dhe vullnetin e punëtorit, shfrytëzimi i të drejtës për pensionim, vdekje, paafësi për punë, por jo si rezultat i shkaqeve afariste;
- Kanë të punësuar së paku një person në kohë të pacaktuar, me përjashtim të organizatave qytetare, si dhe punëdhënësit të cilët do të angazhojnë gra prej komunitetit rom në stërvitje.
- Në ditën e aplikimit t'i kenë shlyer të gjitha obligimet e pagave dhe kontributeve të sigurimit të obligueshëm social dhe
- Nuk kanë punuar me humbje në vitin e kaluar.
- Numri i të angazhuarve në trajnim nuk duhet të jetë më i madh se 50% prej numrit të përgjithshëm të personave të punësuar në kohë të pacaktuar, me përjashtim të organizatave qytetare, si dhe punëdhënësit të cilët do të angazhojnë gra prej komunitetit rom në stërvitje.

Personi i papunë do të marrë pagesë me të holla prej 9.000,00 denarë në muaj, duke përfshirë këtu edhe sigurimin në rast fatkeqësie gjatë punës dhe sëmundjes profesionale. Punëdhënësi është i detyruar të dorëzojë në APRMV listën e evidentimit të pjesëmarrjes.

Punëdhënësi (mentori) është i detyruar që ta realizojë programin e stërvitjes në përputhje me planin e vërtetuar për këtë. Punëdhënësi do t'i paguhet një shumë paushale e përmjeshme për mentorim, si dhe për harxhime materiale një shumë prej 5.000,00 denarë për person të stërvitur pas mbarimit të trajnitimit, me përjashtim për shfrytëzuesit ndihmës minimale të garantuar e cila do të paguhet 10.000,00 denar për person të stërvitur pas mbarimit të trajnitimit.

Punëdhënësi është i detyruar që t'i mbajë në punë më së paku 50 për qind të personave të stërvitur dhe të mos e zvogëlojë numrin e përgjithshëm të personave të punësuar për kohë të pacaktuar me orar të plotë pune në një periudhë prej gjashtë muajsh.

Kushtet, të drejtat dhe detyrimet do të përcaktohen me nënshkrimin e marrëveshjes për trajnim ndërmjet Agjencisë së Punësimi të RM-së, punëdhënëseve dhe kandidatëve.

Punëdhënësit e interesuar fletëparaqitje mund të dorëzojnë deri në pëmbushjen e plotë të numrit të paraparë në përputhje me këtë program.

Për informata më të hollësishme vizitoni klubet për punësim në qendrat e punësimi, si dhe ueb faqet si vijojnë:

Agjencia e Punësimi të RMV: www.av.gov.mk

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale: www.mtsp.gov.mk

AGJENCIA E PUNËSIMIT
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



AGJENCIA E PUNËSIMIT
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të Planit Operativ të programeve dhe masave aktive dhe shërbimeve në tregun e punës për vitin 2019, e miratuar nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për masën aktive 2.1 Subvencionim i rrogave, e financuar nga buxheti i Agjencisë së Punësimi të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më datën 25.02.2019 bën

SHPLLJE PUBLIKE
për

personat e papunë

- U bëhet thirrje të gjithë personave të evidentuar në APRMV të cilët më veshitë inkuadrohen në tregun e punës :
- persona të papunë në një periudhë më të gjatë (mbi 12 muaj)
- persona deri në moshën 29 vjeçare ;
- persona më të moshuar mbi 50 vjeç ;
- persona shfrytëzues të asistencës sociale ose kompensimit në para për të papunësuarit ;
- persona shfrytëzues të Programit kompensim i kushtetuar në para për arsimin e mesëm;
- persona që kanë pasur status të femijëve pa prindër dhe përkujdestje prindërore;
- viktimat e dhunës familjare ;
- persona me invaliditet ;
- femra të përkatësisë etnike rome dhe bashkësi tjera etnike
- persona të përkatësisë etnike rome;
- prindër vetëmbajtës;
- prindër të femijëve me nevoja të posaçme;
- çifte bashkëshortore me tre ose më tepër femijë;
- prindër të femijëve në rrugë;
- persona të dënuar, por të liruar nga institucioni për dënim dhe rehabilitim ;
- persona endacak ;
- ish shfrytëzues të lëndëve narkotike;
- persona pa arsim të mesëm ose më të ulët;

të paraqiten në klubet e punës së Qendrave të punësimi të APRMV-së ku rregullisht evidentohen si të papunë .
2. Çdo punëdhënësi që do të punësojë persona të papunë nga qëllim grupet e lartpërmendura, do të fitojë mbështetje financiare për pagesën e bruto rrogës mujore në vlerë prej 19.000,00 denarë, për periudhën prej 3, 6 ose 12 muajve. Punëdhënësi ka të drejtë këyre të punësuarve të ju paguajë bruto rrogë mujore më të lartë se vlera e subvencionuar.

3. Punëdhënësi që do të punësojë një person të papunë me subvencionim, ka për obligim personin ta mbajë në marrëdhënie pune edhe pas mbarimit të subvencionimit në kohëzgjatje prej 6, 12 ose 18 muaj ;

4. Kushtet, të drejtat dhe obligimet më konkrete të Agjencisë së punësimi të RMV, punëdhënëseve dhe kandidatëve do të rregullohen me nënshkrimin e një kontrate ndërmjet tyre .

5. Personat e papunë mund të aplikojnë për pjesëmarrje në këtë masë aktive deri në plotësimin e numrit të planifikuar sipas Planit Operativ.

Informata të hollësishme mund të merren në klubet e punës së 30 qendrave të punësimi të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kontakt telefoni 02-3111-850 dhe ueb faqja www.av.gov.mk.

AGJENCIA PËR PUNËSIM E REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË SË VERIUT



AGJENCIA E PUNËSIMIT
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të Planit operativ të programeve dhe masave aktive të punësimi dhe shërbimeve në tregun e punës gjatë vitit 2019, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për masën aktive 5.Prakticitetit, të financuar nga buxheti i Agjencisë së Punësimi të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më datën 25.02.2019, bën

SHPLLJE PUBLIKE
për

pjesëmarrjen e punëdhënëseve në masën e praktikitetit

- U bëhet thirrje punëdhënëseve të interesuar, të cilët kanë nevojë për angazhimin e të rinjve të papunë deri në moshën 34 vjeç, të cilët janë të evidentuar si të papunë në APRMV, së paku që kanë mbaruar arsimin fillor dhe të cilët nuk kanë përvjeje pune në përputhje me profilin arsimor, që të paraqiten në klubet e qendrave të Agjencisë së Punësimi të RMV-së, çdo ditë pune prej orës 9,00 deri më 14,00.
- Të drejtë për pjesëmarrje kanë punëdhënësit të cilët :
- I takojnë sektorit privat ose sektorit qytetar ;
- Që kanë së paku një person të punësuar në kohë të pacaktuar, së paku gjashtë muaj para aplikimit, me përjashtim të organizatave qytetare dhe punëdhënëseve të cilët do të angazhojnë femra të përkatësisë etnike rome si praktikante;
- T'i kenë të paguara obligimet e rrogave mujore dhe kontributeve të sigurimit social obligativ .
- Kohëzgjatja e trajnitimit gjatë praktikitetit do të jetë deri tre muaj.
- Secili kandidat që që do të zgjidhet nga ana e punëdhënësit pas intervistës së realizuar paraprakisht, do të mbështetet financiarisht nga Agjencia e Punësimi të Republikës së Maqedonisë së Veriut në një shumë prej 9.000,00 denarë në muaj (duke përfshirë edhe tatimin personal për të ardhurat dhe sigurimin në rast fatkeqësie gjatë punës dhe sëmundjes profesionale) për periudhën që kryhet trajnimi praktik.
- Punëdhënësit e interesuar për pjesëmarrje në këtë masë aktive kanë mundësi të aplikojnë deri në plotësimin e numrit të paraparë të shfrytëzuesve . 6. Shpallja publike do të jetë e hapur deri në plotësimin e numrit të paraparë të shfrytëzuesve.
- Kushtet, të drejtat dhe detyrimet do të përcaktohen me nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet Agjencisë së Punësimi të RMV-së, punëdhënëseve dhe kandidatëve.

Informata më të hollësishme mund të merren në klubet e 30 qendrave të Agjencisë së Punësimi, në tel. 02/3111-850, si dhe ueb faqen www.av.gov.mk

AGJENCIA E PUNËSIMIT
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Aeroporti i Rinasit po bëhet gjithnjë e më i zënë, teksa më shumë shqiptarë po udhëtojnë dhe të huajt që po vijnë për të kaluar pushimet në vend shtohen. Në 2018-n, trafiku në Aeroportin e Rinasit shënoi nivel rekord prej 2.95 milionë pasagjerësh, sipas të dhënave nga Tirana International Airport (TIA). Në raport me vitin e mëparshëm, numri i pasagjerëve është rritur me rreth 12%.

BETEJA PËR AJRIN E SHQIPËRISË

Rreth 7% më shumë shqiptarë udhëtuan nga dhe drejt Rinasit në 2018-n, në krahasim me vitin e mëparshëm, sipas shifrave të INSTAT. Por, lulëzim të vërtetë shënuan të huajt, trafiku i të cilëve në hyrje e dalje u rrit me 27%, pas zgjerimit me 29% të vitit të mëparshëm, duke e bërë periudhën 2017-2018 më të mirën në historinë e pas tranzicionit për ardhjen e turistëve.

Fluksi i pasagjerëve me charter u rrit me 64% në 2018-n, ku ndikimin kryesor e dhanë linjat nga Polonia, Norvegjia, Izraeli, Ukraina, Çekia, Suedia, teksa agjencitë turistike në bashkëpunim me ato shqiptare sollën turistë në hotelet shqiptare, kryesisht në bregdetin e Durrësit, duke futur për herë të parë në mënyrë masive konceptin e "all inclusive" ose "half board".

Gjithsesi, Italia, ku jetojnë një pjesë e madhe e emigrantëve shqiptarë, vijon të dominojë më shumë se gjysmën e tregut të fluturimeve, sipas numrit të pasagjerëve.

GARA E KOMPANIVE AJRORE

Pas falimentimit të Belle Air, në fund të vitit 2013, e cila zinte më shumë se 50% të tregut të fluturimeve ajrore me destinacionet direkte drejt Italisë, tregu është rikonfiguruar, por Italia vijon të mbetet destinacioni kryesor. Fillimisht ishte Allitalia, që operonte prej vitesh dhe Blue Panorama që hyri e re, të cilat zunë vendin e Belle Air dhe më pas hynë në treg Alba Wings dhe Fly Ernest.

Në fund të vitit 2018, sipas të dhënave nga TIA, Blue Panorama, kishte 24% të tregut total të flutu-

BETEJA PËR AJRIN

DESTINACIONET KRYESORE KU FLUTUROJNË SHQIPTARËT

Gara për ajrin është ashpërsuar në vitin 2018. Italia vijon të dominojë më shumë se gjysmën e tregut. Rritje të ndjeshme shënuan charter-at, të nxitur nga kthimi i Shqipërisë në destinacion të preferuar turistik dhe Londra e Budapesti, nga hyrja e linjave low cost...



rimëve, nga 29% vitin e mëparshëm. Pas saj, në vend të dytë ka kaluar Fly Ernest, me 13% të tregut (nga 6% në 2017-n). Në vend të tretë ka kaluar Alba Wings, me 10% të tregut, e cila ka menaxhim të njëjtë me Blue Panorama. Më pas renditet Allitalia, që një vit më parë ishte e dyta, me 9% të totalit. Allitalia ka humbur vazhdimisht terren dy vitet e fundit, pasi ka shkurtuar linjat direkte me disa qytete të Italisë, ndërsa destinacioni kryesor i saj tashmë është Roma, e cila shërben edhe për qëllime tranziti. Në vitin 2015, kjo kompani zinte 31% të tregut.

Ndërsa operatorët low cost kanë arritur të fitojnë terren në tregun e Italisë, këtë e kanë bërë në kurriz të cilësisë së shërbimit ndaj pasagjerëve. Të dhënat e Autoritetit të Aviacionit Civil bëjnë të ditur se kompania më problematike, me numrin më të lartë të anulimeve dhe vonesave të fluturimeve është Fly Ernest, e ndjekur nga Blue Panorama, Adria dhe Albawings.

Sa u përket vonesave të gjata,

mbi 7 orë, problematike mbetet kompania Fly Ernest e ndjekur nga Blue Panorama. Nga të dhënat që na vijnë nga përgjegjësja e Sektorit për të Drejtat e Pasagjerit në AAC, znj. Enkela Hajderi, një aspekt problematik që lidhet me mosrespektimin e të drejtave të pasagjerëve është me kompaninë Fly Ernest, e cila ka një numër shumë të ulët të kompensimeve të pasagjerëve. Kompania që respekton më shumë pasagjerët në aspektin e kompensimeve është Blue Panorama, me rreth 500 të tilla. Ndërkohë, kompanitë më serioze që respektojnë oraret janë Turkish Airlines, Austrian Airlines, Allitalia, Lufthansa, British Airways, Aegean. Destinacionet drejt Italisë zinin 56% të tregut total të fluturimeve në vitin 2018, me një ulje të lehtë me 1 pikë përqindjeje në krahasim me një vit më parë.

Më pas renditet Turkish Airlines, që ka mbajtur peshën e pandryshuar të tregut në 7%. Në rënie të lehtë ishte Austrian Airlines, që ka zbritur me 2 pikë përqindjeje në

5% të tregut. Lista vijon me British Airways, me 4% të tregut (rritje me një pikë përqindjeje në krahasim me një vit më parë), po me nga 4% janë Aegean Airlines dhe Adria Airways dhe më pas me nga 3% secila, Wizz Air dhe Pegasus Airlines. Renditja mbyllet nga Lufthansa, Jetairfly, Air Serbia, me nga 2% dhe Transavia e Mistral Air me 1%. Fluturimet charter kanë transportuar 5% të totalit të pasagjerëve në 2018-n.

DESTINACIONET, KRYESON ROMA

Destinacioni kryesor ku udhëtohet nga dhe drejt Rinasit vijon të jetë Roma, me 329 mijë pasagjerë në 2018-n, me rritje prej 1.8% me bazë vjetore. Roma shërben jo vetëm si destinacion direkt, por edhe si tranzit për të udhëtuar në Europë dhe jashtë saj. Destinacioni i dytë është Milano, me 283 mijë pasagjerë, me rritje 6% në raport me një vit më parë. I treti është Bergamo, me 143 mijë pasagjerë (rritje 15%). Destinacionet italiane që

kanë parë rritjen më të madhe të trafikut të pasagjerëve janë Verona dhe Bolonja, me nga rreth 20% secila, ndërsa më pak i preferuar për t'u arritur me avion ka qenë Bari, që ka parë rënie vjetore prej 35%. Në total, pasagjerët nga dhe drejt Italisë ishin gati 1.56 milionë në vitin 2018 (rritje 6%). Stambolli është në vend të tretë, me 264 mijë pasagjerë (12.5% rritje). Stambolli është bërë konkurrues vitet e fundit si një destinacion tranzit, kryesisht vendeve aziatike, por dhe destinacioneve të tjera të Europës dhe atyre të largëta.

ROMA, E PREFERUARA E SHQIPTARËVE

Destinacioni kryesor ku udhëtohet nga dhe drejt Rinasit vijon të jetë Roma, me 329 mijë pasagjerë në 2018-n, me rritje prej 1.8% me bazë vjetore. Roma shërben jo vetëm si destinacion direkt, por edhe si tranzit për të udhëtuar në Europë dhe jashtë saj.

Vjena e ka humbur disi rëndësinë, si një nga pikat pika kryesore të kalimit drejt së gjithë Europës e jashtë saj. Në vitin 2018, nga dhe drejt Aeroportit të Vjenës udhëtuan rreth 168 mijë pasagjerë, duke shënuar për herë të parë rënie me rreth 4%, si rrjedhojë e rritjes së konkurrencës për tranzite nga Lufthansa, apo Turkish Airlines. Pas operimit të dy linjave direkte British dhe Wizz Air, Londra është bërë një destinacion i preferuar, me 143 mijë pasagjerë në 2018-n, me një rritje prej 15.3%.

Nga dhe drejt Athinës kanë udhëtuar rreth 100 mijë pasagjerë, me një rritje të ndjeshme prej gati 20%. Nga dhe për në Budapest, nga ku filloi fluturimet Wizz Air në 2017-n, udhëtuan rreth 49 mijë pasagjerë një vit më parë, me një rritje prej 70%. Për shkak të biletave të lira, Budapesti është shndërruar në një destinacion të preferuar turistik për shqiptarët, duke qenë një nga më të kërkuarit për kalimin e natës së ndërrimit të viteve. Amsterdami, një destinacion i ri i nisur në 2017-n ka parë rritje të ndjeshme edhe në 2018-n, me 40 mijë pasagjerë, me rritje 44%. / Monitor.al

RAPORT I BANKËS POPULLORE TË MAQEDONISË

Analizuar në baza vjetore, norma e rritjes së kredisë arriti në 7.8% dhe në pjesën më të madhe vjen nga rritja e kredive të miratuara për sektorin e amvisërisë"

Koha Qefsere ABDYLI

Shkup, 24 shkurt - Depozitat në muajin janar janë ulur me 0.8% në baza mujore, për shkak të një rënieje në depozitat e sektorit të korporatave dhe një rënie të moderuar të depozitave familjare.

Depozitat dhe kreditë në janari janë ulur

Çdo vit, sipas Bankë Popullore të Maqedonisë, ka një rritje prej 10.6% dhe është rezultat i rritjes në të dy sektorët.

"Pas rritjes së lartë sezonale në muajin dhjetorë, kreditë e përgjithshme në muajin janar u ulën me 0.8% në baza mujore. Në kushtet e rritjes së kreditimit të sektorit të ekonomive familjare, rënia mujore në total u ngrit nga kreditimi i reduktuar në sektorin e korporatave, i cili regjistroi një rritje të konsiderueshme në muajin e kaluar. Analizuar në baza vjetore, norma e rritjes së kredisë arriti në 7.8% dhe në pje-

sën më të madhe vjen nga rritja e kredive të miratuara për sektorin e amvisërisë", tregojnë nga BPRM.

Në sektorin e korporatave në muajin janar u regjistrua ndryshim mujor prej 2.6% i cili sipas BPRM-së kryesisht vjen nga rënia e parave të depozitave dhe në një masë më të vogël nga rënia e depozitave afatshkurtra në denarë dhe depozitat afatgjata në valuta.

Në janar, kreditë për sektorin e korporatave regjistruan një rënie mujore prej 1.9%, ndërsa krahasuar me një bazë vjetore,

ato u rritën me 5.7%. Kreditë në denarë kanë kontributin më të madh në rënien mujore, pra në rritjen vjetore.

Depozitat e përgjithshme të amvisërisë regjistruan rënie mujore prej 0.5%, e cila, sipas njoftimit, është tërësisht për shkak të tenies së parave të depozitave, në kushtet e rritjes së depozitave me afat në denarë dhe në valuta të huaja.

Analizuar nga aspekti i strukturës së parasë, u arrit një normë vjetore e rritjes prej 9.3% e cila rezultoi nga rritja e depozitave në denarë dhe në valutë, me një

kontribut më të rëndësishëm të depozitave në denarë (57.4).

Në muajin janar, kreditë e makinave kanë një rritje mujore dhe vjetore prej 1% dhe 1.1% respektivisht, ndërsa kreditë e miratuara në kartat e kreditit tregojnë një ndryshim në rënie mujore dhe vjetore prej 0.6%.

Ky muaj, bilancet negative në llogaritë rrjedhëse shënuan rritje vjetore mujore prej 9.2% dhe 4.8%, ndërkohë që kreditë e miratuara në bazë të tjera regjistruan një rënie mujore prej 0.5, me një rritje vjetore të njëkohshme prej 1.6%.

Politika, arti i llafollogjisë

Alber VATAJ

TEKNIKAT

Dy nga teknikat e përdorura për të ndaluar miratimin e ligjeve të padëshiruara kur nuk ke shumicën për t'i rrëzuar ato, janë: a) fjalimet tepër të gjata dhe të pakuptimta dhe b) propozimi i mijëra amendamenteve për ligjin në diskutim, gjë që e bën thujtë të pamundur përfundimin e procedurës, pasi vetëm leximi i amendamenteve të propozuara kërkon shumë kohë. Këto teknika përdoren në vende normale. Në Shqipëri, në një rast është përdorur një teknikë më pak normale, kur opozita ia doli me dhunë të bllokojë foltoren e Parlamentit gjatë diskutimeve për reformën zgjedhore disa vite më parë. Mazhoranca i mblodhi deputetët e vet në një sallë tjetër dhe e konsideroi ligjin të miratuar.

DEPUTETËT QË ARRITËN TË FLASIN 24 ORË PA NDËRPRERJE

Fjalimet për të humbur kohën, të njohura si filibaster, ndoshta do të kthehen një herë në politikën amerikane. Po si mund t'ia dalë dikush të flasë gjithë ditën?

Ti ngrihesh para kolegëve tuaj, kruan fytyrën dhe përgatitesh për të folur. Përgjatë të gjithë natës, pa pushim. Ndoshta ke sjellë ushqim me vete, ose ke ndonjë adresar telefonik, të cilin e lexon me zë të lartë, në rast se nuk të vijnë më ide se çfarë mund të thuash. Dhe nuk ke mundësi të shkosh në banjë, nëse ke nevojë, duhet të vijosh të flasësh. Filibasting – një taktikë që synon të harxhojë qëllimisht kohën e Parlamentit, përdoret zakonisht nga ligjvënësit për të mos lejuar zhvillimin e një votimi për një çështje që ligjvënësi e di se e ka të humbur. Kjo metodë është përdorur në sistemet demokratike që nga kohët që nuk mbahen mend. Parlamentarë të daluar e kanë përdorur shpesh këtë taktikë duke realizuar sipërmarrje mbinjerëzore, vetëm me synimin për të humbur kohë, ngadalësuar apo bllokuar miratimin e një ligji.

Shembujt më spektakolarë janë hasur në Senatin e Shteteve të Bashkuara. Më 1935, një demokrat nga Luiziana, Huey Long, u përpoq të ndalonte një ligj duke folur për më shumë se pesëmbëdhjetë orë, duke recituar mes të tjerash, edhe receta për garniturë sallate dhe duke diskutuar në detaje si të fërgohen më mirë gocat e detit. Njëzet e dy vjet më vonë, një senator veteran nga Karoli-

na e Jugut, Strom Thurmond, vendosi një rekord në llafollogji duke ndaluar miratimin e një ligji për të drejtat, duke folur për 24 orë e 18 minuta, duke lexuar me zë të lartë ligjet e votimit të secilit shtet të SHBA-së dhe duke cituar fjalën e lamtumirës së George Washinton në mënyrë integrale.

Filibaster është një fjalë me rrënjë holandeze, "vrijbouter", dhe në kuptimin origjinal do të thotë "pirat". Kjo është një taktikë kaq e rëndësishme në sistemin politik amerikan sa filmi i vitit 1939 i Frank Capra, "Zoti Smith shkon në Uashington", paraqet heroin James Stewart, duke mbajtur një fjalim llafollogjik të stërgjatë në Senat, gjë që shpëton Amerikën përmes ekspozimit të korrupsionit politik.

Gjatë viteve të fundit, anëtarët e senatit amerikan kanë qenë në gjendje të kryejnë një teknikë që quhet "filibasteri i heshtur". Në këtë rast, ata thjesht sinjalizojnë synimin për të bllokuar një ligj për sa kohë mbështetësit e ligjit nuk janë në gjendje të sigurojnë tri të pestat e senatit. Por Harry Reid, udhëheqësi i shumicës demokrate, i cili vetë mbajti foltoren për gati nëntë orë në vitin 2003, tashmë kërkon që çdokush që

ka një kundërshti të ngrihet dhe të deklarojë kundërshtinë ndaj në ligj në rast se dëshirojnë ta bëjnë një gjë të tillë. Kjo nënkupton një kthim në debatet e viteve 1950 dhe 1960, kur politikanët e jugut si Strom Thurmond dhe Robert Byrd flisnin përgjatë të gjithë natës për të mos lejuar miratimin e ligjeve që u jepnin të drejta të barabarta njerëzve me ngjyrë.

Në rast se kjo ndodh, një gjeneratë e re ligjvënësish do të duhet të thërrasin në ndihmë rezervat e pashfrytëzuara të qëndresës fizike – megjithëse ka gjasa që nuk do t'u pëlqejë t'i krahasojnë me llafollogjinë rekordthyesë të Thurmond, i cili me këtë teknikë synoi të ruajë segregacionin racor në SHBA. Sipas biografisë të Thurmond, Joseph Crespino, një profesor historie në Universitetin Emory, politikani mbrojtës i segregacionit – i cili vdiq në zyrën e tij në vitin 2003 në moshën 100 vjeç – qe jashtëzakonisht i përgatitur fizikisht për një sipërmarrje të tillë.

Thurmond kishte marrë me vete furnizime – përfshirë një copë të madhe bukë elbi, një copë mishi kundërfiletë, tableta qetësimi, lëng frutash e ujë, thotë Crespino. Senatori foli në një mënyrë të qetë dhe mo-

Fjalimet për të humbur kohën, të njohura si filibaster, ndoshta do të kthehen një herë në politikën amerikane. Po si mund t'ia dalë dikush të flasë gjithë ditën?



notone për të kursyer zërin e tij nga mekja. Me përjashtim të një pushimi gjysmë ore në fillim, kur rregullat i lejonin atij t'i linte vendin senatorit tjetër, Barry Goldwater, Thurmond qëndroi në këmbë në foltoren e Senatit përgjatë të gjithë kohës. Për historianët, aspekti më habitës i kësaj sipërmarrjeje është se si ia doli të shmangë vajtjen në tualet për kaq shumë kohë. "Kjo është një lloj misteri urologjik se si ai ia doli ta bëjë një gjë të tillë", thotë Crespino. "Pas fjalimit, pyetja e parë që i bënë gazetarët qe se si ia doli të mbajë urinën pa i shpëtuar." Thurmond u tha atyre se kishte vizituar dhomën e avullit të senatit para fjalimit për të dehidratuar veten, në mënyrë që trupi i tij të qe në gjendje të absorbonte lëngje si një "sfungjer". Por thashethemet qenë të shumta dhe thoshin se kishin përdorur një metodë shumë më praktike dhe hileqare. Një punonjës i senatit afro-amerikan, me emrin Bertie Browman deklaroi në kujtimet e veta se në fakt senatori qe pajisur me një tub dhe një qese.

Ndërsa në SHBA mund të jetë vendosur rekordi botëror për llafollogji gjatë shekullit të njëzetë, praktika ka një histori të gjerë në të gjithë botën. Në Romën e Lashtë, Kato i Riu,

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përtheshë, Shkup | Gazelë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Sloboden Pecat" - rr. Kej 13 Noemvri nr.3/1-238, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel, 24 shkurt 2018 | Numri i parë i gazelës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjigjës: Emin AZEMI | Ndhimëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI • Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772



arrinte të irritonte Senatin në rastet e diskutimit të ligjeve që ai nuk i pëlqente, duke vijuar të flasë derisa binte nata. Në Senatin e Romës që e ndaluar me ligj që Senati të merrte vendime pas Perëndimit të diellit, në mënyrë që të shmangeshin tentativat për komplete, apo organizim seancash pa dijeninë e të gjithë senatorëve.

Fjalimi më i gjatë në dhomën e ulët të Parlamentit të Anglisë, që një maratonë që zgjati për gjashtë orë nga Henry Brougham, më 1828. Por kjo në fakt nuk që një filibaster për të harxhuar kohë e për të ndaluar miratimin e një ligji. Në anën tjetër, Charles Stewart Parnell i Partisë Parlamentare Irlandeze, e përdori rregullisht këtë taktikë në Uestminster gjatë viteve 1880 në përpjekje për të fituar autonominë dhe për të futur në axhendën e Parlamentit vetëqeverisjen në Irlandë.

Fjalimi më i gjatë në dhomën e ulët të Parlamentit të Anglisë gjatë shekullit të njëzetë që një fjalim i mbajtur nga deputeti konservator, Sër Ivan Lawrence, i cili foli për katër orë e 23 minuta kundër një ligji në vitin 1985. Sër Ivani që një avokat dhe kishte eksperiencën e mjaftueshme për fjalime publike për të mbajtur fjalët e tij brenda temës, por përpjekjet e tij nuk e ndaluan dot miratimin e ligjit që po kundërshtonte. "Nuk mendoj se kisha as një shishe ujë me vete", kujton ai. "Që me të vërtetë adrenalina që më mbajti të vijoja. Për fat të keq, gjithkush mendoi se kjo që një hile". Deputetët e tjerë ndërhyjnë ta ndërprisnin me shaka herë pas here. "A është miku im i nderuar i vetëdijshëm se më ofroi të më dërgojë me makinë në shtëpi sot", tha njëri prej tyre. Një mik i tij, më vonë i tha Sër Ivanit se atë natë kishte mbajtur një kopje të transkriptit të fjalimit të koka e krevatit për të vënë veten në gjumë, sepse vijonin i vinin në mendje orët e kaluara në Parlament.

Ndryshimet në procedurat parlamentare tashmë e kanë bërë shumë të vështirë për përdorimin e teknikës së filibasterit kundër

ligjeve të mbështetura nga qeveria në Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar, megjithëse disa deputetë laburistë u akuzuan se po përpiqeshin të bënin diçka të tillë në një debat të kohëve të fundit. Me raste, ligjet e propozuara nga deputetët dytësorë, ndalohen përmes diskutimeve të gjata. Në vitin 2005 një deputet laburist, Andrew Dismore, foli për 197 minuta kundër një propozimi ligjor që synonte të qartësonte se deri në çfarë mase pronari i një shtëpie kishte të drejtë të reagojë me dhunë ndaj një dhunuesi të banesës së tij.

Por jo të gjitha filibasterat kërkojnë fjalime të gjata. Një deputet në Zelandën e Re, bllokoj reformën për qeverisjen vendore në vitin 2009, duke propozuar një mijë amendamente—shumë prej të cilave qenë në gjuhën e indigjenëve vendës Maori. Këto të fundit do të duhej të përktheheshin në anglisht, rrjedhimisht u humb kohë. Gjithsesi, shumë parlamente—përfshirë të dy dhomat e parlamentit të Australisë, si dhe Dhomën e Përfaqësuesve (kongresit) në Shtetet e Bashkuara, —kanë rregulla të qarta mbi kohën që i lejohet një kongresmeni të flasë. Senati i SHBA-së nuk e ka një rregull të tillë dhe 60 nga 100 senatorë mund të votojnë për hapjen e një debati para votimit. Rritja e armiqësisë mes palëve gjatë kohëve të fundit është akuzuar si shkaktare e rritjes së rasteve të përdorimit të filibasterave të heshtur. Por në rast se plani i Reid ecën përpara dhe ndryshon rregullat, fjalimet maratonë mund të rikthehen në dhomën e Senatit. Çështja nëse opinioni publik do t'i tolerojë këto hile, gjithsesi është një diskutim tjetër.

Në epokën e lajmeve 24 orëshe, politikanët mund të mos jenë shumë të gatshëm të bëhen shaka publike përmes fjalimeve të gjata për të humbur kohën, siç qenë paraardhësit e tyre, argumenton Gregory J Wawro, profesor i politikës në universitetin Cornell dhe bashkautor i librit "Filibasteri: pengimi i ligjëvënies në Senatin e Shteteve të Bashkuara." "Në kohën e filibastera-

ve të mëdhenj kundër të drejtave civile dhe në ditët e Huey Long, diçka e tillë nuk shfaqej në televizor", thotë Wawro. "Mbetet për t'u parë nëse senatorët do të jenë të gatshëm të shikohen nga të gjithë amerikanët duke lexuar nga një adresar telefonik apo duke recituar receta kulinarike". Dhe përveç pajisjes së bollshme me ujë e ushqim, ata do të duhet të mendojnë se si do ta marrin votuesit e tyre një tentativë kaq të qartë humbje kohe. Frika nga votuesit që shohin televizor është e mjaftueshme për ta bërë edhe fjalimin më serioz, por gjithsesi të gjatë, të tepërt për çdo politikan.

LLAFOLLOGËT E MËDHEJ TË AMERIKËS

Një nga filibasterat më të gjatë në histori ndodhi kur senatori i SHBA-së, Strom Thurmond foli për 20 orë e 54 minuta në 28 gusht 1957 deri në orën 21:12 minuta të mbrëmjes së nesërme kundër reformës për të drejtat civile. Senatori Alfonse D'Amato nga Nju Jorku, vijoi të flasë për 23 orë e 30 minuta në një përpjekje për të ndaluar një ligj mbi ushtrinë në vitin 1986. Robert Byrd nga Virxhinia Perëndimore foli kundër Aktit të Lirive Civile më 1964 për 14 orë e 13 minuta. Huey Long i Luizianës diskutoi cilësitë e recetave të ndryshme kulinarike më 15 orë në vitin 1935.

LLAFOLLOJIA NËPËR BOTË

Në dhjetor 2010, deputeti nga Partia e Gjellbër e Austrisë, Werner Kogler, mbajti një fjalim që zgjati 12 orë dhe 42 minuta. Deputeti konservator i Kanadasë, Tom Lukiwski, foli për gjashtë orë në një komision parlamentar në vitin 2008. Në Britaninë e Madhe, në shkurt 1983, laburisti John Golding foli për 11 orë mbi ligjin mbi telekomunikacionet, por për shkak se fjalimi u mbajt në një komision dhe jo në sallën e Parlamentit, ai kishte të drejtë të bënte pushime. Më 1936, deputeti Tommy Henderson nga partia e Unionistëve të Pavarur në Parlamentin e Irlandës së Veriut, foli për dhjetë orë rresht.

Shqipëria që s'duam!



Nga
Leonora Laçi

Gjithçka po na bëhet fakt i kryer, e ne spektatorë kalimtarë! Edhe sikur mos ta duam ne, e do pushteti, e merr pushteti pushtetin, e merr pushti shtetin. Kjo është Shqipëria që s'duam sot as nesër!

Gënjeshtra është ulur këmbëkryq në këtë qyq Shqipëri, e leksione mbanë free.

Shqipëria që duam, Bashkia që duam, partia që duam, gënjeshtra që duam, kryetari që duam, media që duam, policia që duam!!!

Por vërtetë a e duam atë që qeveria do për ne, a i vjen përshatat ajo interesave tona apo interesave të veta?!

Slogane të tilla që nuk i beson dot as ai që i promovon.

Shqipëria që s'duam!

Është një vend që ngjarjet tragjike harrohen me të ndodhur, e skandalet politike mbyllën me të tretat, por keq qeverisja zgjatë përtej parashikimeve.

Shqipëria që s'duam!

Është një vend ku vrasjet e femrave nuk të bëjnë më përshtypje, grushtat e dheut i hidhen me shpejtësi viktimave sikur secili do të mbulojë mekatet e veta.

Shqipëria që s'duam!

Një vend që vakia dhe dasma bëhen një, përcjellja është kryefjalë e ngjarjeve të tilla.

Shqipëria që s'duam!

Është një vend që emigrantët e viteve të fundit janë elita intelektuale. Truri vrapon në skutat e botës për të shpëtuar sa më parë dhe ai.

Shqipëria që s'duam!

Një vend ku në burg shkojnë të varfrit që nuk e blejnë dot lirinë, e kriminelit vërtetë i kryen shërbime partisë. Sa më i madh krimi, aq më lart ngjitesh në rangje pushteti.

Shqipëria që s'duam!

Vendi ku opozita si e tillë me mungesën e saj në kuvend nuk sjellë asnjë dëm a dobi.

Shqipëria që s'duam!

Vendi ku miti i këmbëve të shkurtra të gënjestrës bie.

Një vend ku realiteti prodhon gënjeshtra apo anasjelltas, gënjeshtra që riprodhohet me shpejtësi duke iu veshur a ngjeshur fakti si vërtetësi. Një vend ku demokracia është tradhtuar që në gënezë.

Shqipëria që s'duam!

Një vend ku qeveria është e papërmbylthme në hajni e llomotitje deri në shpërfytyrim.

Në një vend ku gënjeshtrat elektorale po na i quajnë premtime, gënjeshtrat për të ardhmen quhen besimdhënie, gënjeshtrat e së kaluarës po na i quajnë histori.

Gënjeshtra është ulur këmbëkryq në këtë qyq Shqipëri, e leksione mbanë free.

Shpesh herë na kanë gënjyer, kemi dashur të gënjehemi, kemi gënjyer, gënjeshtra dashmirëse apo dashakeqëse, gënjeshtra që kanë qenë një domosdoshmëri, ashtu siç i thuhet atij që është në prag të vdekjes, do jetosh, do të jetosh edhe ti.

Gjithçka po na bëhet fakt i kryer, e ne spektatorë kalimtarë! Edhe sikur mos ta duam ne, e do pushteti, e merr pushteti pushtetin, e merr pushti shtetin.

Kjo është Shqipëria që s'duam sot as nesër!

LAVDËROHET RASHICA

Anëtori i përfaqësueses së Kosovës, Milot Rashica është lavdëruar për paraqitjen që kishte në barazimin 1 me 1 që Werder Bremani e nxori me Stuttgartin. Radiotelevizioni publik gjerman NDR në raportimin e ndeshjes e ka cilësuar Rashicën si lojtarin e vetëm që shkaktoi rrezik ndaj mysafirëve. "Në sulm rrezikoi vetëm Rashica. Kosovari kishte dy raste të mira shënimi [minutat 15 dhe 30] dhe me shpejtësinë e tij i shkaktoi probleme mbrojtjes së Stuttgartit", ka raportuar ky televizion.



Demiri luan 90 minuta në fitoren e Mariupolit

Shkup, 24 shkurt - Mbrojtësi i krahut të majtë Besir Demiri dhe skuadra e tij ukrainase Mariupol, me fitore kanë nisur sezonin pranveror. Këta në kuadër të javës së 19, të elitës së futbollit ukrainas e kanë mundur skuadrën e Olimpik. Mbrojtësi Demiri, në këtë ndeshje të parë në sezonin e ri luajti për 90 minuta dhe pati një paraqitje të mirë. kështu ai vetëm ka vazhduar paraqitjen e mirë të futbollistëve të kombëtares shqiptare në fillim të pranverës. Mariupol me 27 pikë përkohësisht e mban pozitën e 6-të, ndërsa Olimpik Donjeck me 19 pikë e mban pozitën e 9.

Renova ka shënuar fitore të thellë ndaj Vardarin me rezultatin 4:0. Shkëndija ka barazuar në fushën e Makedonija GJ.P 1:1, Shkupi me lehtësi ka mundur Pobedën 3:0. Rabotnički ka luajtur barazi me Sileksin 1:1, ndërsa Akademija P. ka marrë fitoren në fushën e Ballasicës me rezultatin 1:0

Koha

Fisnik NUHIU

Shkup, 24 shkurt - Të dielën u zhvilluan takimet e javës së 20 në Ligën e Parë futbollistike të Maqedonisë së Veriut. Ndeshje interesante ishte ajo me ekipit të Renovës dhe Vardarit, takim të cilin e fituan "gjipspunuesit" me rezultatin e thellë 4:0, duke i sjell Vardarit humbjen e dytë në sezonin pranveror. Skuadra e Renovës arriti që në minutën e 9 të shënoj golin e parë me anë të Emran Ramadanit, ndërkaq vetëm katër minuta më vonë Emanuel Mbella rriti epërsinë në 2:0. Në pjesën e dytë nikoqirët shënuan edhe dy herë në portën e Vardarit, së pari në minutën e 48 me golin e tij të dytë në këtë takim, Emran Ramadani rriti shifrat në 3:0, ndërsa në minutën e 74 Vlatko Stojanovski dërgoi topin në

LIGA E PARË - JAVA E 20

RENOVA TURPËRON VARDARIN, SHKUPI MUNDI POBEDËN



rretjen e portieri Gaçevskit, duke vulosur rezultatin 4:0. Ekipi i Renovës pas kësaj fitore tani radhitet në vendin e gjashtë me 25 pikë të tubuara, ndërsa Vardari ka humbur pozitën e dytë. Kampioni aktual, Shkëndija ka barazuar në terren mysafir ndaj Makedonija GJ.P 1:1. "Kuqezinjtë" ishin të parët që kaluan në avantazh me golin e Omar Imerit në minutën e pestë të përbaljes. Në pjesë e dytë ishin nikoqirët ata që dëshironin golin

më shumë dhe kështu në minutën e 58 barazuan shifrat në 1:1 me anë të Robson da Silva i cili nga gjuajtja e lirë mposhti portierin Marko Jovsnovski. Nga ana tjetër ekipi i FC Shkupit, ka zhvilluar një takim të mirë para tifozëve vendas "Shvercerat", duke shënuar fitore ndaj Pobedës me rezultatin 3:0. Goli i parë për Shkupin erdhi në minutën e 38, me një supergol nga kapiteni Muharem Bajrami, i cili nga gjuajtja e liri mposhti por-

tierin mysafir. Në fraksionin e dytë Çairasit, shënuan edhe dy gola, së pari Viktor Angelov në minutën e 50 të ndeshjes rriti epërsinë në 2:0, ndërsa Serxhio Zhunior në minutën e 76 shënoi golin e tretë për FC Shkupin. Në takimet tjera, Rabotnički ka barazuar me Sileksin 1:1, ndërsa Akademija Pandev ka shënuar fitore të rëndësishme duke e mposhtur Bellasicën në terren mysafirë me rezultatin 1:0.

Shembulli i një trajneri

Të jesh i suksesshëm në një drejtim të caktuar është një gjë dhe të kesh vlera të larta njerëzore është diçka tjetër. Të fitosh nuk do të thotë detyrimisht se ke klasë si njeri, por kur këtë e posedon si vlerë personale atëherë flasim për një profil personazhi të kompletuar. Duke llogaritur se karriera e tij si trajner është realisht në fillim, ish-futbollisti i suksesshëm shkupjan tregon se mbase niveli i edukatës në kombinim me punën që bën në terren do të jenë formula që do ta ngrisin në një teknik të suksesshëm. Një karrierë e nisur te FC Shkupi për momentin duket e determinuar të vazhdojë në Gjilan te Drita. Fillimisht i zgjedhur si ndihmës i trajnerit të mirënjohur Shpëtim Duro, me dorëheqjen e këtij të fundit merr postin e shefit të stafit teknik te kampionia në fuqi e Kosovës. Në debutim para vetes kishte derbin e qytetit të Anamoravës, ku fitorja pritej për më shumë se 15 vite. Drita dominon dhe fiton me klasë 3:1 përbal-



lë Gjilanit dhe në kushte kur të gjithë ishin pushtuar nga euforia e triumfit ndaj rivalit të përbetuar, Ardian Nuhiu arrin të prezantojë 'modelin' e 'shkëlqimit në heshtje!' I matur si gjithmonë, fjalë pak, por të zgjedhura e të kombinuara mirë, pa eufori dhe me një qetësi admiruese në vend që të 'fluturojë' e shijojë suksesin e momentin, ai dedikon fitoren tashmë ish-shefit të tij, Shpëtim Duros. Respekt! Modeli i mirënjohjes dhe kolegjalitetit të mirëfilltë e sinqertë. Manife-

stim vlerash me klasë, tregues klasik kur personalen e vendos pas të përgjithshmes. Njeri i rrallë që në vend t'i kënaqet suksesit të tij, kujton dhe vlerëson njeriun që deri dje e kishte mbi veten. Ky është Ardian Nuhiu, njeri me klasë e edukatë admiruese. Punëtorë i vyeshtëm që tregon se nuk 'dehet' nga sukcesi i momentit, sepse ka qëllime të qarta për të ardhmen! Karakteristika këto që mbase parajlmërojnë një karrierë të sukses-shme!

Zhegrova debuton për Baselin

Ylli i Përfaqësueses së Kosovës, Edon Zhegrova është shfaqur për herë të parë në fushë me fanellën e Baselit, që nga transferimi i tij në klubin zviceran. Kosovari hyri në minutën e 84-të të ndeshjes së Baselit kundër Neuchatel Xamax, të cilën skuadra e Baselit e fitoi me rezultat 2:0, në kuadër të Super Ligës së Zvicrës. Zhegrova e zëvendësoi Valentin Stockerin në këtë ndeshje, mirëpo ai luajti vetëm për gjashtë minuta të kohës së rregullt dhe minutat shtesë. 19-vjecari u la në stol për ndeshjen e fundit, më 17 shkurt, kundër Sionit. Zhegrova u transferua në Basel nga Genku

gjatë afatit kalimtar të janarit. Ai u transferua në formë huazimi, deri në qershor të vitit 2020, kur klubi zviceran e ka opsionin për ta blerë përfundimisht belgun. Të interesuar për Zhegrovën ishin edhe mjaft shumë klube të tjera evropiane, si Lazio, Milani e Barcelona, pasi që raportohej se as kosovari nuk ishte i kënaqur në klubin belg për shkak të minuta-ve të paktë në të cilat aktivizohej. Gjatë gjithë pjesës së parë të sezonit, ai i ka bërë gjithsej 12 paraqitje për ish-klubin e tij, vetëm shtatë në Jupiler Pro League, nivelin e parë të futbollit në Belgjikë.



KATËR TRAJNER PËR TA ZËVENDËSUAR ALLEGRIN

Bardhezinjtë mund të mos e kenë nevojën për të vijuar gjatë me Allegrin, ose ky i fundit vendos të emigrojë diku tjetër. Trajneri livornez ka një detyrë të vështirë përpara: të përmbysë Atletico Madrid dhe të kualifikohet në çerekfinale të Championsit. Nëse kjo nuk ndodh, gjërat bëhen të qarta. Allegri ikën në fund të sezonit



Atletico Madrid dhe të kualifikohet në çerekfinale të Championsit. Nëse kjo nuk ndodh, gjërat bëhen të qarta. Allegri ikën në fund të sezonit. Për të, sukcesi në Ligën e Kampionëve është "kuti" matës. Emrat e pasuesit, megjithatë, do të kufizoheshin në një rreth të nivelit të lartë, në përputhje me pretendimet dhe cilësinë e një klubi që, në këtë moment, është mes katër, ose pesë më të mirëve në Europë. Kështu shkruan torinezja "Tuttosport", e cila e shtjellon më tej idenë e vet.

ZIDANE - Zinedine Zidane është një opsion që vjen vetvetviti, nga një miqësi 20-vjeçare midis francezit dhe Andrea Agnelli. "Zizou" nuk e ka ndërprerë kurrë da-

shurinë për Torinon, ndihet i lidhur me klubin bardhezi, ka një marrëdhënie të veçantë me Cristiano Ronaldo. Tri arsye mjaft të mira për ta trajnuar Juventusin, pasi ka luajtur e shkëlqyer me të edhe si futbollist.

GUARDIOLA - Guardiola është një hipotezë e çmendur, të paktën ashtu siç ishte Cristiano Ronaldo një vit më parë.

Ndryshimet radikale teknike të bardhezinjtë do të përbënin një hov total në raport me të kaluarën e afërt taktike. Guardiola mund ta bëjë më së miri këtë gjë, por duket e vështirë të largohet nga "Etihad". Agnelli e ka në listë, megjithatë, sepse ka në plan ta dërgojë klubin në krye të botës.

KLOPP - Klopp është ndoshta emri më pak i mundshëm, për shkak të një marrëdhënie shumë të fortë që e lidh atë me Liverpool. Nëse fiton titullin në Premier League, çka mungon tash 20 vite në "Anfield", zor se Juventus mund t'i afrohet trajnerit gjerman.

DESCHAMPS - Për Deschamps do të ishte një rikthim. Ai ka qenë trajner i Juventusit në vitin e vështirë, kur luajti në Serie B. Një përvojë e rëndësishme për të ardhmen e tij. Pavarësisht se drejton Francën, Deschamps duket i joshur nga ideja për t'u ulur në këtë stol, për të konkurruar në nivelin më të lartë, pasi i ka drejtuar bardhezinjtë në momentin e tyre më të vështirë dhe dramatik.



Icardi do mbyllë sezonin me Interin

Mauro Icardi vijon të jetë jashtë grumbullimit me skuadrën e Interit, teksa çështja ka marrë një dimension tjetër. Klubi i hoqi atij shiritin e kapitenit dhe nga raportimet e bëra është mesuar se ai nuk kthehet në fushë pa iu ridhënë shiriti. Për këtë, Icardi ka kohë që qëndron jashtë fushe me arsyetimin se është i dëmtuar. Inter bëri një kontroll për të dhe rezultoi se sulmuesi nuk ka asnjë dëmtim. Një histori trilli, që në këtë mes nuk dihet se cila palë po gënjen. "Corriere dello Sport" ka publikuar një lajm të bujshëm ditën e sotme, ku thekson se Icardi ka nevojë për ndërhyrje kirurgjikale në gju, për pasojë të mbyllë fazën e mbetur të sezonit. Argentinasi ankohet për dhimbje në gju dhe sipas medias italiane deri tani ai është mbajtur me injeksione, por dëmtimi nuk është zhdukur plotësisht. Me situatën e krijuar 26-vjeçari nuk do rrezikojë më shumë me gjurin e tij dhe në ditët në vijim mjekët do të bëjnë një vlerësim të ri. Ka mundësi reale që ata të japin "OK" për të kryer operacion në gju për Icardin, me qëllimin për të pastruar zonën e dëmtuar dhe të zhduket inflamacioni. Nëse ish-kapiteni operohet do të duhet të qëndrojë të paktën për 2 muaj jashtë fushe dhe mund të kthehet i gatshëm për të luajtur vetëm në sezonin e ardhshëm, kohë ku nuk dihet nëse do e gjejë si zikaltër apo në ndonjë klub tjetër.



Marcelo dëshiron largimin

Marcelo dëshiron që të largohet nga Real Madridi në afatin kalimtar të verës, raporton Telemadrid. Sipas këtyre raportimeve thuhet se mbrojtësi brazilian është takuar dy herë me menaxhmentin e klubit gjatë kësaj jave për të diskutuar mundësitë e largimit të tij. Dëshira e tij është që të transferohet te Juventus dhe të bashkohet

me ish-bashkëlojtarin e tij Cristiano Ronaldo. 30 vjeçari ishte bashkuar me gjigantin spanjoll më 2007 dhe që nga atëherë ka qenë i jashtëzakonshëm në Santiago Bernabeu. Raportohet se Juventus është i gatshëm të paguajë 45 milionë euro për shërbimet e tij, derisa lojtarit do t'i jepte pagë prej 12 milionë euro në sezon.

Messi: 50 "hat-tricke" te Barça

Lionel Messi sot tregoi se fundi i kohës së tij në futboll ende është shumë larg. Ylli i Barcelonës është duke kaluar në një formë të jashtëzakonshme këtë sezon, derisa sot shënoi "hat-trickun" e tij të 50-të në fanellën e Barcelonës për t'ia dhënë pikët e plota në derbin ndaj Sevillës, shkruan BBC. E Sevilla duket se është "viktima" e tij e preferuar, pasi

shënoi golin e tij të 36 në 35 paraqitje kundër këtij ekipi. Por, në moshën 31 vjeçare Messi duket se nuk e ka ndërmend që të ndalet, derisa është në kërkim të topit të gjashtë të Artë. Tripleta ndaj Sevillas e çoi atë në kuotën e 25 golave në La Liga këtë sezon, mesatarisht një gol në çdo 75 minuta. Ai ka nëntë gola më tepër se bashkëlojtari i tij Luis Suarez, e dy-

fish më shumë se golashënuesi më i mirë në skuadrat e tjera, Cristhian Stuani i Gironas që si i treti ka 13 gola. Në të gjitha garat ai ka shënuar 33 gola në 32 ndeshje, përfshirë gjashtë në Ligën e Kampionëve duke e udhëhequr Barcelonën drejt tripletës. Goli i tij i tretë sot ishte i 650 në karrierë, 585 për Barcelonën dhe 65 për Argjentinën.



DE LAURENTIIS THUMBON JUVEN

“Kemi shumë për të bërë në këtë drejtim, por realisht nuk e kuptoj firon e tifozerisë në San Paolo, të cilët mesa duket nuk ndjekin më skuadrën e tyre nëse nuk renditet e para. Motoja jonë është të luftojmë deri në fund, sepse ata që dorëzohen që më vështirësinë e parë në jetë praktikisht janë të humburit”, ka deklaruar De Laurentiis



Me konsolidimin e rrugëtimit në Europa League Aurelio De Laurentiis shprehet me bindje se Napoli i tij nuk i druhet më asnjë rivali, por presidenti i të kaltërve rezervon disa thumbime edhe për kampionët në fuqi të Serisë A. Nëse ke një borxh prej 200 milionë eurosh me bankat për një lojtar, çfarë sensi bën të fitosh, ironizon ai bardhezinjtë e Cristiano Ronaldos. Për më tepër presidenti i Napolit i drejtohet edhe tifozerisë së klubit të tij të cilët po shfaqen gjithnjë e më të pakët në shkallët e stadiumit. “Kemi shumë për të bërë në këtë drejtim, por realisht nuk e kuptoj firon e tifozerisë në San

Paolo, të cilët mesa duket nuk ndjekin më skuadrën e tyre nëse nuk renditet e para. Motoja jonë është të luftojmë deri në fund, sepse ata që dorëzohen që më vështirësinë e parë në jetë praktikisht janë të humburit”, ka deklaruar De Laurentiis. Krahas thumbimeve për klubin torinez, presidenti i Napolit jep edhe vlerësimet e tij në këtë pikë të sezonit. “Çmimin Oskar do t’ia jepja padikustim Ancelottit për durimin e treguar, një trajner që mbërriti në një terren kompleks, por që me durimin, qetësinë dhe buzëqeshjen që e karakterizon i ktheu qetësinë dhe

klimën pozitive ambientit të këtij klubi dhe lojtarëve të kësaj organike. Është një prej aftësive të mëdha të Carlos të lexojë mes rreshtave duke na psikologjisur të gjithëve. Për më tepër ai ka potencialin për ta përmirësuar këtë skuadër duke na çuar në finalen e Bakusë në Europa League. Sa i takon një sfide Napoli-Chelsea, nëse Sarri do të rezistonte në stolin e Bluve të Londrës do të ishte bukur një takim i tillë dhe uroj më gjithë zemër që Sarri t’ia dalë mbanë kësaj aventure në Premier League”, ka theksuar De Laurentiis.



Trajnerit italian i ofrohet stoli i kombëtares së Iranit

I shkarkuar nga detyra e trajnerit fillimisht te Milani e më pas te Sevilla, trajneri italian Vincenzo Montella mund të ulet së shpejti në stolin e një ekipi kombëtar, atij të Iranit. Kombëtarja e këtij vendi, pas një paraqitje të mirë në “Rusi 2018”, po mendon që tani për Botërorin e radhës, në Katar (2022). Dhe duke parë rëndësinë që ka ky event, drejtuesit e Federatës Iraniane të Futbollit po mendojnë t’ia ofrojnë drejtimin e skuadrës trajnerit Montella. “Aeroplani”, siç njihet ndryshe trajneri Montella, do të fitonte 1.5 milionë euro nga kjo detyrë si dhe bonuse të tjera nëse Irani arrin të kualifikohet në Botëror. Sipas mediave italiane, trajneri ka kërkuar disa ditë për të reflektuar për këtë ofertë para se të marrë një vendim. Montella aktualisht është pa ekip. Dy shkarkimet e fundit nuk e kanë penguar Iranin t’i ofrojë Montellës detyrën e trajnerit të kombëtares, që nëse pranon do të drejtojë për herë të parë një ekip kombëtar në karrierën e tij.

Rregullorja ndryshon sërish, ja rastet kur do jepet penallti



Bordi Ndërkombëtar (IFAB), organi që rregullon Rregulloren e Futbollit, do të takohet të shtunën e ardhshme për të rishikuar konceptin e prekjës së topit me dorë brenda zone për tri rastet përjashtimore të paqëllimshme. Tre përjashtimet: Aktualisht, në rregulloren që ekziston tani është e shkruar se janë tri raste kur prekja e topit me dorë brenda zone nuk jepet penallti: 1. Kur duart janë të ngjitur për trupi, 2. Kur topi preket me dorë pas një devijimi, 3. Kur lëvizja e dorës është e natyrshe dhe jo e qëllimshme. Vetëm në këto tre raste

nuk akordohet penallti. Gjithsesi IFAB dëshiron të ndryshojë sërish këtë rregull dhe në mbledhjen e 1 qershorit në Skoci do kërkojë që çdo prekje e topit me dorë në zonë të akordohet penallti, pavarësisht qëllimit dhe lëvizjes së lojtarit. Votimi. Në mënyrë që propozimi i IFAB të ketë sukses, ai nuk zbatohet pa shumicën e thjeshtë. Duhet të paktën gjashtë nga tetë vota në Këshill, që të integrohen me një votë secilin, katër federata të Britanisë së Madhe (Angli, Uells, Skoci dhe Irlandën e Veriut) dhe FIFA-s, vota e tyre është me vlerë katër.

Wisla, klubi i madh polak që pësoi rënie drastike

Fusha stërvitore e Wisla Krakowit në fshatin Myslencie, 40 minuta në jug të qytetit të dytë më të madh në Poloni, Krakow, ishte e ngrirë muajin e kaluar, ndërsa disa qindra tifozë arritën të kalonin nëpër borë për të përshëndetur Jakub Blaszczykowski. Blaszczykowski, një mesfushor 33-vjeçar, ka luajtur në disa prej ndeshjeve më të mëdha të futbollit, përfshirë në finale të Ligës së Kampionëve të vitit 2013 si pjesë e Borussia Dortmundit, në dy kampionate evropiane dhe në një Botëror me Përfaqësuesen e Polonisë. Por në këtë pasditë, Blaszczykowski ishte shumë larg nga ato momente. Ai ishte pranë që të luante ndeshjen e tij të parë miqësore që kur iu bashkua Wisla Krakowit, një prej skuadrave më të dekoruara të Polonisë. Wisla është skuadra ku Blaszczykowski bëri emër dhe së cilës i kishte dhënë premtimin se një ditë do të kthehej pasi që firmosi me Dortmundin në vitin 2007. Ai nuk po kthehet te Wisla për të bërë pensionimin më të lehtë, apo për një pagesë të fundit. Në fakt, e vërteta është krejt ndryshe. Blaszczykowski, që njihet me nofken Kuba, është kthyer në vendlindje me një marrëve-



shje të pazakontë ku është pajtuar të mos marrë fare para për të luajtur dhe iu bashkua dy investuesve polakë për të huazuar 350 mijë dollarë te klubi për të mbuluar rrogat e papaguara të bashkëlojtarëve të tij të rinj. Wisla Krakowit kur u kthye ishte në gjendje të rëndë dhe historia e saj është

ndyrë pas një serie të ngjarjeve katastrofave, përfshirë marrjen në pronë nga huli-ganët, mungesën e parave dhe një investuesi misterioz të huaj që ofroi veten si shpëtimtar, mori certifikatat e pronësisë së klubit dhe më pas - pa dhënë asnjë qindarkë - u zhduk.

Nga lagjet e varfra deri në majë të skenës botërore të ragbit

Lagja e varfër “Kibera” në periferi të Naj-robotit nuk duket si vend ku mund të gje-sh një sportist ndërkombëtar, mirëpo ylli i Përfaqësueses së Kenias në ragbi me shtatë lojtare, Diana Awino, e quan këtë vend shtëpi të saj. Niveli i papunësisë në Kibera është 50 për qind dhe vetëm 20 për qind e shtëpive - kryesisht kasolle me mure të baltës - kanë energji elektrike. Është një tualet për 50 shtëpi dhe vetëm së fundmi janë vendosur dy gypa qendrorë të ujit. “Për të mbijetuar, gjëja numër një është të kesh një punë, një punë që paguhet, pasi të duhet të paguash edhe qiranë”, thotë Awino. “Duhet të ushqesh familjen tënde. Është vërtet e vështirë”. Awino, pjesë e Përfaqësueses së Kenias që fitoi titullin e Afrikës në ragbi shtatëshe në Botsuana vitin e kaluar, është shembulli më i mirë i sakrificës në popullatën 2.5-milionëshe në Kibera. Ajo jeton me të birin e saj nëntëvjeçar dhe me familjen. Për të realizuar ëndrrën që të luajë për vendin e saj, është dashur të bëjë sakrificë.



Surpriza në ndeshjet e luajtura në NBA, ku spikat fitorja 118-112 që Houston korri ndaj Golden State në fushën e këtij të fundit. Ekipi teksan e komandoi gjatë gjithë kohës ndeshjen, duke e merituar fitoren

NBA

WARRIORS "BIEN" NDAJ HOUSTONIT, LEBRON NUK MJAFTON PËR LAKERS



Golden State Warriors pësuan humbjen e dytë në 3 sfidat e fundit, pasi u mposhtën me rezultatin 112-118 nga Houston Rockets, në sfidën e zhvilluar në "Oracle Arena" të Oaklandit. Miqtë e nisën sfidën në mënyrë perfekte, duke krijuar 15 pikë diferencë që në fraksionin e parë, ndërsa më pas menaxhuan mirë lojën, duke mos u dhënë mundësi vendasve të përmbysin rezultatin. Kevin Durant dhe Stephan Curry shkëlqyen sërish, duke shënuar 54 pikë, 10 asiste dhe 13 rikuperime së bashku, por që nuk i shërbyen skuadrës kampione në fuqi, që të marrë fitoren. Forma e mirë e Ingram dhe LeBron James, nuk mjaftoi që Los Angeles Lakers të dilte triumfatore nga transferti e New Orleansit, përballë Pelicans. Dy yjet e skuadrës kaliforniane regjistruan 56 pikë, 15 asiste dhe 12 rikuperime së bashku, por në fund rezultati shkoi në favor të vendasve, në shifrat 128-115. Cleveland Cavaliers regjistruan fito-

ren e dytë radhazi në këtë sezon, duke dhënë sinjale rikthimi, pasi mposhtën me rezultatin 112-107 Memphis Grizzlies. Kevin Love ishte protagonist i suksesit të Cavs, pasi në 25 minutat e qëndrimit të tij në parket, arriti të shënojë 32 pikë dhe të rikuperojë 12 topa, duke u shpallur edhe më i miri i

ndeshjes. Një sfidë mjaft spektakolare ishte ajo e zhvilluar në "Fiserv Forum" të Milwaukee, ku Bucks-at vendas triumfuan me rezultatin 140-128 përballë Minnesota Timberwolves. Takimi ishte mjaft i ekuilibruar në tre fraksionet e para, ndërsa Bucks shpërthyen në pjesën e fundit, të cilën e fituan

me 14 pikë diferencë, falë edhe një performance spektakolare të dyjve të skuadrës, Middleton dhe Antetokounmpo. Pas dy humbjeve radhazi, Sacramento Kings u rikthye te fitorja, teksa ia doli të triumfojë me rezultatin 116-119 në një transfertë aspak të lehtë, përballë Oklahoma City Thunder. Ba-

sketbollisti i vendasve, Westbrook ishte spektakolar në këtë sfidë, pasi regjistroi 41 pikë të shënuara, 4 asiste dhe 10 rikuperime, por këto shifra i shërbyen vetëm për të qenë më i miri i takimit, pasi nuk ndihmuan Oklahomën për të shmanhur humbjen. Chicago Bulls vijon ngjitjen në renditjen e Konferencës së Lindjes, pasi regjistroi fitoren e tretë radhazi, këtë herë me rezultatin 126-116 përballë Boston Celtics. Zach LaVine ishte protagonist i Bulls, por edhe më i miri i takimit, pasi qëndroi në parket thujse gjatë gjithë lojës dhe arriti të shënojë 42 pikë, 4 asiste dhe 6 rikuperime. Phoenix Suns vijon "hemorragjinë" e humbjeve, pasi mbrëmë u mposht për herë të 17 radhazi, në transfertën ndaj Atlanta Hawks, ndërsa fitorja e fundit daton më 13 janar të këtij viti. Dy basketbollistët e Suns, Booker dhe Johnson zhvilluan një takim mjaft të mirë dhe u duk se rezultatin do të shkonte në favor të miqve, por Hawks reagan fuqishëm në fraksionin e fundit, duke përmbysur gjithçka në favor të tyre.

Joshua dëshiron përballjen me Wilderin

Kampioni i botës në boks, Anthony Joshua ende dëshiron që në të ardhmen të përballlet me Deontay Wilder, nëse kampioni i WBC-së nuk arrin të pajtohet për një rimeç me Tyson Fury, ka thënë promotori Eddie Hearn. Më 1 qershor Joshua do ta bëjë debutimin e tij në SHBA kur do të përballlet me Jarrell Millerin në Madison Square Garden, derisa Wilder ende nuk e ka konfirmuar meçin e tij të radhës, raporton Sky Sports. Meçi ndërmjet Wilderit dhe Furyt mund të mos ndodhë, e kjo sipas Hearnit mund të shihet edhe si diçka pozitive. "Mendoj se ndoshta është lajm i mirë për ne, Wilder duhet ta shikojë këtë e të thotë 'tani meçi im me Fury me gjasë s'do të ndodhë, prandaj le të ndodhë meçin me Joshuan. Do të doja të shihja Wilderin të ketë një meç e më pas të zhvillohet meçi për titull të botës, nëse Joshua mund ta mposhtë Millerin. Kjo është ajo çfarë duam", është shprehur Hearn për Sky Sports.



NADAL "ZBARKON" NË AMERIKË: Shpresoj që kjo gjë të mos më ndodhë sërish



Pas Akademisë që funksionon prej gati 3 vitesh në Majorka tenisti spanjoll Rafael Nadal ka çelur edhe një seli të saj na Kankun të Meksikës. Tenisti spanjoll, numri 2 në botë, do të rikthehet në fushë javën e ardhshme në turneun e Akapulko, një muaj pas sfidës së fundit, atë të humbur në finalen e Australian Open. "Jam i kënaqur që projekti im me Akademinë e tenisit po njihet këtu rritje dhe Meksika është vendi ideal për të përhapur idetë e mia. Unë shpresoj që kjo Akademi këtu të jetë pikë referimi për të ardhmen. Shpresoj që të afrohen sa më shumë vajza, pasi sa më shumë të tilla

luajnë tenis aq më i lartë është niveli i këtij sporti", u shpreh tenisti spanjoll. Tenisti spanjoll në fund u shpreh se synon që muaji mars të të mbyllet pa dëmtime, në mënyrë që të jetë gati për fushat me dhë, sipërfaqja e tij e preferuar. "Pas Akapulko janë edhe dy turne Masters në Amerikë dhe shpresoj që aty të jem në formë. E vetmja gjë që kërkoj është të luaj mirë dhe të mos dëmtohem, që të mos kem problem si vjet. Sot, për ne tenistët është bërë një formalitet bashkëjetesa me dëmtimet, por shpresoj ta mbyll këtë fazë të sezonit pa probleme fizike", tha Nadal.

Hamilton analizon sezonin

"Provat mbeten prova, gara është tjetër gjë. Aktualisht ne jemi duke testuar gjithçka, ndaj në këto momente nuk ka rëndësi se sa të shpejtë jemi në pistë. Shpejtësia ka rëndësi vetëm në provat zyrtare dhe do të shohim se ku jemi para garës së parë, në Australi", u shpreh Lewis Hamilton, 5 herë kampion në Formula 1. Kampioni i botës në Formula 1 kërkon të karikojë skuadrën pas rezultateve jo fort të mira në testet e para të zhvilluar në Montmelo. Makina Mercedes ishte më shumë se 1 sekondë e avashtë karshi Ferrarit. "Testet konfirmuan se janë të sh-

pejtë, por kemi kohë për t'u përmirësuar dhe kuptuar se ku mund të rikuperojmë", tha Hamilton. Hamilton përpiqet të përfshijë në këtë garë edhe pilotët të tjerë, duke deklaruar se sfida për titullin do të jetë mes disa pilotësh dhe jo vetëm mes tij e Vettel. "Jemi 6 të tillë që mund të duelojmë për titull dhe testet e para dhanë një sinjal. Madje do të shohim më shumë pilotë fitues këtë sezon se herët e tjera. Zakonisht nuk shoh atë që bëjnë të tjerët, por përqendrohëm në punën time dhe të skuadrës", u shpreh kampioni i botës.



Kryeministri Edi Rama ka folur për televizionin italian Rai News për çështjen e protestave opozitare dhe akuzat e opozitës. Rama tha se opozita është e shqetësuar sepse nuk ka shans të fitojë zgjedhjet lokale nga njëra anë dhe nga ana tjetër për shkak të reformës në drejtësi

Kryeministri shqiptar tha se 3-4 orë protestë shkatërruan 3-4 vjet punë në sensin e imazhit të vendit. Rama nuk mohoi se ekziston blerja e votave.

Komuniteti ndërkombëtar deri më tani ka kritikuar vendimin e opozitës për të dorëzuar mandatet. Dhe kjo në një farë mënyre është të dalin në anë të qeverisë suaj, ju pse mendoni se është kjo mbështetje?

Mendoj se kjo mbështetje është për Shqipërinë dhe jo për qeverinë time, sepse është vendim i paarsyeshëm është një akt që nuk di të ketë ndodhur në demokraci ku populli përfaqësohet nga të zgjedhurit e tij, dhe ata duhet të përfaqësojnë vullnetin e popullit.

Opozita vijon të thotë se është një problem serioz në vend kultivimi dhe trafikimi i kanabisit, ju keni përsëritur disa herë se p.sh, në Lazarat problemi thuhet është zgjidhur falë qeverisë tuaj. Si është situata në ç'pikë jemi?

Vetëm pak kilometra nga këtu ishte një Republikë e imponimit dhe e mbështetur nga politika nga

RAMA NË RAINNEWS: S'MOHOJ BLERJEN E VOTAVE



qeveria e tyre që kultivonte dhe trafikonte marijuanë, ashtu siç kishte edhe një heshtje të përgjithshme mbi këtë fenomen në të gjithë vendin. Ne e nxorëm në dritën e diellit dhe goditëm mbi të gjitha frontet. Por në fund nuk duhet të më dëgjoni as mua as ata, duhet të dëgjoni Guardia di Finanza që në 2017 konfirmoi se thuhet nuk kishte më.

Në fjalimet tuaja të ditëve të fundit keni bërë një krahasim mes protestës së studentëve dhe asaj të opozitës, kush është diferenca?

Protesta e studentëve ishte një protestë e popullit, kishin të gjitha arsyet të cilat ne i dëgjuam, ndërsa kjo nuk është një protestë e popullit. Kjo është një protestë e një establishmenti që u mund thellë dhe që ka arsye për të protestuar sepse nga njëra anë ata janë të dëshpëruar sepse nuk mund të fitojnë. Janë zgjedhjet për pak muaj

dhe nuk kanë shanse dhe nga ana tjetër ata janë shumë të shqetësuar për reformën rrënjësore të drejtësisë që ne kemi ndërmarrë me Komisionin Europian edhe me mbështetjen e SHBA-ve që po largon nga drejtësia të gjitha shefat e mëdhenj të një sistemi që ka garantuar imunitet për politikanët dhe për këta këtu.

A mendoni se kontestimet e ditëve të fundit kanë dëmtuar imazhin e Shqipërisë në botë dhe ndoshta e ka bërë më të vështirë udhëtimin drejt integritimit evropian?

Kjo sigurisht nuk i bën mirë as imazhit dhe as ekonomisë së vendit sepse jemi në një periudhë të rritjes ekonomike më shumë se 4%. Ishin 3-4 orë që shkatërruan 3-4 vjet punë në sensin e imazhit.

Por si do ta bëni? Opozita është një pozicion lufte dhe kanë deklaruar se kanë ndërmend të

protestojnë deri sa të mos ketë zgjedhje, deri sa ju nuk e keni lënë qeverinë dhe mbi të gjitha nuk duan as të vazhdojnë punën në parlament?

Ne kemi bërë një qeveri së bashku për të pasur zgjedhje të njohura nga të gjithë por me një kusht, kush fiton qeveris, kush humb rri në opozitë dhe mjaft të flitet keq për Shqipërinë dhe të kontestohen zgjedhjet.

Ne kemi maxhorancën, jemi përpara në të gjitha sondazhet në një mënyrë ekzemplare, nuk mund, nuk mund të merret peng një komunitet dhe të thuash unë do bëj kamikazin nëse nuk më jepni atë që dua. Jemi gjithmonë gati për të dialoguar, jemi gati të dëgjojmë por sigurisht që duhet të qeverisim.

Ju cituat shifra, sondazhe dhe votimin e maxhorancës me të cilën jeni zgjedhur. Por është e vërtetë edhe se, këtë thotë opozita të paktën se ka pasur dhe një përqindje votash që janë adresuar, OSBE fliste për një 20% të votave...

Nuk është e vërtetë. Raporti i OSBE thotë se duhet të adresohen disa aspekte që ligji elektoral t'i japë më shumë qëndrueshmëri sistemit. Pastaj në fund blerja e votave janë diçka që nuk mund të përjashtoj se ekziston.



Kurti: Jemi duke bashkëpunuar me LDK'në për rrëzimin e Qeverisë

"LVV dhe LDK janë partitë më të mëdha në vendin tonë dhe janë parti opozitare që koordinohen brenda Kuvendit dhe jashtë tij. Ne jemi të interesuar që të largohet kjo Qeveri dhe të kemi zgjedhje të parakohshme", ka deklaruar Kurti

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti thotë se me LDK janë duke bashkëpunuar për të siguruar numrat për rrëzimin e Qeverisë, transmeton Gazeta Metro.

Kurti shprehet kategorikisht kundër propozimeve për një Qeveri gjithëpërfshirëse apo edhe teknike, duke shtuar se partie e tij nuk udhëhiqet nga parashikimet, por nga parimet.

"Ne të Lëvizjes Vetëvendosje nuk udhëhiqemi nga parashikimet, por nga parimet. Ne dëshirojmë që të ketë sa më parë për interesin e vendit zgjedhje të parakohshme parlamentare, zgjedhje demokratike nga të cilat do të dalin institucione me legjitimitet të freskët edhe qeveri e re, e cila do t'i hap rrugë zhvillimit ekonomik të vendit që koncentrohet në prodhim e punësimi dhe tek drejtësia institucionale dhe gjyqësore, e cila përqendrohet te luftimi i krimit e korrupsionit", ka thënë Kurti, për Ekonomia Online.

"Nuk besoj që formulat dhe kombinimet qofshin ato për Qeveri teknike apo gjithëpërfshirëse do ta mund ta mbrojnë sovranitetin dhe zhvillojnë ekonominë".

Kreu i VV-së thotë se me LDK janë duke bashkëpunuar për të siguruar numrat për rrëzimin e Qeverisë

"LVV dhe LDK janë partitë më të mëdha në vendin tonë dhe janë parti opozitare që koordinohen brenda Kuvendit dhe jashtë tij. Ne jemi të interesuar që të largohet kjo Qeveri dhe të kemi zgjedhje të parakohshme", ka deklaruar Kurti.

Por, kreu i VV'së thotë që nuk do të mbështesin asnjë iniciativë të Listës Serbe në këtë drejtim.

"Natyrisht që ne nuk mbështesim iniciativat që burojnë nga Lista Serbe, por është përshtypja ime që Lista Serbe nuk është e interesuar për rrëzimin e Qeverisë. Ajo është e interesuar për një Qeveri të dobët", tha ai

Dokumenti i CIA-s: Në Kosovë nuk ka turq, ata i krijojnë Serbia për të zhdukur identitetin shqiptar

Pushteti serb me propagandën ndaj gjuhës shqipe shkoj aq larg sa që thoshin se gjuha shqipe është e varfër dhe duhet përdorur vetëm me njerëzit e paarsimuar



Në dokumentin e CIA-së të vitit 1951 tregon politikën e poshtë serbo-komuniste kundër identitetit kombëtar shqiptar, duke tentuar më çdo kusht për të zbehur ndjenjat kombëtare të shqiptarëve në ish-Jugosllavi.

DOKUMENTI I CIA-S

"Autoritetet jugosllave shfrytëzuan injorancën e popullatës së shqiptarëve me pretekstin se ata ishin turq për shkak të besimit të tyre mysliman, mohuan pastaj të drejtën për të folur gjuhën e tyre dhe u përpoqën të zhduknin traditat e tyre

dhe ndjenjat patriotike dhe kombëtare. Dokumenti thotë se në Kosovë, nuk ka pasur kurrë turq, por familje shqiptare që flisnin turqishten. Dhe pushteti serbo-komunist kishte dhënë privilegje për familjet shqiptare që dërgonin fëmijët e tyre në shkollat turke. Ata shkuan aq larg sa nxiten edhe përçarje mes shqiptarëve mysliman dhe shqiptarëve katolikë.

Familje të shumta shqiptare që jetojnë në Prizren, Prishtinë dhe Pejë e flasin turqishten po aq rrjedhshëm sa edhe shqipen. Si rezultat, ekziston një përpjekje nga ana e serbëve për të thënë se

ata që flasin gjuhën turke kanë origjinë turke dhe prandaj duhet të arsimohen në atë gjuhë. Ata përfitojnë nga ndjenja e thellë fetare në mesin e popullsisë së asaj zone për të dekurajuar miqësinë që myslimanët kosovarë kanë me katolikët e asaj zone dhe që ata thonë se nuk tolerohet nga feja myslimane. Prandaj, sipas tyre, shqiptarët që e vazhdojnë këtë miqësi duhet të konsiderohen katolikë dhe rrjedhimisht përse të mos shkojnë në Romë?

Pushteti serb me propagandën ndaj gjuhës shqipe shkoj aq larg sa që thoshin se gjuha shqipe është e varfër dhe duhet për-

dorur vetëm me njerëzit e paarsimuar: Me qëllim të avancimit të interesave të tyre antishqiptare, një pjesë e popullsisë që banonte në qytet flisnin vetëm gjuhën turke për tregti dhe marrëdhënie me qeverinë. Ata injoronin gjuhën shqipe dhe e përdorin për të folur vetëm me personat e paarsimuar. At flisnin turqisht duke e konsideruar turqishten si superiore ndaj shqipes, Pas tridhjetë viteve të dominimit serb, megjithatë, gjuha turke e folur nga ky grup është korrupsion nga një përzjerje e fjalëve shqiptare dhe sllave. Edhe pse ka ende një numër familjesh në qytetet Prizren, Prishtinë, Mitrovicë dhe Vushtrri, të cilët vazhdojnë të flasin turqisht por në zhdukje e sipër.

Pushteti serbo-komunist mbështeti vetëm shkollat në gjuhën turke dhe serbe dhe inkurajonte studentet me ndihma për të vazhduar shkollimin në këto shkolla".

TATËPJETA E SOCIALDEMOKRACISË

EVROPIANE



Bëjeni një provë vetë! Kujtoni emrin e një kreu të një qeverie socialdemokrate në Bashkimin Evropian. Nuk iu bie ndërmend...me të drejtë, sepse nuk jeni i vetmi që duhet të mendohet gjatë për këtë. Portugalia, Malta, Suedia, Sllovakia dhe Rumania qeverisen në BE nga socialdemokratët.

NË SHTETET E MËDHA NUK QEVERISIN SOCIALDEMOKRATËT

Por në shtetet e mëdha të BE si Franca, Italia, Polonia nuk qeverisin socialdemokratët, edhe në Gjermani jo plotësisht (socialdemokratët janë në koalicion me konservatorët, shën.red.). Në Spanjë kryeministri Pedro Sanchez sapo shpalli zgjedhjet e parakohshme dhe nuk dihet, nëse ai do të fitojë zgjedhjet.

Qëllimisht socialdemokratët evropianë zgjedhën të premten (22.02) kryeqytetin spanjoll, Madrid si vend për kongresin e tyre

para zgjedhjeve evropiane në fund të majit. Socialdemokratët që vuajnë në shumë vende nga vlera në rënie, donin të merrnin pak ndriçim nga drita që ende e rrethon Sanchez. Por edhe kjo dëshoi, sepse vetë Sanchez po del në zgjedhje të reja.

Politologu dhe studiuesi i partive politike, Franz Walter në një intervistë me gazetën „Die Zeit” gati që para 10 vjetësh bëri parashikimin se Partia Socialdemokrate gjermane „nuk do të jetë më kurrë parti popullore”. Sepse elektorati i dikurshëm i punëtorëve, zgjedhësit kryesorë të saj është reduktuar. Ata që sot ndjehen të injoruar nga politika përqafojnë më mirë populistët, djathtas apo majtas. Kjo mund të vërehet në shumë vende evropiane.

SONDAZHE JO OPTIMISTE

Në Francë, Itali, Gjermani partitë tradicionale socialdemokrate kanë rënë ndjeshëm në elektorat.

Me gjasë grupi parlamentar socialist në Parlamentin Evropian pas zgjedhjeve të majit do të rrudhet ndjeshëm. Në vitin 2014 socialdemokratët arritën të kapnin 191 vende. Në këtë vit, sipas një prognoze të platformës së studimit të opinionit publik, „Poll of Polls” ata mund të arrijnë vetëm 136 vende. Partia laburiste britanike nuk do të jetë më pjesë e parlamentit të ri, bën që t'u hiqen atyre edhe 21 vende. Megjithatë, kreu i grupit parlamentar socialist në PE, Udo Bullmann, dëshiron të mbetet forca e dytë politike. Pritet që liberalët dhe populistët euroskeptikë pritet të fitojnë shumë vende në Parlamentin e ri Evropian. Forca kryesore mbeten konservatorët, fraksioni i të cilëve, nga 221 vende pritet të dobësohet nga 221 në vitin 2014, në 177 vende.

As kandidati kryesor i socialdemokratëve evropianë për postin e kreut të KE, Frans Timmermans nuk e ka të lehtë. Forca

Socialdemokratët evropianë duan t'i japin zemër vetes për zgjedhjet në Parlamentin Evropian në fund të majit. Me të drejtë, sepse sondazhet e tyre tregojnë tendencën në rënie kudo në Europë

politike që kishin socialdemokratët në Holandë është rrënuar. Socialdemokratët holandezë me gjasë do të dërgojnë vetëm 3 deputetë në PE. Timmermans, shpreson të jetë njëri prej tyre.

Nga ana tjetër brenda familjes socialdemokrate evropiane ka tensione. Socialdemokratët sllovakë apo rumunë nuk janë më socialdemokratë të vërtetë, sipas mendimit të shumë drejtuesve socialdemokratë, por në shumë pika më konservatorë apo nacionalistë se CDU dhe CSU në Gjermani. Më problematike paraqitet situata në Rumania, ku Frans Timmermans, zëvendës-president aktual i Komisionit Evropian akuzoi socialdemokratët, se nuk bëjnë sa duhet kundër korrupsionit dhe ruajtjes së shtetit ligjor. Në Rumania ka zëra se kreu arrogant i socialdemokratëve rumunë planifikon të dalë nga grupi parlamentar i përbashkët në PE. Kjo do të ishte një goditje e re në fushatë zgjedhore për socialdemokratët, pasi rumunët socialdemokratë sjellin në parlament 11 vende. (DW)



Arabia Saudite emëron për herë të parë një grua ambasadore në SHBA

Arabia Saudite bën historinë, për herë të parë emëron një grua ambasadore në SHBA. Krejt kjo për të tentuar ti përmirësojë marrëdhëniet me SHBA-së pas vrasjes të rëndë të gazetarit, Jamal Khashoggi. Princesha Reema bint Bandar do ta zëvendësojë në këtë pozitë princin Khalid bin Salman, i cili është vëllai i vogël i princit në pushtet. Ai tashmë është caktuar zëvendësimistër i mbrojtjes, ndërsa lajmin për këtë ndryshim në diplomacinë saudite e kanë bërë të ditur mediat shtetërore të Arabisë Saudite. Ambasadorja e re do të përballlet me qëndrimet armiqësore të ligjvënësve amerikanë, të cilët kanë kërcënuar se do të ndërmarrin masa kundër Arabisë Saudite për shkak të vrasjes së gazetarit Khashoggi dhe dyshimeve se princi Mohammed bin Salman është personalisht përgjegjës për këtë krim. „Zgjedhja e një përfaqësueseje të re diplomatike paraqet përpjekje të Riadit për t'i freskuar marrëdhëniet me Uashingtonin, ndonëse kjo gjë nuk do të arrihet lehtë, të paktën me Kongresin”, ka thënë Kristian Ulrichsen nga Instituti „Baker.

Brexit, frikë për trazira në Britani

Ka shenja në rritje se pasiguria lidhur me daljen e Britanisë nga Bashkimi Evropian po fillon të ndjehet tek investimet. Një sinjal i tillë ishte njoftimi i prodhuesit japonez të makinave, Nissan për largimin nga Britania



Korrespondenti i Zërit të Amerikës Henry Ridgwell njofton nga Londra se sipas një sondazhi të kohëve të fundit, një e treta e bizneseve britanike mund të largohen jashtë vendit si rezultat i Brexit. Ndërkohë në media kanë rrjedhur edhe planet sekrete të qeverisë për rastet emergjente që prashikojnë evakuimin e mbretëreshës nga Pallati Buckingham në rast trazirash nëse Britania largohet nga BE pa ndonjë marrëveshje.

Për dekada me radhë, firmat japoneze e kanë përdorur Britaninë si portën drejt Evropës. Por vendimi i kompanisë Nissan për të zhvendosur në Japoni prodhimin e modelit të makinës X-Trail ka shkaktuar ankth. Ministri Britanik i Biznesit Greg Clark shpjegon: „Shqetësohem sepse ata kanë vërej-

tur pasigurinë që lidhet me Brexit dhe mendoj se është sinjal serioz për të gjithë në parlament, se ka ardhur koha të zgjidhim këtë pasiguri.”

Ndërsa lidhjet e Britanisë dobësohen, Japonia dhe BE po festojnë nënshkrimin e një marrëveshjeje tregtare që do të përfshijë një të tretën e prodhimit global bruto. Gjatë vizitës në Tokio të hënën Kancelarja Angela Merkel tha se një marrëveshje për Brexit-in ende ishte e mundur.

„Duhet ta dimë nga Britania, kjo është pika kritike, se cilat janë planet e tyre për të ardhmen.”

Me kalimin e ditëve rreziku po shtohet edhe më shumë për mos arrijtjen e një marrëveshjeje për Brexit-in. Planet për raste emergjente të qeverisë të rrjedhu-

ra në media sugjerojnë evakuimin e familjes mbretërore, nëse ka trazira.

Ndër skenarët më të rrezikshëm janë edhe trazirat në rrugë si rezultat i mungesës së ushqimit dhe ilaçeve, ndërsa kufizimet e eksportit të plehrave krijojnë male me mbeturina. Alberto Alemanno është profesor i drejtësisë në shkollën ndërkombëtare të biznesit HEC Paris.

„Duket që është një skenar shumë i komplikuar, që sjell ndërlikime për qytetarët, për bizneset në të dy anët e Kanalit të La Manshit. Por varianti tjetër është rishqyrtimi i marrëveshjes së tërheqjes...jo tërësisht, vetëm përshtatja e procesit që mund të çojë në miratimin e planit nga parlamenti.”

Kjo mund të mos mjaftojë. Bri-

tania po kërkon ndryshime në të ashtuquajturën 'ndalesa irlandeze', e cila kërkon të mbajtet Britaninë të lidhur me rregullat e BE deri në arrijtjen e një marrëveshjeje tregtare, që synon të menjanojë pengesat kufitare mes Irlandës dhe Irlandës së Veriut, ku do të jetë kufiri i tokësor i Bashkimit Evropian me Britaninë. Profesi për politikën evropiane Anan Menon sqaron: „Ata nuk do na ofrojnë ndihmë për mbajtjen në fuqi të rregullave ekzistuese të lëvizjes në kufirin irlandez për një kohë të kufizuar.”

Rihapja e marrëveshjes së largimit mund të bëjë që edhe vende

të tjera të BE-së të kërkojnë ndryshime, kryesisht kërkesat e Spanjës për bisedime mbi sovranitetin e Gjibraltarit, thotë profesori Alberto Alemanno.

„Mund të kemi kërkesa nga disa shtete anëtare, dhe Spanja mund të jetë njëra prej tyre. Po ndryshon edhe faktori politik në Evropë, madje shumë shpejt, para zgjedhjeve të bllokut në muajin maj.”

Një kujtesë se ngërçi aktual është vetëm fillimi i rishikimit të marrëdhënieve të Britaninë me një Evropë në ndryshim, një proces që mund të marrë vite, ose ndoshta dekada.

LUFTA E KINËS DHE RUSISË PËR RAJONIN E BALLKANIT

Otto von Bismarck, ideatori i Gjermanisë së bashkuar dhe ai që e shndërroi këtë të fundit në një prej fuqive më të rëndësishme botërore, i është referuar Ballkanit si një rajon, problemet e brendshme të të cilit shpeshherë kanë tendencë të tërheqin vëmendjen dhe interesin e fuqive të jashtme.

Në të vërtetë, 16 vjet pas vdekjes së tij, vrasja e Arkidukës Franz Ferdinand, nxiti fillimin e Luftës së Parë Botërore. Që prej asaj kohe, Ballkani ka mbetur një rajon gjeopolitik sfidues, me situata shkatërruese për të, si Lufta e Dytë Botërore, Lufta e Ftohtë dhe më e fundit, lufta e egër e ish-Republikës së Jugosllavisë në fillim të viteve 1990. Nga ndarja e ish-Republikës së Jugosllavisë, lindën një sërë shtetesh, paqëndrueshmëria e të cilave vërehet edhe sot e kësaj dite. Kjo u bë më se e dukshme, në fillim të janarit të këtij viti, kur Parlamenti grek votoi për të njohur zyrtarisht Republikën e Maqedonisë së Veriut.

EKSPORTET E MAQEDONISË MBETEN TË VARURA NGA SERBIA

Për një rajon mbi të cilin interesat e Bashkimit Europian, Turqisë, Rusisë, Kinës dhe Shteteve të Bashkuara janë të mëdha, zhvillimi politik dhe ekonomik i një shteti të vogël si Maqedonia e Veriut ka shumë rëndësi. Që nga shpallja e Pavarësisë së saj në vitin 1991, Maqedonia e Veriut po lufton me presionet e vazhdueshme të krijimit të një demokracie në një popullsi që përbëhet shumica nga maqedonas (popull sllav) dhe një pakicë të konsiderueshme shqiptarësh, turqish, romësh, serbësh dhe disa pakicave të tjera.

Jeta politike e vendit ka kaluar disa kriza, ku mund të përmendim luftën e shtetit fqinj të Kosovës që pati ndikim shumë negativ dhe përplasjen e ashpër të armatosur në vitet 2001-2002 midis shqiptarëve të Maqedonisë dhe maqedonasve. Për më tepër, një numër i madh banorësh të Maqedonisë ishin pjesë e fluksit të madh të emigrantëve nga Lindja e Mesme në Europën Perëndimore, që e përkeqësoi situatën në vend.

Sikur të mos mjaftonin problemet e mësipërme, ekonomia e Maqedonisë së Veriut është një nga më të varftrat në Europë. E lidhur ngushtë me ekonominë e madhe të Jugosllavisë, shteti i ri i pavarur mori masa të konsiderueshme për zhvillimin e ekonomisë.

Edhe pse Gjermania dhe vendet e tjera të BE-së janë tani ndër partnerët e mëdhenj tregtarë, eksportet e Maqedonisë mbeten të varura nga kalimi në tregjet e Europës së Veriut nëpërmjet Serbisë. Perspektiva e Maqedonisë së Veriut mbetet sfiduese. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, papunësia është mbi 20%, tregu i punës ka mungesa të theksuara të fuqisë punëtore, sistemi arsimor ka nevojë për rishikim rrënjësor dhe duhet që sistemi gjyqësor të jetë i paanshëm. Të gjithë këta janë faktorë të nevojshëm për të përmirësuar investimet



Rajoni i Ballkanit pritet të jetë kufiri i ardhshëm gjeopolitik, për këtë arsye, Rusia dhe Kina janë të etura për të investuar në të

dhe për të rritur perspektivat. Infrastruktura më e mirë është e domosdoshme për zhvillimin e vendit, veçanërisht në transport.

Por ky shtet ballkanik u përball edhe me një problem tjetër; pavarësisht interesit të Shkupit (kryeqytetit të vendit) për tejkalimin e izolimit diplomatik dhe dëshirës së tij për t'u bërë anëtar i BE-së dhe NATO-s, rruga drejt anëtarësimit u ndërlikua dhe u pengua nga Greqia.

Problemi mes Republikës së Maqedonisë dhe Greqisë daton në fillim të vitit 1991, në lidhje me emrin e shtetit të ri. Për Greqinë, emri i shtetit të ri ishte i njëjtë me emrin e rajonit në veri të Greqisë që njihet si Maqedonia greke dhe ka si qytetin e saj të dytë më të madh, Selanikun.

Frika e Greqisë ishte se nëpërmjet pretendimit se ishte "Maqedonia", qeveria e Shkupit një ditë mund të dëshironte të krijonte një Maqedoni më të madhe, e cila do të përfshinte pjesë të Greqisë veriore, Bullgarisë jugperëndimore, Shqipërisë juglindore, Kosovës jugore dhe Serbisë. Por duke qenë se shteti i ri kishte fillimisht nevojë për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike dhe të bashkohej me organizatat ndërkombëtare, ai u bë i njohur si ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (FYRM), dhe që në vitin 1993 iu bashkua Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Presioni për të gjetur sa më parë

një zgjidhje për këtë problem ishte shumë i madh për të dyja vendet. Ai u theksua në dekadën e fundit, duke qenë se lidhjet tregtare midis dy vendeve gradualisht u zgjeruan. Depresioni i viteve 2010-2017 që kaloi Greqia, bëri që ajo ta shikonte me prioritet përmirësimin e marrëdhënieve me fqinjin e saj në veri.

Dhe në fakt, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë po luan rol të rëndësishëm në formimin e tubacioneve të reja të energjisë që lidhin Rusinë dhe tregjet europiane. Greqia, e cila është e varur nga energjia e importuar, do të përfitonte shumë nga përmirësimi i marrëdhënieve me shtetin fqinj në veri të saj.

RUSIA

Në dekadën e fundit, rusët kanë qenë shumë aktivë në rritjen e pranisë së tyre në Ballkan, një rajon me interes tradicional. Planet e ndryshme për tubacionet për gazin rus (duke u munduar të anashkalojnë Ukrainën me të cilën Rusia ka marrëdhënie të tensionuara) përfshijnë Maqedoninë e Veriut në mesin e vendeve të tjera. Në të njëjtën kohë, Maqedonia e Veriut po punon për të ndërtuar një tubacion të gazit natyror dhe rrjetin e shpërndarjes. Shumica e gazit natyror vjen në Maqedoni nga Rusia dhe kalon nëpërmjet Bullgarisë.

Gjithsesi, në vitin 2016, Maqedonia e Veriut dhe Greqia nënshkruan një memorandum mirëkuptimi për të ndërtuar një interkonjektor që mund të lidhë me Gazsjellësin Trans Adriatik ose me një terminal të importit të Gazit Natyror të Lëngshëm në Greqi. Për Rusinë do të ishte ideale që Maqedonia e Veriut të mbetej jashtë çdo

aleance perëndimore, si NATO dhe BE.

Rusia do të preferonte që Maqedonia e Veriut dhe vendet e tjera të rajonit të ndikoheshin më shumë prej saj. Por sipas ish-ambasadorit të SHBA-së në NATO, Kurt Volker, "edhe pse në mënyrë të ngadaltë, rajoni i Ballkanit me siguri që do të bëhet një pjesë e Europës, gjë që do të ndikojë negativisht në ambiciet e Rusisë për të mbajtur Europën të ndarë në sfera të ndryshme ndikimi; duke u munduar që të legjitimojë zbatimin e sundimit nëpërmjet formave jodemokratike, për krijimin e mundësive në mënyrë që Rusia të ushtrojë ndikimin nëpërmjet korrupsionit, operacioneve të inteligjencës dhe keqinformimit.

Aty ku Rusia e sheh paqëndrueshmërinë, pasigurinë dhe dobësinë si mundësi për të avancuar dhe për të rritur ndikimin e saj, BE përipiqet që të krijojë stabilitet, siguri dhe prosperitet". Rusia ka qenë aktive edhe në pjesë të tjera të Rajonit të Ballkanit, duke përfshirë Bullgarinë dhe Rumaninë, ku dyshohet se ka ndikuar në zhvillimin e procesit zgjedhor. Edhe në Mal të Zi po hetohet grushti i shtetit gjatë 2016, i cili mendohet se është nxitur nga rusët.

Strategjia e Rusisë është të vazhdojë të ketë një rol të rëndësishëm në rajonin e Ballkanit, sidomos në ato shtete ku ndikimi i BE-së është i madh (në drejtim të tregtisë dhe investimeve), por ai është edhe një rajon që ka nevojë për ndihmë në drejtim të infrastrukturës.

Avantazhi i Rusisë është se politika e brendshme e BE-së po e ngadalëson pranimin e anëtarëve të rinj, duke lënë vende si Maqedonia e Veriut, Bosnja, Mali i Zi, Serbia dhe

Shqipëria jashtë bllokut të saj. Kina ka qenë një nga shtetet e gatshme dhe të afta për të angazhuar rajonin e Ballkanit, përfshirë edhe Maqedoninë e Veriut.

KINA

Kina ka qenë aktive në ofertat e ndryshme që i ka bërë rajonit në drejtim të infrastrukturës, veçanërisht në sistemin e transportit. Sipas Institutit Amerikan të Sipërmarrjeve, Investimet e Huaja Direkte të Kinës në Maqedoninë e Veriut gjatë periudhës 2005-2018 kanë arritur në 400 milionë dollarë dhe të gjitha kanë qenë në sektorin e transportit.

Për Kinën, Maqedonia e Veriut është një lidhje e rëndësishme ndërmjet njërive të saj në portin në Greqi (ku ka investuar në të njëjtën periudhë 9.88 miliardë dollarë nga të cilat 6.7 miliardë dollarë në fushën e transportit) dhe Serbi (ku ka investuar 10.2 miliardë dollarë, nga të cilat 4.84 miliardë dollarë kanë qenë në sektorin e transportit dhe 3.07 miliardë dollarë në sektorin e energjisë).

Ndërkohë që Kina vazhdon modernizimin e rrugës së vjetër të mëndafshit nëpërmjet nismës së saj "Një Rrip, një Rrugë", Ballkani duke përfshirë edhe Maqedoninë e Veriut, do të fitojë rëndësi më të madhe në tregjet më të gjera dhe më të pasura të Europës Perëndimore. Duke marrë parasysh sa më sipër, votimi i Parlamentit grek më 25 janar në favor të një marrëveshjeje me fqinjin e saj verior, për të njohur vendimin për të ndryshuar emrin nga Maqedoni në Republikën e Maqedonisë së Veriut, do të ketë pasoja të konsiderueshme. Votimi grek është një hap i rëndësishëm në drejtim të stabilitetit rajonal dhe një fitore për BE-në, në lojën gjeopolitike të Ballkanit.

Është e rëndësishme që Maqedonia e Veriut të avancojë sa më shpejt në drejtim të anëtarësimit në NATO dhe BE. Një prej të parëve që reagoi pozitivisht ndaj këtij lajmi ishte Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, i cili shkroi në rrjetin social, Twitter se vota është "një kontribut i rëndësishëm për stabilitetin dhe prosperitetin e rajonit. Unë jam pro dhe po e pres me padurim momentin që Maqedonia të jetë pjesë e NATO-s", tha z. Stoltenberg.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë njohur Republikën e Maqedonisë që në fillimet e saj dhe kanë mbështetur anëtarësimin në NATO dhe në të gjitha institucionet e tjera euroatlantike. Në shtator të 2018, kur Sekretari i Mbrojtjes i asokohe, Jim Mattis, vizitoi Shkupin, ai e cilësoi atë si "një partner i besueshëm i sigurisë dhe një kontribuues i rëndësishëm i paqes dhe sigurisë globale.

Në të njëjtën kohë, z. Mattis vuri në dukje se Rusia po zhvillonte një fushatë të fshehtë propagandistike në shtetin e Maqedonisë kundër ndryshimit të emrit të kësaj të fundit në Maqedoninë e Veriut.

(Scott B. MacDonald
The National Interest)

A ËSHTË POEZIA ENDE E MUNDSHME?

Ajo që e thellon dilemën se a do të jetë në gjendje poezia të mbijetojë në universin e komunikimit masiv, është pikërisht frika nga tjetërsimi i natyrës njerëzore, nga zvogëlimi i ndjeshmërisë krijuese, nga erozioni shpirtëror i kombeve etj



Vjollcë Berisha

Të gjithë ne që jemi mësuar të zhgaravim mbi një copë letër, duke u munduar të shtrydhim deri në pikën e fundit ndjeshmërinë tonë dhe aftësinë për të thithur të dukshmen e të padukshmen në botë, jemi tërësisht të lidhur me litarët e dyshimit nëse poezia është ende e mundshme në kohën e komunikimit masiv e në kohën e informacioneve krejtësisht të pafiltruara që mëtojnë ta stërmbushin kujtesën e ta trashin shijen tonë estetike.

Në të gjitha epokat e njerëzimit, buzë secilit ndryshim a secilës prirje për një prurje të re, janë gjetur reflektime të këtila që dridhen nga frika e fundit të poezisë më shumë se nga mendimet mbi apokaliptin dhe gjithnjë pas tyre, si përgjigje lakonike, ka gdhirë pohimi ricosian se "sa është e pashtershme jeta, po aq është e pashtershme edhe poezia."

Nëse ende sot flasim për një prodhim tërësisht subjektiv me të gjitha karakteristikat e fisnikërisë njerëzore, një prodhim që domosdo i nënshtrohet edhe ligjeve të shijes dhe modës, është lehtësisht e kuptueshme që të vihemi përballë frikës që ngjallin format e reja të krijimtarisë, shumësisë së teksteve poetike që shpërthejnë si dëshirë për t'i bërë bashkë dy-tri figura, jo rrallë shterpe, apo dy-tri rima, jo rrallë foljore, që në kohën e medias kanë dhe mundësinë të gjejnë lehtë rrugën për te publiku, rrugë këto që në asnjë rast nuk u siguron një biletë udhëtimi për në krye të listës së vlerave letrare, por që arrijnë të çrregullojnë shumëçka në baraspeshën e listës, duke e krijuar kaosin receptiv në të cilin padashur humbin vëmendjen krijimet e vërteta dhe autorët e tyre të talentuar.

Duke qenë plotësisht prodhim i ndjenjave më të thella e më të holla njerë-

zore, si dhe duke qenë fryt i vetmisë krijuese dhe i përshtypjeve të akumuluar, te poezia, më shumë se te të gjitha artet, vihet re edhe trandja më e vogël në botën e njeriut, në mënyrën e jetesës, bile edhe në kurbën e ëndrrave të tij. Ajo, si një sizmologe e kujdesshme, shënon të gjitha ndryshimet në shijen e përgjithshme, në hapësirat e caktuara për interesime të veçanta të stilit, në ndikimet e ndërsjella të artit të kombeve e kohërave, si dhe të gjitha prirjet për shmangiet eventuale nga shprehja e deriatëhershme artistike.

Mungesa e vëmendjes së përgjithshme ndaj këtij arti të veçantë, zvogëlimi i atij publiku elitar që e thith me një frymë poezinë, përmbysja e vlerave të mirëfillta poetike, mosvëmendja e merituar, vërshimi i pseudopoezisë dhe humbja e garës së poezisë ndaj këtij fenomeni efemer, janë vetëm disa nga krizat që i kalon arti në epokën tonë. Ajo që e thellon dilemën se a do të jetë në gjendje poezia të mbijetojë në universin e komunikimit masiv, është pikërisht frika nga tjetërsimi i natyrës njerëzore, nga zvogëlimi i ndjeshmërisë krijuese, nga erozioni shpirtëror i kombeve etj.

Njeriu i sotëm, evropiani i djepit të qytetërimit botëror, përfshirë edhe homo-balkanicusin dhe homoalbanicusin (prodhuesi i fundit i eposit si lloj i veçantë letrar), e ka ulur për disa gradë temperaturën e ndjeshmërisë njerëzore, aftësisë së tij të rrezatimit shpirtëror. Ai është njeriu që s'ka më durim të shtrohet në biseda të gjata tavolinash, por e pi kafënë me një gllënkë të vetme në banak dhe niset ta harxhojë ditën si shkumës. Ai është njeriu që nuk ka durim të shfletojë me gishtin tregues nga mëngjesi në mbrëmje të njëjtën gazetë, por shtrydhet midis dritareve të shumta të ekranit të celularit që i servon një ujëvarë informacionesh të selektuara e të paselektuara që ia

mbysin orët e mbamendjen. Ai është njeriu që s'dridhet nga frika se mund të mos jetë marrë vesh mirë për kohën e vendin e takimit me një mikeshë të vjetër, pasi në çdo çast mund ta verifikojë me një telefonatë dy-trisekondëshe. Ai është njeriu që s'e njeh as dorëshkrimin e atij që i dërgon puthje vizuale dhe letra pa mbarim...Ai është njeriu që po vrapon drejt robotizimit. Poezia e tij kërkon të jetojë, siç ka jetuar edhe në kohëra të rrezikshme (bile ku e ku më mirë), siç ka jetuar kur s'e ka pasur këtë trajtë që ka sot.

Megjithë këto ndryshime në botën që na rrethon, me gjithë mëdyshjen tonë se ç'orakull mund ta parashihte fatin e poezisë së njerëzimit, kemi kaq shumë të drejtë për të dhënë përgjigje afirmative, në të mirë të poezisë. Mjafton të flasim për dëshirën e nevojën e njeriut për art edhe para qytetërimeve, për format e ndryshme të poezisë që kanë përfaqësuar kohëra të ndryshme, madje edhe mometet më të rënda të historisë së njerëzimit janë brendashkruar në dëshirën për art, për të ardhur te kjo përgjigje afirmative për vazhdimin e fjalës poetike, ndoshta sipas profecisë së poetit grek Karlos Kuerios që thotë:

Durim, poet durim!

Pa shpirt ky ç'qytetërim?

Njerëzimi, me shkencë të thatë ngarkuar, i zbehtë

i shpërftyruar, nesër te porta jote do trokasë i penduar.

Do kthehet, vëlla, do kthehet e do shikosh me lot në sy të lypë një këngë për lëmoshë.

Ose sipas konstatimit të drejtë të Tagorës, i cili, përkundër profetizimeve mbi humbjen e primatit të poezisë në raport me artet e tjera apo të vdekjes së saj, thotë që poezia do të vazhdojë të shkruhet derisa dy njerëz të dashuruar të ecin mbi këtë tokë.



JOSIF BRODSKI

Elisaveta Leskajës

*Ka ngrirë ajri dhe drurët halorë
veshim xhupat edhe gëzofët,
Me torbën në sup nëpër borën e pushtë
më mirë dre se gamile dygungshe.
Në se besojnë këtej në një Zot,
me komandantin e burgut ngjason,
burgun ku brinjët të dhembin, të therin
dhe të thërresin, do ca të tjera!
Në jugë ku bie dëborë aq pak,
besojnë në Krishti, q' u ngjan endacak:
u lind shkretëtirës, në vërë dhe kashtë
dhe vdiq, siç thonë, prapë përjashta.
Le ta kujtojmë me verë e simite
jetën që rrodhi nën qiellin plot dritë,
që t' i shpëtojmë arrestit të dhunshëm
për deri sa toka ka vend aq shumë.*

Dashuria

*Dy herë u zgjova sonte këtë natë
dhe shkova drejt dritares ku fenerët,
si pikat e një fraze mbetur n'erë,
një fraze të këputur aq të gjatë,
s' më dhanë qetësi mua as prehje.
Në ëndërr ti shtatzënë m' u fanite,
megjithëse prej vitesh ishim ndarë,
gabimi më i rëndë si një barrë,
duart përmbi bark duke rrëshqitur,
kërkonin nëpër pantallonat
çelësin. E dija duke shkuar
drejt dritares së vjetër në errësirë,
në ëndërr, duke pritur me dëshirë
dhe fatin nuk ma hidhe aspak mua
dhe as kësaj ndërprerjeje të shtirë,
sepse në errësirë zgjat gjithmonë
ajo që u ndërpre dikur në dritë.
Ne ishim të martuar ato ditë
përbindsha lakuriq e me kurorë,
dëshmi e saj na ishin vetë fëmijët.
Do vijë dita, mbase, do të kthehesh
një natë dhe e lodhur dhe e dobët
dhe unë do ta shoh fëmijën tonë,
një djalë a një vajzë të paemër
dhe nga çelësi do ta heq dorën.
Nuk do ta zgjat, nuk kam aspak të drejtë
t' ju le në mbretërinë e errësirës,
në atë heshtjen plumb të hapësirës,
fundosur nga kjo gjendje e vërtetë,
nga kjo dëshira ime e paarrirë.*

Në kafene

*Nën kurorën e rrapit që fëshfërit "fësh-fësh"
dhe e bën kafenenë sikur s' ekziston më,
vend si të tjerët, si çdo dru që fëshfërit,
gjelbërimi është i përjetshëm. Rrap qoftë a lis,
si të thuash, nuk jam askush dhe jam çdo njeri,
një njollë e tharë në tablonë plot gjallëri
që jeta e shkruan me penelin e saj vetë
siç nuk ka një palitër tjetër në jetë.
Shfletoj gazetën "fësh-fësh" i menduar,
nga cili model kjo është skicuar,
pa adresë, pa emër, formën e mosekzistencës
përsëritim rrapit edhe unë këtë mbrëmje të verës.*



Në bazë të Planit operativ të programeve dhe masave të punësimit dhe shërbimeve në tregun e punës për vitin 2019, e miratuar nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për masën aktive Trajnim në vendin e punës për punëdhënësit të njohur Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut, më datën **25.02.2019**, boton

SHPALLJE PUBLIKE

për personat e papunë

U bëhet thirrje personave të evidentuar si të papunë të cilët kërkojnë punë në mënyrë aktive dhe të cilët janë të interesuar për t'u përfshirë në masën e Trajnimit në vendin e punës për punëdhënësit të njohur, që të paraqiten në klubet e qendrave të Agjencisë së Punësimit të RMV-së, ku rregullisht evidentohen si të papunë çdo ditë prej orës 9,00 deri më 14,00.

Kandidatët e zgjedhur do të kalojnë një trajnim tremujor dhe kjo do të mbahet në hapësirat e punës së punëdhënësit në përputhje me programin e trajnimit e propozuar nga ana e punëdhënësit. Pjesëmarrësve të stërvitjes do t'u jepet vërtetim për ndjekjen e trajnimit praktik.

Personat e papunë do të marrë pagesë me të holla prej 9.000,00 denarë në muaj, duke përfshirë këtu edhe sigurimin në rast fatkeqësie gjatë punës dhe sëmundjes profesionale.

Punëdhënësi është i detyruar që t'i mbajë në punë më së paku 50% të personave dhe të mos e zvogëlojë numrin e përgjithshëm të personave të punësuar për kohë të pacaktuar me orar të plotë pune në një periudhë prej gjashtë muajsh.

Shfrytëzuesve të kompensimit me të holla do t'u vazhdohet e drejta e pagesës deri në mbarimin e stërvitjes, ndërsa shfrytëzuesit e ndihmës sociale do të vazhdojnë të marrin ndihmë me të holla gjatë stërvitjes. Nëse shfrytëzuesi i ndihmës sociale nxirret nga puna para mbarimit të trajnimit, ka të drejtë të kthehet në regjistrin e shfrytëzuesve të ndihmës sociale.

Kushtet, të drejtat dhe detyrimet me të përcaktohen me nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, punëdhënësit dhe kandidatëve.

Personat e papunë që janë të interesuar për këtë shpallje, fletëparaqitjet mund t'i dorëzojnë deri në plotësimin e numrit të planifikuar.

Për informata më të hollësishme vizitoni klubet për punësim në qendrat e punësimit, si dhe ueb faqet siç vijojnë:

Agjencia e Punësimit: www.av.gov.mk

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale: www.mtsp.gov.mk

AGJENCIA E PUNËSIMIT
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të Planit operativ të programeve dhe masave aktive të punësimit dhe shërbimeve në tregun e punës gjatë vitit 2019, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për masën aktive 5. Praktikiteti, të financuar nga buxheti i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më datën 25.02.2019, bën

SHPALLJE PUBLIKE

për personat e papunë

1. U bëhet thirrje të rinjve deri në moshën 34 vjet, të cilët janë të papunë, të cilët së paku e kanë mbaruar arsimin e mesëm, dhe të cilët nuk kanë përvojë pune në përputhje me nivelin e ulët ose me profilin arsimor, që të përfshihen në masën e Praktikitetit për periudhën deri tre muaj te punëdhënësit me qëllim të marrjes së disa njohurive dhe shkathtësive praktike, që të paraqiten në klubet e qendrave të Agjencisë së Punësimit të RMV-së, çdo ditë prej orës 9,00 deri më 14,00.

2. Për secilin kandidat që do të zgjidhet dhe që do të përfshihet në masën e praktikitetit, është paraparë mbështetje financiare në një shumë prej 9.000,00 denarë në muaj (duke përfshirë edhe tatimin personal për të ardhurat dhe sigurimin në rast fatkeqësie dhe sëmundjes profesionale) për periudhën gjatë së cilës bëhet puna praktike.

3. Personat e papunë të cilët janë të interesuar për të marrë pjesë në këtë masë mund të aplikojnë deri në plotësimin e numrit të paraparë të shfrytëzuesve.

4. Kushtet, të drejtat dhe detyrimet do të përcaktohen me nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet Agjencisë së Punësimit të RMV-së, punëdhënësit dhe kandidatëve.

Informata më të hollësishme mund të merren në klubet e 30 qendrave të Agjencisë së Punësimit, në tel. 02/3111-850, si dhe ueb faqen www.av.gov.mk

AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të Planit operativ (PO) për programe dhe masa aktive të punësimit dhe shërbimeve në tregun e punës për vitin 2019, miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për masën aktive 3.2 – Trajnim për kualifikime profesionale sipas nevojave të punëdhënësit, financiar nga buxheti i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në bashkëpunim me UNDP-në, më datë **25.02.2019**, hapet

THIRRJE PUBLIKE

për punëdhënësit

- U bëhet thirrje punëdhënësit të cilët kanë nevojë të sigurojnë punëtorë të kualifikuar nëpërmjet trajnimeve, të paraqiten në klubet e punës së Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për të marrë pjesë në këtë aktivitet.
- Trajnimit do të kryhet nga ana e: qendrave për trajnim profesional dhe/ose shkollave të mesme profesionale, si dhe punëdhënësit në përputhje me programin e verifikuar paraprakisht nga ana e Qendrës së arsimit për të rritur dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
- Punëdhënësi është i obliguar të punësojë 50% të personave të cilët me sukses kanë kryer trajnimin dhe të mos zvogëlojë numrin total të të punësuarve me orar të plotë pune në periudhë prej 6 muajve, përveç nëse arsyet për ndërprerjen e punësimit janë nga fajësia dhe vullneti i të punësuarit, ushtrimi i të drejtës për pension, vdekje, paaftësi për punë dhe jo si rezultat i arsyeve të biznesit
- Punëdhënësi i cili do punësojë më shumë se 50% të personave të cilët kanë marrë pjesë në trajnim, për ata persona do të mund t'i shfrytëzojë përfitimet nga Programi 2 - MBËSHTETJE PËR KRIJIMIN E VENDEVE TË REJA TË PUNËS nga PO 2018, në përputhje me kriteret e vendosura
- Punëdhënësi e interesuar për pjesëmarrje në këtë aktivitet mund të aplikojnë deri në fund të këtij viti (31.12.2019), përkatësisht deri në plotësimin e numrit të paraparë.
- Të drejtat dhe obligimet mes APRMV-së, UNDP-së dhe pjesëmarrësve, do të rregullohen në bazë të marrëveshjes së përbashkët.

Fletëparaqitja për pjesëmarrje duhet të dorëzohet në klubet e punës së qendrave për punësim çdo ditë pune prej orës 09:00 – 14:00.

Informata shtesë mund të merren në klubet e qendrave për punësim ose në kontakt telefonin 02/ 3111-850 lokali 114, si dhe ueb faqen www.av.gov.mk.

AGJENCIA E PUNËSIMIT
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të Planit operativ të programeve dhe masave aktive të punësimit dhe shërbimeve në tregun e punës gjatë vitit 2019, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për 6.2 Programin e angazhimit në punë – punëve publike, të financuar nga buxheti i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më datën **25.02.2019** bën

SHPALLJE PUBLIKE

për NJËSITË E VETADMINISTRIMIT LOKAL DHE QYTETIT TË SHKUPIT

U bëhet thirrje njësitëve të vetadministrimit lokal dhe Qytetit të Shkupit, të cilat janë të interesuara për organizimin e punëve publike nëpërmjet angazhimit të personave që janë të evidentuar si të papunë me kualifikime të ulëta në projektet me karakter infrastrukturor dhe të mbrojtjes së mjedisit jetësor, që të paraqiten në klubin e punës së Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut – qendrën e punësimit ku është selia e NJVL-së.

Për realizimin e këtij programi është paraparë mbështetje financiare në një shumë prej 400 denarë për secilin person të angazhuar gjatë ditës, duke përfshirë këtu edhe tatimin personal dhe sigurimin për invaliditet dhe dëmtim fizik i shkaktuar në punë dhe sëmundje profesionale. Njësitë e vetadministrimit lokal dhe Qyteti i Shkupit do të marrin pjesë me kofinancim me mjete prej 20% për person të angazhuar gjatë ditës.

Mjetet do të transferohen pas kalimit të angazhimit të punës në njësitë e vetadministrimit lokal dhe Qytetit të Shkupit.

Angazhimi i personave të papunë mund të realizohet në një cikël gjatë vitit nga ana e njësitëve të vetëqeverisjes lokale dhe qytetit të Shkupit.

Kushtet, të drejtat dhe detyrimet do të rregullohen me nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet njësitëve të vetadministrimit lokal dhe Qytetit të Shkupit dhe Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Shfrytëzuesit e të drejtës së ndihmës sociale gjatë kohëzgjatjes së angazhimit do ta kenë aktive të drejtën e tyre për shfrytëzimin e kësaj ndihme.

Njësitë e vetadministrimit lokal dhe Qyteti i Shkupit paraqitjen e bëjnë me dorëzim e fletëparaqitjes së formularit të unifikuar në formë të shkruar më së voni deri më **31.03.2019** në klubin e punës së Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut – qendrën e punësimit ku ndodhet selia e NJVL-së.

NJVL e interesuar dhe Qyteti i Shkupit mund t'i dorëzojnë fletëparaqitjet në qendrat e punësimit çdo ditë pune prej orës 09:00 – 14:00. Informata më të hollësishme mund të merren në klubet e qendrave të punësimit, në telefonin kontaktues 02/3111-850 si dhe në ueb faqen e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (www.av.gov.mk) dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (www.mtsp.gov.mk).

AGJENCIA E PUNËSIMIT
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të Planit operativ të programeve dhe masave të punësimit dhe shërbimeve në tregun e punës gjatë vitit 2018, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për masën aktive të 3.3 Stërvitjes për zejtarë, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut, më datën 25.02.2019 bën

SHPALLJE PUBLIKE

për personat e evidentuar si të papunë që janë të interesuar

U bëhet thirrje personave të evidentuar si papunë, të cilët janë të interesuar për të marrë pjesë në stërvitjen për aftësi në zej, që të paraqiten në klubet e qendrave të punësimit ku janë të evidentuar si të papunë më së voni deri 15.03.2019.

Stërvitjet kanë të bëjnë me këto zejtarë:

- përpunues i metalit, me minimum shkollë fillore,
- bukëpjekës, me minimum shkollë fillore,
- ëmbëltorist, me minimum shkollë fillore,
- Automekanik, me minimum shkollë fillore.

Stërvitja (pjesa teorike dhe praktike) do të realizohet në një periudhë prej 6 muajve në kushte reale të realizuesit i stërvitjes.

Personat e papunë, që do të përfshihen në stërvitje, do të marrin një pagesë mujore prej 9.000,00 denarë, duke përfshirë këtu edhe tatimin personal për të ardhurat dhe sigurimin në rast fatkeqësie gjatë punës dhe sëmundjes profesionale.

Personat e papunë, të cilët do ta mbarojnë stërvitjen (pjesën teorike dhe praktike) dhe që do ta japin me sukses provimin përfundimtar, do të marrin certifikatë për aftësi dhe kompetenca, të lëshuar nga Dhoma e Zejtareve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Shfrytëzuesve të pagesës me të holla dhe shfrytëzuesit e të drejtës së ndihmës në para nga mbrojtja sociale, gjatë kohës që zgjat stërvitja nuk e humbin atë të drejtë.

Kushtet, të drejtat dhe detyrimet do të përcaktohen me nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe kandidatëve.

Personat e papunë që janë të interesuar, fletëparaqitjet e tyre mund t'i dorëzojnë në qendrat e punësimit prej orës 09:00 deri 14:00. Informata të hollësishme mund të merren në klubet e qendrave të punësimit, ku janë të evidentuar si të papunë, në telefonin kontaktues 02/3111-850 dhe ueb faqen e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (www.av.gov.mk) dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (www.mtsp.gov.mk)

AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të Planit operativ të programeve dhe masave të punësimit dhe shërbimeve në tregun e punës gjatë vitit 2019, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për masën aktive të stërvitjes për zejtarë, të financuar nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut, më datën 25.02.2019, bën

SHPALLJE PUBLIKE

për punëdhënësit zejtarë të cilët janë të interesuar

U bëhet thirrje punëdhënësit të cilët janë të interesuar për realizimin e stërvitjeve për zejtarë, nëpërmjet marrjes së aftësive dhe shkathtësive, që të paraqiten në klubet e qendrave të punësimit më së voni deri më 15.03.2019.

Stërvitjet kanë të bëjnë me zejtarë në vijim që do të realizohen tek punëdhënësi :

- Përpunues i metalit, me minimum shkollë fillore,
- Bukëpjekës, me minimum shkollë fillore,
- ëmbëltorist, me minimum shkollë fillore,
- Automekanik, me minimum shkollë fillore.

Punëdhënësit zejtarë të cilët janë të interesuar duhet t'i plotësojnë kushtet siç vijojnë:

- Të dorëzojnë Lejen për zejtar ose ushtrues i veprimtarisë zejtare në përputhje me Ligjin për zejtarë (FI. Zyrtare e RMV nr. 215/15) e dhënë nga Dhoma e Zejtareve.
- Gjendje momentale jo më të vjetër se dy muaj të lëshuar nga Regjistri Qendror i RM-së
- Diploma e mjeshtrit të zejtes nga veprimtaritë e parapara zejtare do të llogaritet si përparësi.

Realizuesit e stërvitjes varësisht nga zëja dhe kohëzgjatja e stërvitjes, e cila mund të jetë 3-6 muaj, do të marrin deri 30.000,00 denarë pagesë me të holla për secilin person të stërvitur.

Kushtet, të drejtat dhe detyrimet do të përcaktohen me nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Dhomës së Zejtareve të Republikës së Maqedonisë dhe punëdhënësit.

Punëdhënësit e interesuar, fletëparaqitjet e tyre mund t'i dorëzojnë në qendrat e punësimit prej orës 09:00 deri 14:00. Informata të hollësishme mund të merren në klubet e qendrave të punësimit, në telefonin kontaktues 02/3111-850 dhe ueb faqen e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (www.av.gov.mk) dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (www.mtsp.gov.mk)

AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

KUSH DURON NJË VIT PA CELULAR, KOMPANIA I OFRON NJË SHUMË MARRAMENDËSE PARASH

Të ndenjurit pa smartfon për një kohë të gjatë është një bast, i cili ende pritët të fitohet: a do të binit dakord të kalonit një vit pa smartfon në këmbim të 100,000 \$?!

Sot, megjithatë, kjo nuk është më një pyetje imagjinare: "Vitaminwater" kohët e fundit lançoi një konkurs që sfidon pjesëmarrësit që të heqin dorë nga smartfonët e tyre dhe tabletët për një vit. Çmimi? 100 000 dollarë!

"Vitaminwater's nophoneoforayear challenge" kërkon që pjesëmarrësit të kalojnë 365 ditë, pa përdorur një smartphon. Kjo do të thotë të heqësh dorë nga telefoni yt dhe tableti, dhe natyrisht që nuk mund të përdorësh as pajisjet e dikujt tjetër.

Personi i përzgjedhur duhet të nënshkruajë një kontratë, që e "detyron" atë të mos e përdorë telefonin gjatë gjithë kohëzgjatjes



së konkursit dhe nëse ai arrin të respektojë këtë pakt, atëherë mund të fitojë çmimin në fund të vitit.

Së pari duhet të aplikosh për të marrë pjesë në këtë konkurs dhe për tu bërë pjesë, duhet të postosh foto në Twitter apo Instagram që t'i shpjegoni "Vitaminwater", pse keni nevojë për një pushim nga smartphoni juaj (duke përdorur #nophoneoforayear dhe #contest


hashtag).

Postimet e paraqitura do të gjykohen në bazë të fantazisë së përdorur, rëndësisë së markës, humorit dhe cilësisë.

Vlen të përmendet se personi i përzgjedhur, nuk do të detyrohet të heqë dorë tërësisht nga telefoni. Në fakt, "Vitaminwater" ofron një telefon celular të vitit 1996, i kompletuar me një plan mujor vetëm për komunikimin me zë.

"Vitaminwater" shpjegoi se ideja është që të inkurajojë njerëzit, që të mos e shpërdorjnë kohën e tyre me smartfonë.

"Ne mendojmë se nuk ka asgjë më të mërzitshme, se sa të rrih me sytë fiksuar në telefon, dhe kjo është një mundësi e mirë për të thyer rutinën duke fituar në këmbim 100 000 \$", thonë organizatorët e këtij konkursi të padëgjuar më parë.



Studim: Ja përse duhet të largoheni nga Facebook

Pavarësisht gjithë skandaleve që kaloi vitin e kaluar, ja ku jemi sot ende në Facebook ku miliona njerëz shpenzojnë të paktën një orë në ditë në rrjetin social. Mbase për një arsye të thjeshtë: kemi krijuar varësi. Dëshironi të ndiheni më mirë? Fshijeni Facebook.

Një studim i ri shkon më tutje, na tregon përfitimet që do të kemi nga mbyllja e Facebook. Studimi quhet The Welfare Effects of Social Media dhe është përpiluar nga hulumtuesit e Stanford dhe NYU. Është një prej hulumtimeve me të vlerësuarat për median sociale dhe atë çfarë ndodh kur largohemi prej tyre.

Duke u larguar nga rrjetet sociale njerëzit bëhen më pozitivë, më subjektivë, forcojnë vëmendjen dhe shpenzojnë më shumë kohë me miqtë dhe familjen.

Hulumtuesit rekrutuan 2,844 përdorues të Facebook dhe më pas u kërkuan gjysmës prej tyre të ç'aktivizojnë llogaritë për një muaj.

Gjatë kësaj kohe i kontrollonin vazhdimisht dhe komunikonin me SMS për ti pyetur sesi ndiheshin.

Ç'aktivizimi shkaktoi përmirësim të gjendjes së tyre psikologjike. Ata ishin më të lumtur, më pak depresivë, ndienin më pak ankth dhe ndjenin kënaqësi më të madhe.

Përdoruesit të cilët u bënë pjesë e studimit arritën të shkëputeshin nga Facebook plotësisht edhe pas përfundimit të tij.

Boeing sjell taksinë fluturuese pa shofer

Një prototip fillestar i taksisë fluturuese pa shofer e ka kryer me sukses fluturimin e parë testues në Manassas, duke shënuar një hap të suksesshëm në vizionin e kompanisë për fluturime pa pilotë.

Mjeti fluturues u ngrit në ajër për një periudhë të shkurtër dhe u lëshua me sukses në tokë, ndërsa brenda tij ndodhej një kukull e madhësisë së një njeriu mesatar. Pajisja komandohet plotësisht nga sistemi i navigimit autonom.

Në pamjet e publikuara nga kompania në YouTube shihet se si një njeri e kontrollon fluturimin e



pajisjes me anë të një teledirigjuesi. Ndonëse është ende në fazën e prototipit, udhëheqësit e kompanisë po e vlerësojnë atë si e ardhmja e udhëtimit të sigurt. Besohet se ajo do të përdoret në qytetet e mëdha me trafik të ngarkuar.

"Kështu duket revolucioni dhe kjo është kryesisht për shkak të fluturimit pa shofer. Autonomia e certifikuar e saj do ta bëjë udhëtimit të qetë, të pastër dhe të sigurt", tha John Langford, shef ekzekutiv i shoqatës "Aurora Flight Sciences", shkruan "The Washington Post".

Çfarë ndodh në një minutë brenda rrjetit të internetit?

Llogaritë janë bërë nga një shoqëri në operon në botën inovative dixhitale dhe rezultojnë se shkëmbehen 187 milionë email, 38 milionë mesazhe në WhatsApp, 18 milionë sms, shkarkohen 375 mijë aplikacione dhe shpenzohen rreth 900 mijë \$ në e-commerce.

Teknologjia po ecën me ritme marramendëse dhe nga statistik

në 2 vitet e fundit është krijuar rreth 90% e gjithë të dhënave të krijuara deri më sot.

Mjafton të theksohet se çdo ditë në mbarë botën gjenerohen 3 kuintilionë byte, ose më saktë një shifër që shkruhet me 18 zero.

Sipas ekspertëve të IT, i gjithë ky volum të dhënash mund të përdoret për të rritur eficientë e kom-

panive, përmirësuar marrëdhëniet me klientët dhe gjithashtu të shfrytëzohet për të krijuar mundësi të tjera biznesi, duke pushtuar kështu tregjet e reja. Në klasifikimin e informacioneve në një minutë renditen edhe 2.4 milionë video në Snapchat, 973 mijë login-in në Facebook, 481 mijë tweet dhe 174 mijë postime në Instagram.





SI ISHTE JETA NË ALPET E ZVICRËS 100 VITE MË PARË

Kur mendojmë për alpet zvicerane, i imagjinojmë plot me skiatorë me kostume shumëngjyrëshe, teleferikë dhe turistë duke ngrënë çokolatë pas një dite të lodhshme duke u

marrë me sport, transmeton TCH.

Por, në fillim të shekullit XX, nuk ka qenë aspak kështu. Malet kanë qenë shumë pak të eksploruara nga njerëzit, siç shihet nga fotot e mëposhtme, që janë bërë

rreth 100 vite më parë.

Këto foto bardhë e zi janë ngjyrosur artificialisht, nëpërmjet një procesi të shpikur në vitin 1880 nga Hans Jakob Schmid.



Bangkoku, qyteti më i frekuentuar në botë nga turistët

Shesh e kemi të vështirë të zgjedhim se ku duam të shkojmë me pushime. Do të mahniteni pasi të mësoni se cili është vendi i duhur dhe më i kërkuari në botë për pushime.

Sipas një raporti të ri nga "Mastercard" ka një qytet që i ka mundur Londrën, Parisin apo Tokion dhe ai është: Bangkoku.

Ky është vendi më i kërkuar pasi ka një mikëpritje të madhe. Sipas të dhënave 19 milionë vizitorë në 2016-n e ka vizituar këtë vend dhe turistët tërhiqen nga arkitektura befasuese e qytetit, kultura e pasur dhe klima tropikale. Po kështu edhe nga çmimet e lira, pasi një turist shpenzon mesatarisht 64 dollarë në ditë.



Si u bë Islanda shteti më i sigurt në botë për turistët?



Studimet e këtij viti kanë treguar se Islanda është shteti më i sigurt në botë për t'u vizituar – madje për të 11-ën herë me radhë.

Është një kompani australiane që merret me analizimin e të dhënave të ndryshme në mënyrë që ta përcaktojë shtetin më të sigurt dhe më të rrezikshëm në botë, nga gjithsej 163 shtete të pavarura sa janë.

Por, si arriti Islanda që prapë të renditet shteti më i sigurt në botë?

Fillimisht duhet të keni parasysh se faktorët që merren parasysh në renditjet e tilla përfshijnë rastet e krimit, sulmet terroriste, numrin e vrasjeve, posedimin e armëve, përqindjen e arrestimeve, korrupsionin dhe funksionin qeveritar.

Ka disa arsye se përse nuk duhet të besohemi nga historia paqësore e Islandës.

Ky komb i vogël nordik me 340,000 banorë, ka një shkallë

shumë të vogël të krimit dhe ndodhin vetëm 1.8 vrasje për 100,000 persona në vit.

Një tjetër arsye është se Islanda nuk ka ushtri fare; qiejt e këtij shteti monitorohen nga ushtritë mysafire çdo vit. Kjo i bën shanset e shkakut të ndonjë lufte shumë të ulëta.

Edhe policia e Islandës janë të paarmatosur dhe kanë filluar të bartin armë vetëm brenda automjeteve.

Filipine, kodrat e çokolatës në ishullin e përrallave

Kodrat e e Çokolatës në Filipine janë një formacion gjeologjik i veçantë. Ato e kanë marrë emrin çokolatë sepse gjatë periudhës së thatësirës ato marrin ngjyrën e errët si të një çokollate. Aty gjenden rreth 1260 kodra të tilla.

Në pjesën ku fillon peisazhi kodrinor gjenden dy vendpushime turistike, Kompleksi Kodrat prej çokollate dhe Maja Sagbayan, prej ku pamjet e kësaj mrekullie natyrore janë magjepsëse.

Sipas legjendës, thuhet se pei-

sazhi ishte formuar nga lotët e tharë të gjigantit Arogo, i cili kish-te qarë për shumë kohë kur i kish-te vdekur e dashura. Megjithëse, me të vërtetë joshëse për t'u besuar se një bukuri e tillë është krijuar nga forca mbinatyrore.



Japonezët flenë shumë pak, mësoni sa orë

Japonezët bëjnë shumë pak orë gjumë! Rreth 40 për qind e njerëzve në Japoni flenë më pak se gjashtë orë natën, ndërsa shumica e japonezëve flenë më pak se shtatë orët e rekomanduara, sipas një studimi. Sondazhi Kombëtar për Shëndetësi i ka regjistruar zakonet e 3.500 japonezëve gjatë vitit 2015, dhe ka gjetur se një numër rekord i burrave dhe grave nuk pushojnë mjaftueshëm. Pjesa më e madhe e të anketuarve kanë thënë se flenë në mes të gjashtë dhe më pak se shtatë orë mesatarisht. Përqindja e njerëzve që flenë më pak se gjashtë orë tani qëndron në 39.5%, që është një rritje prej 11.1% krahasuar me një dekadë më parë.



Kur janë pyetur se pse nuk flenë mjaftueshëm, burrat kanë thënë për shkak të orareve të gjata të punës, ndërsa gratë ia kanë

vënë fajin përdorimit të teknologjisë para gjumit, për mungesë të gjumit të mjaftueshëm.

Mrekullia e frikshme e një fshati në Spanjë

Fshati Castellfollit de la Roca ndodhet pranë Girona-s në verilindje të Spanjës. Ai shkakton frikë për të gjithë ata që kanë fobi nga lartësia. Fshati është rreth 1.000 vjet i vjetër dhe ndodhet në mes të lumenjve Fluvià dhe Toronell. Castellfollit de la Roca është vendosur në një shkëmb basalt rreth një kilometër të gjatë dhe 50 metra të lartë. Ajo u krijua nga shpërthimi vullkanik, ndërsa erozioni iu dha dy lumenjve një pamje të veçantë. Është pjesë e Parkut Kombëtar të Garrotx, një parajsë për dashamirësit e natyrës dramatike në verilindje të Spanjës, e cila ka 40 vullkane të shuar. Edhe pse nuk ka rreziqe llave, kjo zonë është ende sizmike aktive dhe tërmetet e rastit nuk janë të pazakonta. Rrugët e ngushta dhe pamjet e paharrueshme të Castellfollit de la Roca, të dhurojnë përjetime mistike. Shtëpitë më të vjetra janë pjesërisht të ndërtuara me shkëmb vullkanik, ku më pas vijën sheshet mesjetare dhe kishat e vjetra. Turistët që duan të flenë në fshat dhe jo vetëm të ecin rrugicave të tij, kanë dhoma private dhe konvikte hoteliere. Fshati ka rreth 1.000 banorë. Në të janë gjithashtu dy muze. Njëri i është dedikuar mishit dhe salçiqeve, dhe aty mund të shihni veglat e përdorura në prodhimin e sallameve dhe produkteve të tjera të përpunuara. Ndërsa tjetri i është dedikuar Luftës së Vietnamit.



Vendi që do të paguajë me rrogë gjyshet që kujdesen për nipërit dhe mbesat

Gjyshet janë simbol i përkujdesit dhe dashurisë për të gjithë. Thuajse secili nga ne e kujtojmë gjyshen tonë me shumë dashuri, pikërisht për këtë arsye. Në shumë familje, gjyshet janë ato që kujdesen për fëmijët gjatë kohës që prindërit janë në punë. E për këtë arsye, Suedia ka vendosur t'i shpërblejë. Detyra rraskapitëse e kujdesit ndaj fëmijëve duhet të kompensohet edhe ekonomikisht. Qeveria suedeze ka aplikuar një program pilot që parashikon pagesën e një rroge për gjyshet që kujdesen për nipërit dhe mbesat e tyre nga e hëna në të premte. Qëllimi i këtij programi është për të përmirësuar nivelin e punësimit në vend. Dalarni dhe Stokholmi, kryeqyteti suedez, janë dy vendet ku do nisë program. Programi do nisë tek 1000 familje dhe në gjashtë muaj synohet të përhapet edhe në qytete të tjera. Mendohet se rroga bazë do jetë rreth 700 euro dhe flitet edhe për një përfitim ekstra, afërsisht 100 euro, për t'u kujdesur për fëmijët në shtëpi. Kjo do i japë mundësinë edhe nënave për të punuar të qeta. Duket aq e pabesueshme, që diçka normale siç është një gjyshe e cila kujdeset për nipërit dhe mbesat, tani do jetë një punë e paguar mirë.

Volkswagen prezanton Transporterin e ri



Volkswagen ka zbuluar versionin më të ri të serive të kombit të saj, Transporter, Caravelle e versionin California për kamping. I quajtur T6.1, ky version i ri do të ketë teknologji të re, stil të ri e fuqi elektrike. Çmimet e tyre ende nuk janë zbuluar ndërsa versioni Transporter pritet të lansohet në vjeshtë të këtij viti. Në Transporterin e ri, VW ka shtuar

sistemet e sigurisë si asistimi në trafik (Traffic Assist), asistimi në trafik (parking assist) e asistim në rimorkio (trailer assist). Nga brenda ka sistemin e argëtimit me ekran 9.2 inç që përkrah Apple CarPlay e Android Auto. Një varg i gjerë i motorëve do të ofrohen me të, duke filluar me 4 versione të motorit 2.0 litërs me katër cilindra turbo



diesel me kuajfuqi të ndryshme, duke filluar nga 87 kuajfuqi e deri te ai më i fuqishmi me 193 kuajfuqi. Risia më e madhe që Volkswagen sjell me këtë model është versioni i gjithi elektrik që prodhon 108 kuajfuqi e që mund të përshkoj deri në 400 kilometra rrugë me një mbushje të vetme të baterive.

1623 – Duka Maximilian I i Bavari-së emërohet monark i Paltëve.

1634 – Kapiteni irlandez Walter Devereaux vret Dukën Wallenstein.

1907 – SHBA shpall protektorat Republikën Domenikane.

1908 – Hapet tuneli i parë nën lumin Hadson (tunel për trafik hekurudhor).

1910 – Dali Lama shpëton Tibetin nga trupat kineze.

1919 – Lidhja e Kombeve vendoset sipas Marrëveshjes së Parisit.

1921 – Tbilisi, kryeqyteti i Republikës Demokratike të Gjeorgjisë okupohet nga ana e Rusisë bolshevike.


1925 – Vendosen marrëdhëniet diplomatike mes Japonisë dhe Bashkimit Sovjetik.

1926 – Francisco Franco bëhet Gjeneral i Spanjës.

1945 – Lufta e Dytë Botërore: Turqia i shpall luftë Gjermanisë.

1954 – Abdul Nasser emërohet Kryeministër i Egjiptit.

Çdo dhjetë vjet skeleti i njeriut ndryshon rrënjësisht si pasojë e proceseve të vazhdueshme të rinovimit të qelizave kockore.



A E DINI SE...



Mesatarisht, çdo njeri ndërsa është në gjumë, gëlltitë 8 merimanga gjatë gjithë jetës.



Rrjetet sociale shkaktojnë pagjumësi. Ato konsiderohen si një prej shkaqeve kryesore në këtë drejtim.

ÇUNI KINEZ...

– Doktor doktor, çuni është 6 muajsh dhe akoma nuk i ka hapur sytë!

– Ai që duhet ti hapi sytë je ti morshok, pasi çuni është kinez..



Në Politikë duhet të jesh dinak si dhelpër dhe i fortë si luan
(Niccolò Machiavelli)

KALENDARI HISTORIK 25 SHKURT



A E DINI SE...



BARSOLETA

THËNIA E DITËS